

**D**himbja në familje

**R**regulla të arta

**B**isedoni me fëmijët tuaj

**Ç**erdhja familjare

**S**exhdja kulmi i lirisë njerëzore

**P**oligamia

**T**avafi i një bisede zemrash



*Familja*

# Editorial

Kurorëzimi martesor përkrah prehjes dhe qetësisë që i fal shpirtit është njëkohësisht edhe elementi i vetëm i efektshëm që i fal formë rregullit fiziko-trupor.

Martesa, për femrën, do të thotë që ndjenjat e feminitetit, talentet dhe karakteristikat dalluese të saja t'i fokusojë mbi gjininë tjetër. Ndërsa për mashkullin kurorëzimi martesor është shtrati që e shpëton atë nga rënia brenda vorbullës fatkeqe të anëve negative të epshit dhe që i mundëson atij një jetë familjare të virtutshme.

Nuk ka dyshim se, prirja për të dashuruar dhe për të qenë i dashur nga të tjerët, ndjenjë që ekziston tek krijesa më fisnike, njeriu, përbën shkallën e parë të ngritjes drejt dashurisë hyjnore.

T'i japësh një start të keq kësaj ndërmarrjeje të bekuar me anë të zakoneve dhe veprimeve të mbrapshta që bien në kundërshtim me rregullat e sheriatit, do të thotë të çelësh për vetveten portën e pikëllimit.

Të shkurorëzosh bashkëshortin ose bashkëshorten për shkak dëshirash kalimtare, sepse kjo është e refuzuar kategorikisht nga mësimet e fesë që e konsiderojnë këtë veprim një padrejtësi dhe mëkat të madh, llogaria për të cilin në botën tjetër do të jetë e madhe, ashtu sikurse do të jetë edhe ndëshkimi për të.

Kuptimplotë është që burri të jetë i pari i shtëpisë po qe se do të kemi parasysh temperamentin jashtëzakonisht të ndjeshëm të femrës, e cila edhe kjo është e kuptueshme pasi që mbrojtja e brezit është e mundur vetëm në saj të ndjenjave të dhembshurisë që gruaja ka.

Në shekullin tonë flitet për një garë artificiale të iniciuar në emër të barazisë mashkull-femër. Kjo garë që bie në kundërshtim me veçoritë e krijimit, është duke i dobësuar femrës përherë e më shumë karakteristikën e amësisë dhe zonjës së shtëpisë duke i shkaktuar kështu plagë të rënda familjes.

Të mos duash të kesh fëmijë do të thotë mosmirënjohje ndaj dhuratës hyjnore, të dalësh kundër qëllimit final që ka kurorëzimi martesor dhe të pushtohesh nga ndjesitë e të pashpirtit ndaj vlerave dhe shijeve afektive, morale dhe sociale.

Diamanti i virtyteve që do të shkrijë brenda saj lodhjet e bashkëshortit, çamarokllëqet dhe lojëra mërzitëse të fëmijëve është vetëm zemra e nënës.

***Zoti ynë! Mundësona ne dhe familjeve tona një jetë të devotshme me të cilën do të fitojmë pëlqimin Tënd dhe na i shndërro banesat dhe shtëpitë tona në parajsat e begatisë dhe lumturisë! Mos i shndërro ato në ferrin e dhimbjeve ku gëlojnë mijëra mosbindje dhe akte të pamenduara!***

*Amin!..*

# Në këtë numër do të lexoni:

## Dhimbja në familje

Ahmet Tashgetiren

"Nëna fëmijë" ishte jehonë e tërmetit në rolet shoqërore të anëtarëve. Kjo do të thotë se fëmija nuk ishte fëmijë. Në Perëndim i ishte dhënë një rol që akoma s'mund ta mbarte siç ishte edhe roli i nënës...

4



Dhimbja në familje | 4 |

Ahmet Tashgetiren

| |

| 9 |

Të moshuarit dhe familja  
Mahmut Çamdibi

| |

Solidariteti brenda  
familjes në islam

Mehmet Erkal

| 10 |

| |

## Rregulla të arta për edukimin e fëmijës

Ibrahim Emiroglu

Të edukosh një fëmijë do të thotë që çdo prind të edukojë vetveten...

13



Shtëpia e lumturisë:  
një lulishte dashurie

Jashar Kandemir

| 14 |

| |

| 16 |

Familja dhe njeriu  
Fahredin Jëlldëz

| |

## Kushtet dhe vendi i edukatës familjare

Islam Dizdari

Në edukimin fillestar shëndetësor dhe fizik familja dhe posaçërisht nëna është e pazëvendësueshme.

20



Bisedoni me  
fëmijët tuaj

Ridvan Seferaj

| 18 |

| |

| 20 |

Kushtet dhe vendi i  
edukatës familjare  
Islam Dizdari

| |

## Poligamia

Mag. Artur Tagani

Në historinë e njerëzimit poligamia ka një të kaluar të gjerë...

24



Edukimi i brezave

Ismail Ozxhan

| 23 |

| |

| 24 |

Poligamia  
Mag. Artur Tagani

| |

Jetimët

Sadik Dana

| 26 |

## Përkthyes:

Adelina Muça  
Alban Kali  
Ali Bardhi  
Artur Tagani  
Elona Sytari  
Elvira Puka  
Ermal Nurja  
Evans Drishti  
Klementina Rrepa  
Naim Drijaj  
Nexhat Ibrahim  
Zymer Ramadani

Viti: III Numri: 12

Maj - Qershor 2008

Rebiul ahir - Xhumadel evvel 1429

Boton

Progresi Sh.p.k:

Shkodër / Shqipëri

Redaktor: gjuhësor-letrar:

Islam Dizdari

Dizenjo - Grafik:

Bledar Xama

bledar\_xama@hotmail.com

# Maj - Qershor 2008

30| Tavafi i një bisede  
zemrash...  
Muhamed Sytari



Çerdhja familjare  
Osman Nuri Topbash

Çerdhja familjare  
Osman Nuri Topbash

32|

| |

Prirja për të dashuruar dhe për të  
qenë i dashur nga të tjerët përbën  
shkallën e parë të ngritjes drejt dashurisë  
hyjnore...

32

38| Sexhdeja kulimi i  
lirisë njerëzore  
Enes Kariq

| |

Mendoni se ka njerëz që  
vërtetë ju duan  
Evans Drishti

41|

| |



Sexhdeja kulimi i  
lirisë njerëzore  
Enes Kariq

Nëpërmjet sexhdes rrymon e vër-  
teta, me të kalohet pas kohës dhe  
hapësirës...

38

42| Ajetet Kuranore për  
familjen dhe fëmijët  
Naim Drija

| |

Mburrrja sëmundja  
kryesore e zemrës  
Shpresa Bushati

44|

| |

46| Xhelozia në Islam  
Adem Pizga

| |



Xhamia emevite në Damask  
Ali Bardhi

Arti emevit hodhi gurthemet e  
para në arkitekturën islame që në  
fillimet e dinastisë së saj.

54

Familja dhe rëndësia e saj  
Ahmet Jaman

48|

| |

51| Vjen tek unë papritur...  
Samir Hoxhiq

| |

Muhamedi  
(poezi)

52|

| |



Biblioteka e myftinisë së Shkodrës  
Ferit Hafizi

Janë të njohura raportet e librit me  
bibliotekën. Të grumbullosh libra nuk  
është shumë e vështirë...

56

62| Teknologji  
Ali Bardhi

| |

## Adresa:

L: Vasil Shanto Rr: Çajupi  
Shkodër

Tel: +355 69 20 76 768

## Për artikuj:

e-mail: revistaetika@hotmail.com  
etikaeditor@yahoo.com

Ngjyra: Progresi

Tel: +355 69 20 76 768  
+355 69 20 58 855

Shtyp: ArbëriaDesign, Tetovë

Tel: +389 44 35 33 71  
Fax: +389 44 35 33 72

Çmimi: 1 Euro / 150 Lek / 60 DEN

# Dhimbja në familje

**N**ë faqet e para të revistave që botoheshin para 20 vitesh, jepeshin fotot e vajzave të vogla me një fëmijë në krah të cilat akoma nuk e kishin kaluar moshën e fëmijërisë dhe në to diskutohej çështja “**nëna fëmijë**”. Kjo temë ishte një problem në Evropën e para 20 viteve.

Në muajt e kaluar një vajzë në moshën 13- vjeçare sjell në jetë një fëmijë dhe shumëkush habitet nga situata. Domethënë, pas 20 vitesh në një temë po futeshim në procesin e plotësimit të standardeve të Evropës ndërkohë që ngjarja e cila u kuptua si një tregues i prishjes së shoqërisë evropiane, me një vonesë 20 vjeçare po fillonte të ngacmonte pak strukturën e shoqërisë sonë.

“**Nëna fëmijë**” ishte jehonë e tërmetit në rolet shoqërore të anëtarëve. Kjo do të thotë se fëmija nuk ishte fëmijë. Në Perëndim i ishte dhënë një rol që akoma s’mund ta mbar-te siç ishte edhe roli i nënës... Kur sytë i kaloni nga fëmija tek gruaja, gruaja nuk ishte nënë, djali nuk ishte baba, çatia e familjes kishte fluturuar mbi njësitë sociale të perëndimit. I riu ishte “**fëmija lule**” Beatles ishte Heavy metal, qëndronte në

azilin e pleqve. Dhe ja, në një atmosferë ku familja rrokullisej brenda një anafore, edhe vajzave që jetonin akoma fëmijërinë e tyre, mund t’u vihej roli i nënave.

## Fëmijët janë pasqyrë e tërmetit

Tani kjo furtunë sociale ka filluar të influencojë në një mënyrë të dukshme edhe në vendet e tjera. Janë lotët e fëmijëve në fillim ato që na bëjnë më tepër përshtypje, ndoshta ngaqë skenat më dramatike të këtij tërmeti vihen re tek fëmijët. Drama e tyre pasqyrohet në shoqëri. Vështrimi me sytë e përgjunjur ndaj gjyqtarëve të një fëmije, prindërit e të cilit janë ndarë, gjendja e mjerueshme e fëmijëve që qëndrojnë nën ura që kanë ikur nga shtëpia, rritjet e vazhdueshme të numrit të fëmijëve me faj, nënat fëmijë... në fakt ngjarja nuk përfundon vetëm me dramën e fëmijëve. Ajo është vetëm një rrjedhje gjaku e hanxharit që shpon në shumë thellësi... hanxhari plagën e vërtetë e ka hapur në shpirtira... Turqia, pikërisht tani shumë vite pas Evropës, është futur në anaforën e zgjidhjes së familjes. Ndoshta askush nuk jep sinjalin që “**mbaroi familja**” sikurse ndodh për familjen në Evropë. Por çdonjëri është i sigurt që po e jetojmë pikërisht atë fazë.

## Zonat ku vihet re shthurja e familjes

Një herë duhet të kemi parasysh se ka familje që kanë shkuar drejt shthurjes. Treguesit e ndarjes po rriten dita-ditës. Shumë individë që jetojnë modelin perëndimor po realizojnë martesën e tretë apo të katërt. Pra, janë tre katër herë të ndarë. Po fëmijë a kanë? Jo fëmijë s’kanë. Këto përbëjnë një pjesë që janë duke harxhuar edhe brezin e ri. Bukur, edhe martesat e tyre në të shumtën e rasteve nuk janë në ato rrethana që ne mendojmë. Pra, kur martohen nuk krijojnë një familje të tyren. Këto janë ata që përbëjnë një degjenerim familjeje në të cilën çdo lloj marrëdhënieje pranohet si normale dhe që quhen “**familje alternative**”. Vepimet dhe sjelljet e kësaj bote që prodhojnë marrëdhënie çmendurie epshore, i ndjekim nga shtypi i tyre.

## Anë të tjera të lëkundjes

Por është gabim ta shohësh tërmetin familjar të kufizuar vetëm me këto koloni perëndimore. Kjo pasi Perëndimi nuk është një shabllon prove që zbatohet apo praktikohet vetëm në kolonitë e vogla. E gjithë shoqëria është futur apo përfshirë në këtë fazë nga ana e shtetit dhe familjet sipas ra-

portit të influencimit nga ky proces, e ndjejnë edhe tërmetin. Statistikat e ndarjes në shumë shtete nxjerrin në dukje raportin e ndarjeve sipas shkallës së arsimimit. Kurse shkalla e arsimimit është tregues i pasqyrim të gjykimeve vlerësuese të perëndimorëve.

Padyshim që ndarja është prodhim i një lëkundjeje apo tronditjeje në familje. Por në të njëjtën situatë bëhet fjalë edhe për rritjen e numrit të fëmijëve në shtëpitë e lindjeve. Edhe rritja e numrit të fëmijëve me faj është e tillë. Edhe drejtimi që ka marrë rinia drejt heroinës është i tillë. Po kështu bëhet fjalë edhe për lindjen e lëvizjeve të rinisë së devijuar nga rruga. Edhe rënia e vajzave të ikura nga shtëpia në duart e komisionereve gra është e tillë... Edhe thellimi dita-ditës i ftohjes së marrëdhënieve mes brezave...

Vetëm tek sezoni i asaj që quhet "mospranimi si faj i zinasë..." është e mundur të shohësh faktin se në vend janë dhënë sinjalet e rrezikut të familjes. Faji në çdo shoqëri është një rregull apo parim vlerësues i situatave të veçanta. Është e pamundur ta quash si faj vjedhjen në një shoqëri ku më tepër se gjysma është vjedhës. Kjo pasi një fenomen i tillë tashmë për këto shoqëri është bërë një "vlerë parësore". Tashmë në shumë shtete kanë filluar të hidhen mendimet që "zinaja të mos njihet faj". Pra le të vendoset dinamiti në rrënjët e familjes dhe le të shkatërrohet ajo si e tërë. Vallë kaq shumë është përhapur zinaja? Kaq shumë qenkan zbutur ndjeshmëritë e shoqërisë ndaj këtij fenomeni? Vallë pjesa më e madhe e shoqërisë jeton në një atmosferë të tillë sa të mos ta shohë këtë fe-

**"Nëna fëmijë"** ishte  
jehonë e tërmetit  
në rolet shoqërore  
të anëtarëve. Kjo do  
të thotë se fëmija  
nuk ishte fëmijë. Në  
Perëndim i ishte dhënë  
një rol që akoma  
s'mund ta mbarte  
siç ishte edhe roli i  
nënës...

nomen si faj? Ne nuk jemi me këtë mendim. Por nga ana tjetër e shohim me shumë vend që një temë e tillë të jepet në shumë gazeta dhe të bëhet një temë për diskutim. Këto të paktën janë shenja të një thyerje të asaj ndjeshmërie ndaj këtyre situatave. Kjo do të thotë që tashmë edhe veshët na janë mësuar me këto ndodhi... Dhe aq shumë janë mësuar sa që kemi ardhur në një pikë sa ta pranojmë se një fenomen i tillë të mos quhet faj. Në një hadith thuhet: **"Do të vijë një kohë e tillë që zinaja do të shtohet. Bile njerëzit do të bëjnë zina mes rrugëve. Edhe njeriu më i ndjeshëm i asaj periudhe bile do të thotë: "Sikur ta bënin në një vend më të fshehtë".** Atëherë pyesim nëse jemi me të vërtetë në këtë pikë apo, diku aty afër? Ata që ia mbushin veshët shoqërisë me konceptin e zinasë, janë ata që e kanë përgatitur vdekjen e familjes së tyre.

#### **Ambienti apo rrethi me dhimbje në familje**

Të gjitha situatat që numëruam pak më sipër përbëjnë nga një përfundim. Por është

edhe mënyra e ardhjes deri aty. Pra është edhe prapaskena e këtyre rezultateve. Ja pra, aty është jeta familjare. Dhimbja aty mblidhet e mblidhet deri në atë pikë që të lindë edhe rezultatet. Fëmija fillon ta preferojë jetën apo pozicionimin e tij nën urë si një çati të familjes. Vajza fillon të preferojë për nënë dhe baba apo për fole të saj agjendën e artistit apo neonet me drita... Gruaja dhe burri në vend të bashkëshortit gjen rrugët e devijimit... Pse? Arsyeja është sepse mjedisi familjar brenda të cilit ndodhen ka dhimbje. Ja pra, kjo dhimbje, është një tjetër tregues i një të vërtetë të hidhur të vendit. Ndoshta nuk është arritur të dilet para gjyqtarit për të realizuar ndarjen. Por që në bashkëpunim janë përgatitur materialet për një situatë të tillë. Ajo që jetohet është një mjedis konfrontimi. Është ajo që i bren anëtarët e familjes... që i zhduk dashuritë e tyre. Që i shmang nga njëra-tjetra zemrat.. dhe që në fund secilin e nxit në kërkime jashtë familjes.... Duhet të theksojmë se një situatë e tillë në vend, është jeta e shumë pjesëve të gjera të popullsisë.

#### **Shkaqet e dhimbjes**

Pse kjo dhimbje? Pse kjo shthurje?

Përgjigjen e kësaj pyetjeje duhet ta kërkojmë tek vetë sistemi. Fillimisht u kërkua që të sillej vetëm idetë e botës perëndimore si vlera kulturore. Të gjitha operacionet e bëra kishin si qëllim të shembnin strukturën tradicionale dhe të mundësonin një strukturë të re shoqërore sipas vlerave perëndimore. Për këtë arsye struktura tradicionale u bë qëllimi apo pikësnyimi i goditjeve të shumta. Në këtë

periudhë operacioni më i rëndësishëm në drejtim të familjes janë disa vlerësime të reja lidhur me pozicionin e gruas. Thelbi i kësaj është pikërisht mendimi në kërkim të misioneve të reja për gruan përveç asaj të të qenit nënë. Me mendimin “nëse ndryshon gruaja, ndryshon shoqëria dhe kështu ndryshon struktura tradicionale”, u kërkua së bashku me gruan të kalohej nga brenda në arenën shoqërore.

Por mund të thuhet se ky operacion kulturor nuk pati jehonë në shoqëri përveç se në disa grupime shumë të vogla. Për një kohë të gjatë shoqëria e përdori familjen si një mbështetje dhe i bëri ballë operacioneve.

Me kalimin e kohës sistemi filloi të bëhej influencues në shumë sfera të jetës si në kulturë, drejtësi, strukturat sociale etj. duke e rrokur shoqërinë në të gjitha drejtimet. Formacioni kulturor i dhënë në shkollë nga njëra anë transmetonte tek brezat e rinj vlerat perëndimore, ndërsa kushtet ekonomike që kishin ardhur deri në grykë të shoqërisë e kishin shtyrë gruan që të punonte. Nga ana tjetër, mjetet e komunikimit masiv kishin marrë përsipër detyrën e krijimit apo të formimit të një botëkuptimi të përgjithshëm në drejtim të kësaj strukture socio – ekonomike – kulturore. Përcaktimi i ndihmesave të këtij drejtimi dhe shmangia e përballimeve të ardhura nga shoqëria u bënë misioni themelor i mjeteve masive të komunikimit. Ç’u jetua në këtë periudhë?

### Përplasjet e brezave

Përplasia e brezave në familje, çoi në thyerjen e tërësisë së familjes. Është kërkuar të fshihet influenca e prindërve dhe e gjy-

shërve tek fëmijët e tyre duke u bërë vartës të idesë: “përfaqësues të vlerave tradicionale”. Çdo gjë e ardhur nga fëmijët është përcaktuar si e mirë, ndërsa çdo dëshirë e prindërve si e keqe. Tek çdo fëmijë është kërkuar **“një identitet revolucionar”**. Nëse një vajzë apo një djalë ka ikur nga shtëpia atëherë këtu bëhet fjalë për tema të tilla që: “ka ikur pasi nuk ka mundur t’i përballojë presionet e babait të saj”. Fëmija është paraqitur si një kërkues i lirisë. Një situatë e tillë vazhdon edhe sot.

Janë lotët e fëmijëve  
në fillim ato që na  
bëjnë më tepër  
përshtypje, ndoshta  
ngaqë skenat më  
dramatike të këtij  
tërmeti vihen re tek  
fëmijët. Drama e  
tyre pasqyrohet në  
shoqëri

### Fushata e lirisë seksuale

Në këtë aspekt janë konsumuar vlerat dhe dinjiteti i shoqërisë. Slogani “liri seksuale” është kthyer në një armë për të goditur strukturën shoqërore. Nëse një vajzë ka insistuar tek familja për marrëdhënie të lira, ajo është duartrokitur. Pika e fundit e kësaj faze është lidhja pa kurorë. Pra, nuk kemi një familje në këtë mes. Kjo është edhe pika ku është filluar me sloganin “liri seksuale” dhe në të cilin është mbërritur. Këtu duhet pasur parasysh diçka.

Vendet islame në një mjedis ku ekziston një sistem i llojit perëndimor, po i jeton në të njëjtën kohë dy situatat apo dy rrethanat që krijojnë një kurth me epshin e një turpi “pa të mbuluar” në përgjithësi: influencën e mjeteve të komunikimit masiv si dhe arsimimin e përbashkët të vajzave me djemtë. Nga njëra anë po zgjohet që në moshë të re “vetëdija e jetës seksuale”, deri sa nga ana tjetër si domosdoshmëri e kushteve ekonomike dhe arsimore po rritet vazhdimisht mosha e martesës. Kjo strukturë e pashëndetshme po shtyn edhe shoqërinë në disa situata të pashëndetshme. Kjo pasi një strukturë e tillë edhe ndjenjat seksuale po i zgjon në një moshë shumë të hershme edhe mundësitë e bindjes dhe ndjeshmërisë po i ofron në terrene të lejuara. Këtu sistemi nuk vendos para të riut të drejtën për të zgjedhur tjetër përveç dy sjelljeve që do të çojnë ose në presionin ndaj ndjenjave ose në kërkimin e rrugëve drejt çdo lloj marrëdhënieje jashtëligjore që do të hiqte beqarinë në botën shpirtërore. E para është vështrësimi i ekuilibrit shpirtëror dhe devijimet seksuale të ndryshme dhe e dyta shkon deri tek papërgjegjshmëria që zgjatet deri tek **“nënat fëmijë”**. Po që të dyja këto mbartin kuptimin e plagosjes që në krye të brezave që do të krijojnë familje.

### Gruaja dhe jeta e saj në punë

Slogani fillestar i hyrjes së gruas në jetën sociale të punës është **“Liria ekonomike”**. Gruaja do të punojë, do të fitojë dhe do të shpëtojë nga varësia me të shoqin për nga ekonomike. Kështu, ajo do të jetë më e pavarur dhe më e lirë. Ajo do të vendosë me liri në vetve-

te edhe për të ardhmen e saj. Si kjo propagandë ashtu edhe struktura kapitaliste që mat secilin me vlera ekonomike e tërhoqi gruan drejt jetës në punë. Për dikë të punosh ishte **“rruga e lirisë”**, për dikë tjetër një mënyrë për të përballuar jetesën... por që të dy rastet kishin një përgjegjësi për familjen.

Për një individ që e vlerëson punën si një **“rrugë lirie”** faktikisht lidhja me familjen vinte në plan të dytë. Pyetjes që **“familja apo puna?”** një pjesë padyshim që i përgjigjej **“puna”**. Këtë pjesë asnjë domosdoshmëri **“s’mund ta burgoste”**. Të shkëputesh pa punuar ishte një lloj burgimi në shtëpi. Për këtë arsye fëmija ishte lidhja këmbë e duar për këtë grua. Ishte një gjë e padëshiruar. Kjo pjesë bënte rregullisht kontroll lindjeje dhe ishte klienti i parë i sektorit të kurtazhit. Për këtë pjesë në fakt edhe çatia e familjes ishte e tepërt. Pasi dashje pa dashje familje do të thoshte të futeshe nën një përgjegjësi. Pasi të futeshe nën atë përgjegjësi, nuk mund të parashikoheshin ecuritë e situatave. Ky botëkuptim e rriti edhe numrin e grave të pamartuara në shoqëri. Po nevojat seksuale? Edhe lidhjet jashtëmartese ishin prodhim i këtij botëkuptimi...

Kjo ishte një lëvizje individuale që fillonte me atë që s’kishte asnjë lloj përgjegjësie ndaj shoqërisë, pra fillonte me vetë personin dhe mbaronte po me vetë individin. Mendoni për një çast një shoqëri e cila përbëhet pikërisht nga njerëz të tillë. Dhe pas një brezi nuk mbetej asnjë vepër në botë. Kjo është edhe dita e gjykimit për atë popull. Por edhe t’i tregosh një përgjegjësi të tillë kësaj pje-

se që nuk është një e vërtetë tjetër veçse vetja, është e pamundur.

Nga ana tjetër gruaja që e zgjedh punën si një domosdoshmëri të sistemit kapitalist, është një lloj robëreshe e këtij sistemi. Një, dy, tre apo sa vetë të jenë në shtëpi janë shtyrë në domosdoshmërinë e punës. Çdo pjesëtar i familjes do të punojë. Sistemi fillimisht e ka integruar shoqërinë nga fshati në qytet dhe më pas e ka marrë atë një e nga një në dhëmbët e veta. Ja pra, pikërisht në këtë

Ndoshta askush  
nuk jep sinjalin që  
**“mbaroi familja”**  
sikurse ndodh për  
familjen në Evropë.  
Por çdonjëri është  
i sigurt që po e  
jetojmë pikërisht  
atë fazë

pikë gruaja mbetet e detyruar të ndajë jetën e saj me shtëpinë dhe punën. Ndoshta shpirti i saj është në shtëpi por është e detyruar që të ndahet nga shtëpia. Ajo që jeton është plotësisht një rebelim mes shtëpisë dhe punës. Kurse përfundimet që transmetohen në familje janë të tilla: Fillimisht gruaja është kthyer në një punëtoare. Fillimisht 8 orë punë dhe më pas edhe një orar që nuk i dihet se sa zgjat në shtëpi... E nesërmja po ashtu, e pasnesërmja

po ashtu... stresin që jeton në punë e mbart në shtëpi, dhe anasjelltas... Ky nuk është një lloj statusi që mund ta përballojë njeriu... Këtë fillimisht e paguan gruaja dhe më pas edhe familja. Gruaja e paguan pasi përpyekja për të realizuar të gjitha përgjegjësitë, do të bëhen një ngarkesë që me kalimin e kohës nuk do të mund t’i mbartë dhe energjia e saj do t’i shterojë. Familja e paguan pasi në atë moment kur gruas i shterohen energjitë, do të lërë mënjane ndonjë pjesëtarë të familjes apo ndonjë punë dhe kështu do të acarohen marrëdhëniet burrë-grua, do të ketë çarje apo ndarje në marrëdhëniet nënë-fëmijë dhe të gjitha rezultatet e këtij skenari do të vinë njëra pas tjetrës. Në ajetin 21 të sures Rrum thuhet:

**“Dhe një nga faktet më të qarta është krijimi i bashkëshortëve për ju që të jeni të qetë. Ai ju ka sjellë dashuri dhe mëshirë.”**

Ja pra, ndryshimi në detyrat individuale ndryshon funksionin e krijimit të një ambienti të qetë për folenë e gruas. Pasi gruaja që punon kthehet në shtëpi me stres. Kështu kufizohen momentet ku gruaja dhe burri janë bashkë, kufizohen çështjet për diskutim, ndërkohë që përgjegjësitë familjare pakësohen, shtohen marrëdhëniet në rrethin e punës.

Kjo është e vërteta e dhimbjes në familje. Një preokupim i tillë i nënës në jetën sociale do të thotë dërgim i fëmijës në kopsht apo çerdhe, do të thotë mënjanimi i edukatës, do të thotë drejtim i fëmijëve në moshë të rritjes në marrëdhëniet jashtë kontrollit dhe mbi

të gjitha do të thotë frikë e fëmijës... Do të thotë nënë që frikësohet nga lindja... në fakt ajo që e shkatërron familjen e madhe, kushtet që i dërgojnë të moshuarit në azilin e tyre, janë ato që e dërgojnë fëmijën në çerdhe apo kopsht. Është pikërisht kjo dhimbje që jeton vendi në këtë kohë dhe që influencon masat e gjëra. Është e vështirë që të tregosh familje në të cilat gruaja punon e në shtëpi të mos ketë probleme. Çdo familje paguan një lloj dëmshpërblimi dhe e ardhmja e shoqërisë ndërtohet mbi bazën e këtyre dëmshpërblimeve.

### **Konceptimi i drejtë i problemit**

E vërteta është se familja është në krizë. Ndoshta është një krizë që e ndjek Evropën pas 20 vitesh dhe që përshin në të gjitha çapëkëllëqet që jetojnë.

Familja ka ardhur deri në këtë krizë si rezultat i lëkundjeve të ndjenjave shpirtërore që e ndërtojnë atë, konsumimit të tyre dhe plagosjes me duart e shtetit. Më pas është detyrimi për të jetuar brenda një atmosfere kundër familjare të as-

pekteve materiale që përbëjnë familjen. Është një strukturë socio – kulturore – ekonomike me karakter perëndimor.

Pikat e domosdoshme të kësaj strukture në vend të masave që do të zhdukin rrënjësisht shthurjen në familje, dhimbjen e kaplosur, është ndërtimi i institucioneve që do të përballohen me rezultatet e kësaj dhimbjeje. Vende të tilla si shtëpitë e fëmijëve, gjykatat e fëmijëve, vendet e sigurimit për gratë dhe institucionet e studimit familjar... Nga njëra anë kemi vijmësinë e sistemit që nxit shthurjen, nga ana tjetër shenjat e plasaritjes të hapura në sisteme...

Në Perëndim kjo rrugë nuk e shpëtoi familjen. U dhanë shumë ndihma ndaj këtyre viktimave të familjes... Por familja nuk shpëtoi... Një rrugë e tillë edhe në disa vende myslimane si Shqipëria, Turqia, Bosnja etj. nuk do ta shpëtojë familjen. Kjo është e vërteta që të dhemb dhe kjo duhet të thuhet.

Nuk është se nuk e mendojmë edhe faktin se ka edhe nga ata që pyesin **“Kaq e rëndësishme është familja?”** Kjo pasi

shoqëria është futur në një marramendje vetëdijeje për sa i përket institucioneve themelore. Familja është e rëndësishme. Familja mbetet terreni ku shoqëria është shoqëri. Është bërthama e shoqërisë. Atje është indexi i shoqërisë. Nëse aty ka një prishje të strukturës nuk është e mundur të vjelën nga pema frytet e xhenetit.. Nuk mund të tregohet asnjë lloj shembulli i tillë që të jetë konsumuar në familje dhe që në shoqëri të ketë lënë gjurmë. Familja është sikurse shkolla e parë e shoqërisë. Është vatra ku janë marrë frytet e para. Dhe ja sot, kjo shkollë mbetet përpara shumë rreziqeve. Kur i hedhim sytë Perëndimit, mund të vëmë re ku është stacioni ynë i fundit.

Ose më një analizë të re mund t'i drejtohem një shpëtimi. Kjo a do të jetë një analizë e re si popullatë? Do të përcaktohet një drejtim i ri. Njeriu do t'i drejtohet natyrës që Allahu i ka përcaktuar dhe do të shpëtojë. Edhe për vendin tonë kjo është receta e vetme e shpëtimit.



# Të moshuarit dhe familja

**T**ë moshuarit janë pemët e dinjitetit (Maverdi)

Pleqëria është periudha që të jep mundësi të vlerësosh ngjarjet, të tjerët dhe veten më mirë. Dobësia që shihet tek trupi i të moshuarve nuk duhet të na shtyjë të mendojmë se tek ata ka mbaruar çdo gjë, sepse tek të moshuarit në raport me dobësinë fizike ka një ngritje shpirtërore. Duke u lehtësuar nga preokupimet e periudhës së rinisë, ata kanë kohë të mjaftueshme për t'u interesuar me problemet e njeriut dhe botën shpirtërore.

Të stërvitur nga përvoja e kaluar në pleqëri cilësitë, si: dashuria, dhembshuria, aftësia për të kuptuar drejt, hasen më shpesh. Por në të njëjtin raport interpretimi i keq ose vlerësimi i padrejtë i këtyre përvojave mund të bëhet shkak i disa gabimeve në pleqëri. Ka shumë të moshuar që e shohin veten më lart se të tjerët, që nuk heqin dorë nga mendimi i tyre qoftë edhe i padrejtë dhe që nuk i japin liri të rinjve. Shkaku është se e shohin suksesin e arritur si një meritë vetjake duke anashkaluar ndihmën e Allahut. Epshi dhe dëshira për post është lloji më i vështirë i egos që mund të evitojnë njerëzit.

Në ditët e sotme vlerësimi më shumë se ç'duhet i vlerave materiale, të menduarit vetëm për vete, kanë shkaktuar robërimin e njerëzve ndaj egos, si rrjedhojë edhe largimin e tyre nga njëri-tjetri. Fatkeqësisht nga kjo vetmi janë ndikuar më shumë të moshuarit. Njeriu është një qenie sociale që ka prirje të jetojë në grup dhe asnjëherë të jetuarit vetëm nuk mund të konceptohet liri. Mendimtarët dhe psikologët më të njohur bashkëkohorë tashmë mendimin e gabuar të "lirisë" që e shpie njeriun në vetmi, e kritikojnë ashpër duke i dhënë prioritet ndjenjave të vëllazërimit dhe afritit të individëve me njëri-tjetrin.

Nuk është e mundur të mendojmë se të moshuarit janë "barrë" për shoqërinë, sepse ata kanë investuar për

t'i shërbyer shoqërisë. Në krye të investimeve të tyre padyshim radhitet edukimi, ndërsa investimi më i madh është edukimi i rinisë. Në këtë aspekt atyre u jemi shumë mirënjohës.

Fakti që të moshuarit konsiderohen si problem në shoqëri, vjen nga shthurja gjithnjë e më tepër e familjes si thelb i saj. Në ditët e sotme është e vështirë të dallosh se çfarë detyre, çfarë roli mbajnë mbi supe individët e një familje. Është më se i vërtetë fakti se një nënë teksa nuk gjen kohën e mjaftueshme për të edukuar fëmijën e vet, për t'i përkushtuar dashuri, për ta rritur nën frymën e dhembshurisë dhe për të sakrifikuar që të ndodhet gjithnjë pranë tij....a mos vallë do arrij të gjej kohën e mjaftueshme për t'u interesuar për të moshuarit?!

Nga ana tjetër të moshuarit kanë nevojë për dashuri, interesim. Çdo individ ka detyrime ndaj familjes, si ndaj fëmijëve, ashtu edhe ndaj prindërve të tij. Që të dy anët presin nga ai dashuri dhe interesim. Për të realizuar këtë duhet një personalitet i ekuilibruar, ndërsa tek individët egoistë si rezultat i prishjes së këtij ekuilibri, të moshuarit ose lihen pas dore, ose braktisen fare.

Në familje të moshuarit, gjyshja dhe gjyshi, luajnë një rol të rëndësishëm si tek fëmijët në aspektin e dashurisë dhe të besimit në vetvete, ashtu edhe tek të rinjtë në formimin e personalitetit të tyre. Tek të moshuarit ekuilibri i hormoneve nga agresiviteti e ashpërsia janë drejtuar kah dashuria dhe mëshira. Është vërtetuar shumë herë që në rininë e tyre shumë të moshuar kanë qenë të ashpër dhe agresivë, kurse sot në pleqëri janë vetëm burim i dashurisë, dhembshurisë, mëshirës ndaj nipërve të tyre...ndërsa për shoqërinë kjo përmban në vetvete një rëndësi të veçantë.

Në familje duke përfshirë edhe të moshuarit të gjithë individët kanë de-

tyrat e tyre. Këto detyra janë pasuria më e madhe e familjes. Nëse një pjesë e këtyre detyrave lihen pas dore bëhet shkak i paevitueshëm në edukimin e padrejtë të fëmijëve.

Individët duke përfituar nga përvoja dhe aftësitë e njëri-tjetrit duhet të jetojnë në një harmoni të plotë. Veçanërisht fëmijët përfitojnë shumë nga përvojat, dashuria, mënyra e të shprehurit të të moshuarve. Teksa prindërit mundohen për t'i siguruar jetesën fëmijëve, nuk gjejnë kohën e mjaftueshme për t'u interesuar për to. Si rezultat i kësaj fëmijët futen në vetmi dhe ndikohen vetëm nga moshatarët e tyre. Nëse gjithnjë do të gjenden në një ambient vetëm me moshatarët e tyre, do jetë shumë e vështirë të zgjerojnë të folurin, pikërisht në këtë aspekt është shumë i rëndësishëm prania dhe roli i të moshuarve.

Të moshuarit me një karakter sa serioz, aq dhe të dashur do të jenë shembull për fëmijët dhe të rinjtë. Do të jenë përfaqësuesit më të denjë të vlerave njerëzore që do të trashëgojnë brez pas brezi.

Azilet e pleqve në plan të parë mendohen si një vend ideal për të moshuarit. Por nga ana tjetër duke i larguar nga njerëzit e dashur sado të mira të jenë kushtet në azile, vendin e familjes nuk e zë asnjëherë. Lind ajo ndjenja e dëshimit që mund të përjetojnë...duke pyetur veten, a mos vallë unë nuk isha i denjë për nipërit dhe fëmijët e mi? Pikërisht këto mendime shkaktojnë tek të moshuarit rënie si në aspektin fizik, ashtu edhe në atë shpirtëror e moral.

# Solidariteti brenda familjes në Islam

“O ju njerëz, vërtetë Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj dhe fise që të njiheni mes vete e s’ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur e Allahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë”

(Huxhurat 13)

**N**ë ajetin 13 të sures Huxhurat Allahu i Lartmadhëruar urdhëron e thotë:

“O ju njerëz, vërtetë Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj dhe fise që të njiheni mes vete e s’ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur e Allahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë”.

Nga ajeti i lartpërmendur kuptojmë se lloji i njeriut është krijuar prej një mashkulli dhe një femre dhe kështu me këto dy elemente së pari është formuar familja, ndërsa më pas nga familja janë krijuar edhe fise dhe popujt. Si rezultat i kësaj familja është institucioni social më i vjetër. Jeta sociale ka filluar me të dhe me të vazhdon. Gjatë historisë ky institucion është ngushtuar apo zgjeruar si pasojë e problematikave të ndryshme, por që përherë e ka ruajtur ekzistencën e tij.

Familja që përbëhet nga anëtarë që janë të lidhur me njëri-



tjetrin nga gjaku, qumështi dhe martesa, është vendi në të cilin është mundësuar për herë të parë dhe në kuptimin më të gjerë solidariteti social. Pasi solidariteti social pikësepari mundësohet me anë të ndihmave sociale. T’i bësh mirësi dikujt pa prituri ndonjë shpërblim, t’i buzëqeshësh me një fytyrë të ëmbël, ta pyesësh për shëndetin dhe problemet duke e bërë atë për vete, është një ndihmesë shpirtërore. Për t’i realizuar të gjitha këto nuk është kusht që dikush të jetë i pasur. Gjithashtu nuk është e nevojshme që atij që i jepet ndihmesa shpirtërore,

të jetë i varfër. Në Kur’an, në shumë ajete njerëzit ftohen në punë të hajrit dhe të dobishme, por që theksohet se kjo punë e hajrit dhe me vlerë dhe kjo mirësi së pari t’u bëhet prindërve. Kjo pasi nuk mund të presësh ndihmesë për të tjerët nga një person apo individ i cili nuk e ka përgatitur veten e tij për një solidaritet social në familje si dhe nëse këtë nuk e ka kuptuar si një parim etik të pashmangshëm dhe një lloj sjelljeje etike.

Feja Islame ashtu sikurse i ka dhënë një rëndësi të veçantë ndikimeve shpirtërore dhe ndihmesave sociale ashtu i ka dhënë rëndësi edhe sigurisë sociale. Familja është institucioni më themelor i sigurisë sociale që i garanton njeriut shpëtimin prej rreziqeve. Sigurimi social në familje fillimisht kontrollohet me ekzistencën e respektit, dashurisë dhe dhembshurisë që duhet të ndjejnë anëtarët e një familjeje për njëri-tjetrin. Çështja më e rëndësishme që e fut në rrezik funksionin e institucionit të familjes është mosmarrja në konsideratë nga ana e brezit të ri e solidaritetit brenda familjes

si dhe qëndrimi indiferent i tyre ndaj prindërve. Një gjë e tillë i lëkund themelet e familjes.

Allahu i Lartë urdhëron e thotë:

“Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre ose që të dy i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as “of – oh” as mos u bëj i vrazhdë ndaj tyre por thuaju fjalë të mira. Dhe në shenjë mëshire shtrihe pranë tyre krahun përulës e respektues dhe thuaj: “Zoti im! Mëshiroi ata të dy sikurse më edukuan mua kur isha i vogël”(el-Isra/ 23-24)

Në ajetin e dhënë shprehet kujdesi që duhet treguar ndaj prindërve, ndaj tyre duhet folur me fjalë të mira, sepse ata mërziten e hidhërohen edhe nga një fjalë a shprehje. Kuptimi i ajetit është i gjerë aq sa mund të përfshijë në të fjalë dhe sjellje që mund t’u japë dhimbje atyre dhe që mund t’i shqetësojë. T’u thuash fjalë të këqija prindërve, të sillësh ndaj tyre në mënyrë të padëshirueshme e aq më tepër të mërzitesh nga shërbimi që u bën atyre dhe t’i dërgosh në azil dhe të tilla si këto, janë punë që Islami i ka kundërshtuar rreptësisht. E vetmja gjë e veçantë këtu është ajo që Allahu e ka ndaluar. Këshillat dhe urdhrat e prindërve që janë të këqija dhe gjynah, janë e vetmja gjë e veçantë që Allahu i Lartë i ka ndaluar. Për këtë urdhëron e thotë:

“Ne njeriun e kemi urdhëruar për sjellje të mira ndaj prindërit të vet sepse nëna e vet atë e barti me mund pas mudi dhe pas dy viteve ia ndau gjirin (e porositëm) Të jesh mirënjohës ndaj

Meje dhe ndaj dy prindërve të tu pse vetëm tek Unë është kthimi juaj. E nëse ata të dy tentojnë që ti të më përshkruash Mua shok për çka ti nuk ke asnjë fakt atëherë mos i respekto ata po në çështjet e jetës së kësaj bote të kesh mirëkuptim ndaj tyre e ti ndiqe rrugën e atij që është i kthyer tek Unë, mandej kthimi juaj është tek Unë e unë do t’ju njoftoj për atë që keni punuar”(Llukman/14,15)

Ka shumë hadithe edhe të Pejgamberit (a.s) që theksojnë rëndësinë që ka bindja ndaj prindërve. Mes këtyre shembujve sa bukur tregohet një temë e tillë në këtë bisedë që bëhet mes sahabëve:

- O i dërguari i Allahut, kush është personi më i duhur mes njerëzve për t’u sjellë mirë?

- Ajo është nëna.

- Po më pas kush vjen?

- Përsëri është nëna.

- Po më pas kush vjen?

- Babai. (Buhari, Edeb 2)

E pyesin të dërguarin e Allahut se cila është puna më e pra-

Familja është  
institucioni social  
më i vjetër. Jeta  
sociale ka filluar  
në të dhe me të  
vazhdon

nue-  
shme nga  
ana e Allahut;  
dhe ai thotë:  
“Namazi i falur në  
kohën e vet” E pye-  
sin se cila vjen më pas;  
dhe ai përgjigjet: “Mi-  
rësia që u bëhet prindër-  
ve” më pas e pyesin se cila  
vjen: dhe u përgjigjet: “Lufta  
në emër të Allahut” (Ebu Da-  
vud, Salat, 9)

Që ne të jemi të qëndrueshëm si nga ana fetare, nga ana kom-  
bëtare ashtu edhe nga ajo etike  
është e domosdoshme vendosja  
e familjes mbi baza të shëndo-  
sha. Kjo është edhe arsyeja që  
feja Islame i ka dhënë shumë  
rëndësi familjes. Feja Islame i  
ka shqyrtuar në detaje proble-  
met e marrëdhënieve mes anë-  
tarëve të familjes dhe për këtë  
ka vendosur shumë parime.

Që foleja familjare të jetë e  
qëndrueshme, është kusht që të  
ekzistojë respekti dhe dashuria  
mes partnerëve.

“Ai krijoi nga vetë lloji juaj  
palën (gratë) ashtu që të gjeni  
prehe tek ato dhe në mes jush  
krijoi dashuri e mëshirë. Në  
këtë ka argumente për njerëzit  
që mendojnë.”(Rrum/21)





“A t a janë mbulesat e juaja kurse ju jeni mbulesat e tyre” (Bakare/187)

Ky ajet i fundit shpreh faktin se çiftet e kanë plotësuar veten e tyre me lidhjen në martesë. Martesa është një domosdoshmëri e natyrës së njeriut qëllimi i së cilës është krijimi i një foleje me qetësi dhe lumturi dhe edukimi i brezave të dobi-shëm dhe të mirë për jetën. Në të njëjtën kohë është edhe synet i pejgamberëve. Pejgamberi ynë Muhamedi (a.s) ka thënë:

“Martesa është suneti im. Ai që nuk e zbaton sunetin tim nuk është nga radhët e mia. Martohuni pasi unë do të mburrem me shumicën tuaj përpara të tjerëve.” (Tirmidhi)

Në bazë të këtij suneti besimtarët që kanë mundësi do të martohen, do të edukojnë fëmijë të dobishëm në oxhakun e familjes plot qetësi dhe lumturi dhe gjithashtu do të kërkojnë edhe ndihmesën e Allahut në këtë drejtim.

“Edhe ata që thonë: “Zoti ynë, na bën që të jemi të gë-

zuar me punën e grave tona dhe pasardhësve tanë e neve na bën shembull për të devotshmit” (Furkan/74)

Me sjelljen e një fëmije në jetë nuk mbaron puna. Ashtu sikurse i kushtojmë kujdes që ta rrisim dhe edukojmë në mënyrë të shëndetshme, ashtu do t'i kushtojmë kujdes ndoshta edhe më tepër etikës dhe edukatës së fëmijës dhe sapo fëmija të vijë në jetë do të kërkojmë edhe ndihmën e Allahut. Shembulli më i madh dhe më konkret në fazën e rritjes dhe zhvillimit për fëmijën është prindi i tij. Prindërit që bëhen shembuj negativ për fëmijët e tyre do të kenë një përgjegjësi tepër të madhe përpara Allahut. Kjo pasi fëmijët tanë janë amanet për ne dhe vendi për t'i mbrojtur ato është oxhaku i familjes dhe jo individët. Nënata të cilat pa qenë shumë e nevojshme, i lënë këto amanete madhore që janë një përgjegjësi për ta në dorën e të tjerëve dhe vetë shkojnë në vende të ndryshme, nesër janë kandidatë për edukimin e brezave pa interes dhe mëdyshe.

Islami kërkon nga prindërit

T'i bësh mirësi  
dikujt pa pritur  
ndonjë shpërblim, t'i  
buzëqeshësh me një  
fytirë të ëmbël, ta  
pyesësh për shëndetin  
dhe problemet duke  
e bërë atë për vete,  
është një ndihmesë  
shpirtërore

që fëmijët e tyre të rriten në atë mënyrë që të jenë të kënaqur edhe me Allahun edhe Profetin dhe për këtë arsye duhet që t'i nxisin në adhurim, në punë të mira, të jenë të mëshirës dhe të tolerancës, të tregohen zemërgjerë dhe të gatshëm ndaj ndihmesës, fesë, atdheut dhe popullit. Askush nuk duhet të dyshojë që fëmijët të cilët nuk interesohen për fenë aq sa edhe për lotot sportive, që nuk njohin miqtë e ngushtë të Allahut dhe personalitetet historike aq sa njohin artistët dhe që u kthejnë kokën vlerave hyjnore, do të jenë problem serioz si për të sotmen ashtu edhe për të nesërmet.

E gjithë vuajtja e njerëzimit të sotëm, arsyeja e fatkeqësive në të cilat ka rënë është pikërisht lëkundja e institucionit të familjes. Të presësh një jetë të lumtur dhe një përparim nga anëtarët e një familjeje ku nuk ka një disiplinë hyjnore dhe të cilët nuk njohin një përgjegjësi shpirtërore, do të ishte e njëjtë sikur të vraposh drejt imagjinatave. Një popull i cilit i është shembur rregulli dhe sistemi i familjes, nuk i ka mbetur asgjë në këmbë.

Cilësitë më të larta të popujve të mëdhenj që kanë lënë gjurmë të përjetshme në histori dhe që i kanë prirë botës së njerëzimit për shekuj me radhë kanë qenë pikërisht ata që kanë pasur një strukturë të shëndetshme të familjes. Përmasat e kësaj strukture Allahu i Lartë i ka përcaktuar në Kur'an kur urdhëron: “Mos u thoni prindërve as uf...”, ndërsa Pejgamberi ynë Muhamedi (a.s.) në hadithet e tij kur thotë: “Xheneti është nën këmbët e nënës” Nëse ne arrijmë të marrim pjesë nga këto këshilla sa të lumtur që do të jemi!

# Rregulla të arta

## për edukimin e fëmijës

**F**aktikisht të edukosh një fëmijë do të thotë që çdo prind të edukojë vetveten. Për të pasur një fëmijë të mirë ai duhet të heqë dorë nga gabimet, duhet të përballojë situatat e vështira dhe të sakrifikojë.

Duhet ta vëmë në dukje edhe para fëmijëve dashurinë dhe respektin që kanë anëtarët e familjes ndaj njëri-tjetrit.

Prindërit nuk duhet të debatojnë apo të grinden para fëmijëve apo në sy të fëmijëve. Nuk është e drejtë që fëmijët të përdoren dhe të shfrytëzohen në këto situata dhe të dëgjojnë biseda që përmbajnë fjalë të rënda dhe fyese.

Nuk duhet që të shfaqen reagime fyese apo tallëse ndaj disa fjalëve të gabuara apo edhe gabimeve të vogla. Nuk duhet harruar se edhe ata mund të preken nga këto sjellje.

Nuk duhet lejuar që as fëmijët mes njëri-tjetrit të përdorin fjalë të rënda.

Nëse ka në mes një faj që e kanë bërë fëmijët, duhet gjetur faji dhe të dënohet vetëm ai që e ka bërë atë.

Duhet përdorur drejtësia si në dhënien e dënimit ashtu edhe në atë të shpërblimit. Në këtë aspekt duhet sjellë në mënyrë të barabartë mes vëllezërve (ose nxënësve).

Ne duhet t'u mësojmë dhe t'u shpjegojmë fëmijëve që t'i duam krijesat për shkak të Krijuesit

Me to duhet të sillemi si të mëdhenjtë por nuk duhet të presim si prej të mëdhenjve.

Do të ishte më pak e mërzitshme t'ua kujtosh përgjegjësitë që kanë sesa t'ua numërosh një e nga një gabimet e bëra.

Fëmijës duhet t'u tregojmë shembuj personalitetesh nga njerëz që kanë virtyte të larta, si: heroizmin, kurajën, fortësinë, drejtësinë dhe tolerancën.

Duhet t'i krijohet mundësia që të merret me aktivitete sociale.

Duhet ta nxisim që të merret me sport dhe muzikë.

Duhet t'i shpjegojmë mirë se nuk është e drejtë vënia dorë në mallin e tjetrit, rëndësinë që ka koncepti "drejtësia" dhe domosdoshmërinë e fitimit hallall.

Nuk duhet të lejojmë që çdo dëshirë e fëmijës të shkojë në vend dhe gjërat të ecin në mënyrë të parregullt. Duhet të interesohemi nga afër për ta duke studiuar edhe vendet ku ndodhen dhe nuk duhet ta lëmë mënjatë inisiativën tonë (pa ndjekur ndonjë presion).

Nuk duhet ta dënojmë fëmijën për të gjitha gabimet e bëra, duhet t'ia shpjegojmë me rrugë bindëse gabimin duke bërë të mundur që

disa gabime t'i anashkalojmë. Nuk duhet të ndjekim rrugën e dënimit për shkak të gabimeve të bëra në mënyrë të pavetëdijshme apo pa dashur, por duhet të përpiqemi t'ia rregullojmë gabimin duke e bindur për atë që ka bërë.

Ata duhet t'i edukojmë që t'i mbajnë duart pastër, gjithashtu fytyrën, dhëmbët, thonjtë, veshjen, trupin dhe ambientin.

Fëmijët në moshë të vogël nuk duhet t'i frikësojmë me mjete të frikshme apo me gjëra jashtë realitetit që janë imagjinare.

Edhe sikur të bëjnë pyetje të vështira për moshën e tyre duhet t'u japim përgjigje me durim dhe në mënyrë që ata t'i kuptojnë, por pa i thyer dhe prishur vullnetin e tyre për të mësuar.

Mos harroni se ata janë fëmijë dhe ndjekin çdo lëvizje duke e regjistruar sjelljen tuaj si një model.

Për të kuptuar problemet e tyre duhet të uleni në moshën e tyre si një mik dhe shok por pa ulur tepër edhe shkallën tuaj.

Fëmija duhet të përgëzohet dhe të shpërblehet për një punë të mirë që bën.

Ne duhet të jemi shembull edhe në pastërti dhe në rregull.

Ne duhet ta lejojmë që të luajë dhe të jetojë fëmijërinë e tij.

# *Shtëpia e lumturisë: një lulishte dashurie*

*Fragmente nga jeta familjare  
e Profetit Muhamed (a.s.)*

**P**rofeti Muhamed (a.s.) si në marrëdhëniet me njerëzit e tjerë, ashtu dhe në familjen e tij ishte një shembull i shkëlqyer. Ajo ç'ka bie më shumë në sy është thjeshtësia dhe sjellja e tij tepër praktike. Shpesh herë, në ditët e sotme apo në kohët e shkuara syri ynë është bërë dëshmitar i shumë fenomeneve të cilat kanë bërë bujë në shoqërinë tonë. Por vëmë re se këto nuk bëjnë pjesë në asnjë qoshe të jetës së Profetit (a.s.)

Tipike për të ka qenë thjeshtësia dhe sjellja tepër modeste larg lustrimeve fallso. Profeti (a.s.) i përkushtonte një kujdes të veçantë barazisë ndërmjet grave të tij. Gjithmonë para se të shkonte në shtrat ose pas namazit të sabahut, ai i vizitonte të gjitha gratë e tija dhe i pyeste për nevojat apo për çdo lloj problemi që ato mund të kishin.

Në darkë kur hynte në dhomën e gruas që do të qëndronte atë natë, mbasi jepte selam, menjëherë lante dhëmbët me misvak. Më pas thërriste të gjitha gratë e tij dhe diskutonin së bashku. Zakonisht mbas namazit të jacisë nuk para flitej shumë, çdo kush largohej për të pushuar. Profeti (a.s.) mbasi

Profeti (a.s.) ka shumë shembuj nga jeta e tij që tregojnë se si ka shmangur dasinë mes bashkëshortësh dhe si është përkujdesur për shtimin e dashurisë

merrte abdes ulej në krevatin e tij (Ahmed b. Hanbel, Musned, VI, 85), bënte dua dhe mbasi të flinte për një kohë të shkurtër, ngrihej me kujdes për të mos e zgjuar bashkëshorten e tij, dhe me ujin e misvakut që ajo i përgatiste para se të flinte, merrte abdes dhe fillonte adhurimin e natës.

Për namazin e sabahut, para se të nisej për në mesxhid, falte në shtëpi synetin e namazit të sabahut, më pas zgjonte bashkëshortet e tija dhe pastaj shkonin në mesxhid.

*Si ishte jeta e Profetit (a.s.) brenda ambientit familjar?*

Të njëjtën pyetje i kanë drejtuar disa nga sahabet dhe ta-

binët Aishes (r.a.) Përgjigjja që jepte ajo ishte një shembull i thjeshtësisë dhe i të qenit praktik, gjë të cilën e thamë pak më sipër.

Ajo thoshte: Ai bënte atë që bën çdokush në shtëpinë e tij. Sistemonte rrobat e tij, rregullonte këpucët, milte delet dhe punën e tij e bënte vetë.

Në një transmetim që na vjen nga Ummu Seleme, Profeti (a.s.) kur dilte nga shtëpia bënte dua të cilat fillonin me "Me emrin e Zotit tek i cili mbështetem" (bismillah tevvekelu alallah)

*Një ambjent i mbushur me dashuri.*

Profeti (a.s.) për të forcuar lidhjet e dashurisë, si dhe për të shtuar afrimin ndërmjet bashkëshorteve gjithmonë përdorte metoda tepër modeste. Një ndër shembujt më të përshtatshëm për të treguar një pjesë të kësaj modestie është gara e vrapimit që Profeti (a.s.) ka bërë me Aishen (r.a.) në vitet e para të martesës së tyre.

Sipas transmetimit të Aishes (r.a.) : Profeti (a.s.) e kishte marrë me vete edhe Aishen në një nga udhëtimet e tij. Gjatë rrugës Profeti (a.s.) iu tha shokëve të tij që të vazhdojnë udhëtimin. Mbasi sahabet kishin ecur një pjesë të rrugës, i thotë Aishes (r.a.): A të bëjmë gara, o Aishe?

Aishja (r.a.) e pranoi me kënaqësi propozimin dhe bënë gara së bashku. Duke qenë se Aishja ishte më e re dhe energjike, e fitoi garën. Mbas disa vitesh gjatë një udhëtimi tjetër Profeti (a.s.) i thotë përsëri Aishes që të bënin gara.

Aishja (r.a.) duke kujtuar garën që kishte fituar më parë e pranoi propozimin përsëri me kënaqësi.

Bënë sërish gara, por këtë radhë ajo humbi, sepse sipas transmetimit të saj atë kohë ishte shëndoshur pak. Profeti (a.s.) duke qeshur i thotë: Ky është haku që të mora për garën e parë!

Kur Profeti (a.s.) ulej me Aishen (r.a.) për të ngrënë, më parë dëshironte që të hante e të pinte ajo e para, e më pas posaçërisht hante në vendin ku më parë kishte ngrënë Aishja (r.a.). Nëse hanin mish, merrte pjesën që kishte lënë Aishja (r.a.)

Profeti (a.s.) ka shumë shembuj nga jeta e tij që tregojnë se si ka shmangur dasinë mes bashkëshortësh dhe si është përkujdesur për shtimin e dashurisë.

### *Kush do ta takojë më parë?*

Le të përmendim edhe një shembull tjetër të Profetit (a.s.) për shakatë që bënte me bashkëshortet e tija. Na tregon Aishja (r.a.) se një ditë gratë e Profetit (a.s.) ishin mbledhur rreth tij dhe e pyetën: “O i dërguari i Allahut, mbas vdekjes tënde cila nga ne do të takohet më parë me ty? Profeti (a.s.) tha: Ajo që ka duart më të gjata ndër ju.

Aishja (r.a.) duke vazhduar tregimin e saj thotë: Morëm në dorë një kallam dhe filluam të matnim krahët, dhe mes nesh krahët më të gjata i kishte Sev-

de binti Zema. Më pas ne e kuptuam se “ajo që ka duart më të gjata” nënkuptohej ajo që jepte më shumë sadaka.

Më të vërtetë mbas vdekjes së profetit (a.s.) ishte Sevde ajo e cila ndërroi jetë, sepse ajo kishte dëshirë të jepte sa më shumë sadaka.

### *Shaka te hidhura!*

Sjellja e Profetit (a.s.) me gratë e tija bëhej në një formë tepër të dashur dhe praktike, prezenca e shakave modeste bënë të mundur krijimin e një ambienti të ngrohtë dhe të sinqertë brenda familjes së tyre.

Edhe në ditët kur Profeti (a.s.) kishte shqetësime nga sëmundja, nuk i kursente shakatë. Një ditë Profeti (a.s.) do të qëndronte te Aishja (r.a.) Në momentin kur hyri brenda në dhomë Aishja (r.a.) i kaloi një dhimbje e fortë në kokë dhe filloi të rënkonte.

-Oh koka ime...

Profeti (a.s.) megjithëse në atë kohë me të vërtetë ishte i sëmurë rëndë, i drejtohet Aishes duke i thënë: -Në fakt duhet të jem unë ai i cili rënkon! Sikur ti të vdis-

je para meje dhe unë me dorën time të të laja, të qefinosja dhe të falja namazin e xhenazes e më pas të të varrosja, nuk do të ishte më mirë? Aishja (r.a.) mbasi i dëgjoji këto fjalë tha: -Mjerë për mua ç'po më dëgjojnë veshët... Për Allah po filloj të mendoj se ti e dëshiron vdekjen time. Sikur unë të vdisja, ti në mbrëmjen e asaj dite, do të qëndroje me një nga gratë e tjera. Profeti (a.s.) filloi të buzëqeshte kur i dëgjoji fjalët e Aishes (r.a.)

### *Mëshira dhe toleranca e Profetit (a.s.)*

Në një ditë bajrami Aishja (r.a.) së bashku me dy vajza nga ensarët po zbaviteshin duke kënduar dhe duke i rënë deficit. Profeti (a.s.) për të mos i shqetësuar ato ishte shtrirë mbi minder dhe kishte mbuluar fytyrën. Atë moment vjen Ebu Bekri (r.a.) dhe kur e pa një gjendje të tillë, e qortoi të bijën duke i thënë: -Si mund të bësh gjëra të tilla në praninë e të dërguarit të Allahut. Atëherë Profeti (a.s.) ndërhyri duke i thënë Ebu Bekrit (r.a.):

-Lëri të qeta vajzat, o Ebu Bekir, le të zbaviten.

Përsëri në një ditë bajrami në mesxhidi nebevi po jepej një shfaqje me disa vallëzime tradicionale nga etiopasit. Profeti (a.s.) e kishte marrë me vete dhe Aishen (r.a.) për të parë këtë shfaqje. Këtë hadith të cillin e transmeton Aishja (r.a.) na këshillon duke thënë se do të ishte e dobishme që t'i merrnit vajzat e reja me vete në këto lloj shfaqesh, si dhe bëhuni të kuptueshëm ndaj tyre, sepse ajo e ka parë dhe jetuar vetë një sjellje të tillë nga Profeti Muhamed (a.s.).

Prezenca e shakave  
te sjellja modeste e  
Profetit (a.s.) bënë  
të mundur krijimin  
e një ambienti të  
ngrohtë dhe të  
sinqertë brenda  
familjes së tyre

# FAMILJA DHE NJERIU

**L**ibri hyjnor i Islamit, Kur'ani, tregon se jeta njerëzore mbështete në raportin reciprok mes gruas dhe burrit ku secili gjen tek tjetri qetësinë dhe dashurinë e kërkuar: “dhe nga faktet e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën, ashtu që të gjeni prehje tek ato, dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argument për njerëzit që mendojnë.”<sup>1</sup> Ashtu sikurse përmendet edhe në ajet, jeta e njeriut mbështetet mbi familjen. Patjetër që kjo jetë duhet të rregullohet mbi principet islame dhe vlerat e besimit. Mbajtja përherë gjallë e një jetë mbi baza Islame, si në familje ashtu edhe në elementet e tjera shoqërore mund të arrihet përmes devotshmërisë: “O njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën e saj dhe prej atyre të dyve u shtuan burra e gra.”<sup>2</sup>

Martesa e cila shprehet me termin “sunnet” sipas jurisprundencës islame, është një sjellje e na-

tyrshme e vendosur nga vetë Profeti. Kjo do të thotë që sipas Islamit, martesa nuk është fantazi apo privilegj i pakuptimtë, por një e drejtë dhe një kërkesë e natyrshme.

## Përkufizimi i familjes dhe proceset e saj të natyrshme

Familja e përbërë nga nëna-babai dhe fëmijët, e zgjeruar më tej përmes të afërmeve në një plan më të gjerë, përbën elementin bazë të gjithë shtresave të popullsisë. Roli kryesor i saj është “të arrihet vazhdimësia dhe miredukimi i brezave”, por për të arritur këtë nevojitet rregull dhe harmoni. Një familje e tillë mund të krijohet duke iu përmbajtur kushteve sociale, ekonomike dhe edukative. Familjet e ndërtuara mbi bazën e vlerave të larta si besnikëria, dashuria dhe sinqeriteti, bindja e vetëdijshme dhe morali i bukur janë garancia më e madhe e shoqërisë islame. Detyra kryesore dhe primare e një familjeje islame është: “Edukimi i njerëzve që besojnë Allahun pa asnjë dyshim dhe jetojnë pa i bërë shok Atij.” Kur'ani tërheq vërejtjen për rëndësinë e këtij problemi: “Kur Llukmani i tha të birit të vet: O djali im! Mos i

1. Rum, 21

2. Nisa, 1



Nuk ka asnjë kuptim të thuhet se muslimanët e vërtetë i përkasin së shkuarës. Sot ndihet nevoja për ekzistencën e shembujve të mirë të muslimanëve në çdo fushë të jetës

përshkruaj Allahut shok, sepse idhujtaria është padrejtësia më e madhe.”<sup>1</sup>

### Familja-Kala

Familja përmbush funksione të tjera të rëndësishme në jetën personale dhe atë shoqërore. Ajo ka një mision shumë të rëndësishëm në edukimin dhe mbajtjen nën kontroll të kërkesave dhe prirjeve seksuale. Përsëri ajo, si rezultat i martesës, siguron përmbushjen e këtyre kërkesave në rrugë të ligjshme dhe edukimin e një brezi, prejardhja e të cilit është e qartë. Familja është një kala mbrojtëse kundër një jete dëfrimesh. Është familja ajo e cila mund të realizojë dhe praktikojë vlerat e larta njerëzore si: dashuria, respekti, mëshira dhe sakrifica, të cilat mbeten format më të mira të shprehjes së natyrës së tij.

Familja e cila siguron klimën e përshtatshme që njeriu të fitojë personalitetin e tij, ta zgjerojë dhe ta maturojë atë më tepër, i përngjan një shkolle edukative. Kur’ani e tregon me këtë fjali kuptimplotë sa e rëndësishme është për njeriun familja e krijuar nga martesë: “... burrat janë mbulesë për gratë dhe gratë janë mbulesë për burrat.”<sup>2</sup> Ky ajet i konsideron burrat dhe gratë veshje për njëri-tjetrin. Siç dihet, veshja e mbulon dhe e zbukuron njeriun. Njeriu pa rrobë e ndjen veten të mangët dhe të pasigurt. Ideja e të qenit veshje për njëri-tjetrin e burrit dhe gruas arrihet përmes martesës, e cila i mbron bashkëshortët nga prostitucioni dhe i zbukuron atyre moralin.

Familja luan rol të rëndësishëm edhe në zhvillimin social. Është familja struktura e cila zgjerohet lidhjet fafëfisnore mes njerëzve dhe i kthen këto në mbështetje të ndërsjellë dhe solidarizim socio-ekonomik. Po ashtu ndihmon që brezat të njihen me vlera islame, si dhe ndihmon në zhvillimin e shëndoshë të ndryshimeve shoqërore. Ekzistenca e një strukture vlerësohet me ndikimin e saj.

Strukturat të cilat humbasin ndikimin në një aspekt nuk ekzistojnë fare.

### Sulmet kundër familjes

Në ditët tona familja përballet me disa sulme bashkëkohore. Sistemet joislame dhe strukturat e organizuara në këtë drejtim përbëjnë rreze të vazhdueshme që mund të lëkundin familjen që në themel. Veçanërisht ata të cilët, në kundërshtim me islamin, duke pandehur se mbrojnë të drejtat e gruas, në çdo rast mundohen ta tregojnë martesën si të dëmshme duke tentuar të zhdukin ndikimin e familjes.

Shumë njerëz të rënë në kurthin e djallit, të thurur nga ata që e përdorin gruan si mjet argëtimi, mund të bëjnë çdo gjynah duke rënë në kërkim të gjithçkaje joislame dhe në emër të modernizmit.

Veçanërisht strukturat edukative janë duke i sjellur rinisë vlera joislame dhe mundohen t’i shfaqin atyre një mënyrë jetese jashtë islamit.

Zhvillimet negative si tendenca për ta quajtur “modern” bashkjetesën dhe hedhja e slloganeve “liri seksuale” tregojnë para të gjithëve se në ç’nivel kanë arritur sulmet kundër familjes dhe rreziqet ndaj saj. Ata të cilët i kundërvihen islamit dhe propozimit të tij për martesë kërkojnë një liri të pakufi për ta përdorur gruan si mjet argëtimi.

Përkundër gjithë këtyre zhvillimeve negative muslimanët duhet të përpiqen të realizojnë çdo të vërtetë që flasin dhe besojnë; duhet të përpiqen të edukojnë breza që e duan Allahun (xh.sh.) dhe dëshirojnë të jetojnë një jetë mbi bazat islame. Kjo përpjekje duhet të nisë që në krijimin e një familjeje model islame.

Tashmë nuk ka asnjë kuptim të thuhet se muslimanët e vërtetë i përkasin së shkuarës. Sot ndihet nevoja për ekzistencën e shembujve të mirë të muslimanëve në çdo fushë të jetës. Sepse ajo çfarë përgatitet dhe realizohet sot dhe parapërgatit të nesërmen.

Ka ardhur koha të shihet dhe të thuhet e vërteta. Praktikimi i edukimit islam ka mbetur pezull si në familje ashtu edhe në elementet e tjerë social. Në këtë rast e para që kërkohet është të rishikohet familja si elementi kryesor ushqyes i shoqërisë dhe individit dhe të kthehet në strukturën që edukon njeriun islam duke i kthyer atij funksionet e natyrshme njerëzore.

1. Llokman, 13,7

2. Bakare, 187

# BISEDONI ME FEMIJET TUAJ

Një ditë mësova të heshtë. Heshta në atë mënyrë sa që heshtja ime mund të zgjaste deri në pafundësi.

**N**jë ditë mësova të heshtë. Heshta në atë mënyrë sa që heshtja ime mund të zgjaste deri në pafundësi. Heshtja në botën time të vogël ishte mënyra e komunikimit që kisha krijuar me babin tim.

Babai në darkë kthehej shumë i lodhur. Unë ngaqë rrija gjithë ditën në shtëpi mërzitesha dhe e prisja me padurim. Pa hyrë mirë brenda në shtëpi i hidhesha në qafë, e shtrëngoja fort dhe doja të luaja me të. Babi më përqafohte, më puthte dhe pastaj më thoshte: "Ik tani në dhomën tënde!"

Me përgatitjen e darkës mami na thërriste dhe ne bashkoheshim të gjithë rreth tavolinës. Kur flisnin me njëri-tjetrin, mendohe-

sha të flisja me zë të lartë që të më dëgjonin. Babi nevrikosej shumë dhe më thoshte: "Jam mërzitur gjithë ditën duke u marrë me njerëz, të paktën ti mos më nervozo". Si të mos mjaftonin fjalët e babait, më drejtohej mami duke më thënë: "Gjithë ditën e kaloj duke u marrë me ty dhe as tani nuk do na lejosh të ndërrojmë dy fjalë" dhe më dërgonte për në dhomë.

Duke ulur kokën i mërzitur drejtohesha drejt dhomës sime që tashmë më ishte bërë si burg. Babi akoma vazhdonte të thërriste dhe thoshte: "Ne asnjë dhomë tonën bile nuk e kemi pasur, ti ke gjithçka. Nuk e kuptoj se çfarë kërkon më tepër". Një zë brenda meje thoshte: "Ah sikur edhe unë të mos e kisha këtë dhomë, të kishim një shtëpi të vogël vetëm me një dhomë që të



Duke ulur kokën i mërzitur drejtohesha drejt dhomës sime që tashmë më ishte bërë si burg



Mami dhe babi ngelën të habitur.

Edhe sikur unë të flisja deri në pafundësi,  
ato sërish nuk do te reshtnin së dëgjuari.

gjithë të rrinim së bashku” por këtë nuk kisha guxim ta thoja me zë të lartë.

Babi pasi mbaronte se ngrëni shtrihej ne divan me telekomandën në dorë dhe shikonte televizor. Nganjëherë më thërriste afër dhe me ledhatonte pak. Ne qofte se kishte diçka të bukur në televizor, s’më lejonte të lëvizja nga vendi. Po të lëvizja sadopak, fillonte të thërriste me zë të lartë dhe unë i mërzhitur sërish kthehesha në burgun tim.

Një ditë kuptova që duke heshtur kuptohehim më mirë me babin. Dhe këtë herë fillova ta vrisja mendjen se çfarë mund të krijoja duke heshtur. Në fillim iu futa punës dhe fillova të vizatoj. Babit filluan t’i pëlqenin vizatimet e mia dhe më thoshte: “Ja kështu urtë e butë luaj”. Babi i shikonte me bisht të syrit vizatimet dhe dukej sikur donte të më pyeste diçka. Por tashmë nuk më dërgonte duke u nevrkosur në dhomë. Mami krenohej përpara fqinjëve duke u thënë se sa i zgjuar po tregohet këto kohët e fundit çuni.

Duke u shtuar vizatimet dhoma sa vinte e bëhej më rrëmujë. Mami duke më bërëtitur më thoshte: “Mblidhi këto gjëra!” Kur më mbyllte në dhomë, nuk dija nga t’ia nisja punës. Duke u marrë me këto kalonte koha, por unë nuk arrija që ta rregulloja dhomën mirë. Mami një ditë u fut në dhomën time dhe më tha: “Do të të ndaloj të vizatosh!” Nuk e di se çfarë mund të bëja tjetër sikur familja ime të më ndalonte të vizatoja.

Një ditë vizatova pjesëtarët e një familjeje. Me të ardhur babi në shtëpi u mundova

të gjeja kohën e përshtatshme. Si gjithmonë hëngrëm darkën dhe kaluam tek dhoma e ndenjes. Pa u ulur mirë babi, ia tregova vizatimin që kisha bërë. Pasi e shikoi më tha: “E paske vizatuar shumë bukur, padyshim ky burri këtu jam unë”!!

– Jo ky burri, por ky fëmija je ti - i thashë unë. Jo, tha ai, ky burri jam unë, ky djali je ti, ndërsa kjo vajza është një shoqe e jotja”. Dhe unë përsëri – Jo, ky burri këtu jam unë, ky djali i vogël je ti, ndërsa ajo vajza e vogël është mami.

Babi ngaqë nuk donte të merrej me mua dhe për të më hequr qafe më pyeti: “Po mirë atëherë, përse na ke vizatuar të vegjël?”

I emocionuar fillova t’ua shpjegoj.

Unë do të rritem dhe do të bëhem burrë. Do të gjej një punë dhe do të punoj. Ju do të plakeni dhe do të bëheni të vegjël përsëri. Do ju kërruset shpina. Unë kur të vij nga puna, do të jem i lodhur. Kur ju do të doni të bisedoni diçka me mua, unë nuk do t’u dëgjoj dot, sepse do ta kem kokën plot strese nga puna. Dhe kur ju do të doni të ndani diçka me mua, do ju them: “Shkoni në dhomën tuaj se më duhet të pushoj!” Dhe duke bërëtitur do ju them: “Çdo gjë ua kam blerë, dhomën e keni të ngrohtë, çfarë kërkoni më shumë?”

Mami dhe babi ngelën të habitur. Nuk po u besonin veshëve se çfarë po dëgjonin. Më afruan pranë tyre, më përqaftuan dhe duke më përkëdhelur me gjithë shpirt. Edhe sikur

# Kushtet dhe vendi i edukatës familjare



Në edukimin fillestar  
shëndetësor dhe  
fizik familja dhe  
posaçërisht nëna është e  
pazëvendësueshme

**"T"**ë gjithë ju jeni bari  
rinj dhe të gjithë ju  
do të pyeteni për  
kopenë tuaj; su-  
nduesi është bari

dhe do të pyetet për kopenë e vet; njeriu  
është bari në familjen e vet dhe do të pyetet  
për kopenë e vet; grua është bareshë në  
shtëpinë e burrit të vet dhe do të pyetet për  
kopenë e vet..."

Në kushtet e sotme problemet e edukimit dalin gjithnjë e më shumë në plan të parë. Tashmë si shoqëria, ashtu edhe familja po e kuptojnë seriozisht se krahas nivelit ekonomik dhe mirëqenies, krahas arsimimit dhe punësimit të breznive të reja, po duket qartë domosdoshmëria e një preokupimi serioz dhe me pikësynime të qarta edhe për problemet e edukimit. Vetë bërthama bazë e shoqërisë, familja, ka pësuar shumë të çara dhe është lëkundur mjaft këto

vitet e fundit. Familja shqiptare nga dita në ditë po pëson tronditje serioze, që vijnë si rrjedhojë e një mendjelehtësie për të përvetësuar ato forma jetese, gjoja përparimtare dhe të emancipuara që na i servir bota e huaj perëndimore, pa marrë aspak parasysh traditat tona, kushtet tona dhe mundësitë tona.

Vini re gjymtimet e familjeve, kur një pjesë e madhe e të rinjve janë në mërgim, vini re ndarjet e dhunshme të burrave nga gratë, të baballarëve nga fëmijët, qoftë edhe për arsye ekonomike, vini re abortet e shumta. Sipas statistikave të fundit njoftohemi se, çdo vit bëhen 46 milion aborte në gjithë rruzullin tokësorë, pra në Botë vriten rreth 126 mijë shpirt të pafajshëm në ditë. Ky fenomen ç'njerëzor ka depërtuar edhe tek populli ynë. Vetëm në maternitetet e Tiranës brenda dy ditëve janë bërë 400 aborte. Sipas klinikave private, pohohet se 70% e femrave që dështojnë shtatzaninë janë adoleshente.

Kjo rrjedh sepse ka një liri të frenuar të marrëdhënieve seksuale. Kështu psh 1 në 8 gjimnazistë ka një jetë aktive seksuale. Madje 10 % e tyre pas anketimit kanë pranuar se gjatë shkollës së mesme kanë pasur më shumë se dy të dashur. Natyrisht kur kjo ngjet me të rinjtë patjetër që edhe shumica e abordeve kryhen nga vajza të moshës shumë të re, që të mos themi të mitur. A thua vallë, këta të rinj kanë prindër? Kjo është gjendja e shqiptarëve në Shqipëri, aty ku komunizmi ka lënë gjurmë... aty ku fëmijëve nuk u flitet për Zotin, nuk u flitet për moral, nuk u flitet për Ditën e Gjykimit. E ç'pret tjetër kur humbet dashuria, respekti, e frika ndaj Zotit, i cili shpërblen të mirët (të moralshmit, të ndershmit), e i dënon të këqijtë (të pamoralshmit, të pandershtmit)!

Rrjedhimi është i qartë, e kjo duket në divorcet e shumta. S'ka dyshim se në raste konkrete shkukurorëzimi është alternativa e vetme për një jetë më të lumtur (në rast të tradhtisë, dhunës, apo moszgjedhjes së mirë, mashtrimit, etj.), porse shtimi i rasteve të divorceve dhe hovi i madh i dështimit të familjeve ka pasojë shumë të mëdha. S'ka dyshim se është shumë vështirë vendimmarrja për divorc për momentin që bëhet, porse akoma më vështirë është përballimi i sfidave që vijnë më pas, e sidomos në raste kur çiftet kanë edhe fëmijë. Rastet më të shpeshta të shkukurorëzimeve janë kur tensionet dhe konfliktet mes çiftit rriten, porse në shoqërinë tonë nuk mungojnë edhe ato raste kur të tjerët ndikojnë në prishjen e lumturisë bashkëshortore. Fëmijët duan dashurinë e prindërve, ata duan që të rriten me ta. Dashuria si në familje dhe bashkëshortësi, e shoqëri, është shkak e faktor kyç për arritjen e lumturisë. Mirëpo kjo dashuri nuk mund t'i thithet nga fëmijët nëse prindërit ndahen. Kohëve të fundit pranë Gjykatës së Tiranës bëhen nga 6-të kërkesa në ditë për zgjidhje martesë, e që prej fillimit të vitit 2007 deri në prill janë shënuar 580 padi të tilla. Në qytete tjera nuk shkon ditë pa mos pasur nga një ndarje të paktën. Thuajse më shumë se gjysma e fëmijëve në "vendet e teknologjisë e të kompjuterëve" që ne i kemi ëndërr, jetojnë pa një prind, e nuk mund ta arrijnë kënaqësinë dhe ngrohtësinë prindërore. Prandaj ruajtja e mirëqenies bashkëshortore duhet të jetë parim i çifteve, në mënyrë që fëmijët e tyre të jenë të lumtur në jetë. Por ka edhe raste më të vështira kur fëmijët braktisen.

Ka shumë raste të martesave me të mitura, pa përmendur këtu plagët e

rënda të drogës, të alkoolizmit e të shumë sëmundjeve tjera shoqërore, që në radhë të parë prekin e dëmtojnë familjen.

Asnjë këshillë nuk vlen për këtë si mjet shpëtimi. Çdo rast është një dukuri më vete specifike dhe do të zgjidhet nga vetë ajo familje, nga vetë ai prind, nga vetë ai fëmijë që po rritet dhe është futur në rrugën e vështirë të jetës. Tradita edukative familjare, përvoja e shkollës, mjetet e shoqërisë janë të shumta, por për fatin tonë të keq për një kohë të gjatë këto u ndanë, mohuan dhe nënvleftësuan e madje përçmuan mjetet që na ofron besimi, feja jonë Islame. Në shumë raste edukata familjare e në përgjithësi edukata shoqërore me të gjitha mjetet që ajo ka në dispozicion, iu kundërvu edukatës fetare dhe traditës që ajo kishte krijuar, e luftoi dhe në vend që të merrej me zgjidhjen e problemeve edukative që po krijoheshin, luftonte ndikimin e traditave dhe të riteve fetare aq të dobishme në fushën e edukatës së fëmijëve. Ky problem nuk është kapërcyer, gjallon edhe sot e kësaj dite. Puna që bëjnë shumë institucione fetare, propaganda dhe kultura fetare nënçmohet e madje në shumë raste është në kundërshti me një tendencë gjoja liberalizimi që duket sot në familjen, në shoqërinë dhe në kulturën shqiptare e që për fatin tonë të keq është institucionalizuar edhe nga mjetet shtetërore të edukimit. Vini re sjelljen morale të të rinjve, qëndrimin ndaj së mirës dhe së keqes e dukurive tjera të ndjenjave dhe cilësive morale, vini re veshjen dhe paraqitjen e jashtme të breznive të reja e sidomos të vajzave, qëndrimin ndaj alkoolit, ndaj duhanit, ndaj drogës, ndaj sjelljes qytetare, ndaj të të moshuarve e ndaj familjes në përgjithësi, vini re ashpërsinë dhe egërsinë e njerëzve e sidomos të meshkujve në veçanti. Të gjitha këto e shumë të tjera si këto e kanë rrënjën në edukatën familjare që do ta kemi objekt tonin.

### Objekti i pedagogjisë familjare

Pedagogjia familjare si degë e pedagogjisë së përgjithshme ka një objekt të gjerë. Ajo përfshin problemet e përmbajtjes së edukatës në familje, parimet e organizimit të saj, mjetet, metodat dhe format e punës edukative, lidhjet e familjes me të gjitha mjetet e institucionet edukative, veçorinë e punës edukative, kërkesat ndaj prindit si

Më shumë se në  
familje nuk mund  
të luftohen disa  
vese të këqija,  
si: parazitizmi,  
përtacia,  
kryeneçësia, etj.

edukator etj. Familja është një organizëm edukativ që i zgjidh detyrat e veta të posaçme duke bashkëvepruar me të gjitha mjetet tjera që ka në dispozicion shoqëria.

### Vendi i edukatës familjare

Në mendimin pedagogjik botëror ka pikëpamje të ndryshme lidhur me vendin që zë edukata familjare dhe për rolin që luan ajo në të gjithë sistemin e edukimit të brezit të ri. Dy janë pikëpamjet themelore:

**Drejtimi i parë**, e ngre rolin e edukatës familjare mbi të gjithë faktorët tjerë duke theksuar se interesi i prindërve dhe i familjes në edukim është parësor dhe vendimtar, madje arrihet deri në atë shkallë sa të minimizohet roli i shkollës dhe i institucioneve tjera. Edhe në vendin tonë ka tendenca të tilla për të shmangur në një farë mënyre rolin e shkollës, mësimin në kushtet e klasës me mësimin individual të organizuar në shtëpi nga prindi apo nga mësues privatë. P.sh. Ka filluar në mënyrë disi masive mësimi i gjuhëve të huaja me mësues privatë, në shumë raste edhe paralelisht me atë që bëhet në shkollë. E jo vetëm për gjuhët e huaja, por edhe për disa lëndë si matematika etj. Natyrisht shkalla e lartë e interesimit të prindit për ngritjen kulturore të fëmijëve është një tendencë shumë e dobishme, por nuk mund të shkojë në drejtim të kundërt me shkollën, ta nënvleftësojë dhe ta minimizojë rolin e saj. Në aspekte tjera të edukimit kjo tendencë është edhe më e dukshme. P.sh. në fushën e edukimit moral. Në disa fusha të edukatës prindi dhe familja i kundërvihen shkollës

dhe madje edhe shumë mjeteve tjera të komunikimit masiv. Kjo jo thjesht për dobësi të përmbajtjes së punës së këtyre institucioneve, por në kundërshti, në mospërputhje konceptesh dhe pikëpamjesh.

**Drejtimi i dytë**, përpiqet ta minimizojë rolin e familjes dhe të mbivlerësojë edukimin jashtë ndikimit të prindërve. P.sh. vlerësohet ndikimi i mikromjedisit, si ai i shoqërisë së rrugës, shokët e shoqet e fëmijës. Disa të tjerë vlerësojnë rolin e shkollës dhe të mësuesve si specialistë të punës edukative me fëmijët etj. etj. Jo vetëm moralisht, por edhe ligjërisht, gjithnjë edhe sot prindi përgjigjet për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve. Tagret e prindit e të familjes për mirërritjen e fëmijës janë një problem më vete, por këtu duam të theksojmë se në shumë llojshmëri e faktorëve që ndikojnë në edukimin e breznive të reja, familja është një faktor shumë veprues dhe se në etapa të veçanta të moshës së fëmijëve dhe për probleme të veçanta luan një rol vendimtar. Kjo shpjegohet po të kemi parasysh disa arsye:

**Së pari**, kur familja ngrihet mbi baza të shëndosha, kur krijohet një atmosferë e shëndoshë familjare me marrëdhënie të drejta mes pjesëtarëve të saj, e sidomos mes nënës e babës, fëmijëve dhe prindërve; kur ekziston rregulli dhe respekti në marrëdhëniet mes pjesëtarëve të familjes, kur ndërgjegjia e prindit për edukimin e fëmijëve është e një shkalle të lartë e kjo shoqërohet me rritjen e interesit për edukim e me kujdesin e nevojshëm në këtë fushë, natyrisht e shoqëruar me traditën e mirë familjare, me kulturën dhe përvojën e nevojshme, me nivelin e kënaqshëm material dhe komfortin familjar. Në të gjitha këto rrethana edukimi i fëmijëve në familje gjen kushtet e përshtatshme dhe niveli i punës rritet e si rrjedhim frytet nuk vonojnë të duken. Shtysat e para dhe shpeshherë vendimtare në fushën e edukatës fëmija i merr në familje.

**Së dyti**, familja ka përparësi në disa fusha dhe drejtime të edukatës, sepse ka kushte shumë të natyrshme edukative. Bashkëjetesa, marrëdhëniet mes prindit dhe fëmijës, lidhjet e gjakut krijojnë kushte për një afërsi të natyrshme mes pjesëtarëve të familjes. Si rregull kjo afërsi ruhet për të gjithë

jetën, prandaj autoriteti i drejtë, interesimi i prindit, përvoja jetësore dhe dashuria prindërore bëhen një faktor shumë i rëndësishëm ndikues në edukatë.

Në arsimimin dhe në formimin e përgjithshëm të fëmijëve shkolla luan rol kryesor dhe drejtues me planet dhe programet e veta mësimore. Roli i familjes në këtë drejtim padyshim është ndihmës. Por në edukatë ka pamje të tilla, ku përparësia e prindit dhe e familjes dalin në pah më shumë se shkolla. Në edukimin fillestar shëndetësor dhe fizik familja dhe posaçërisht nëna është e pazëvendësueshme, gjithashtu në edukimin e disa cilësive morale. Në një hadith Hazreti Muhamedi a.s shprehet: "Nën këmbët e nënës është xheneti". Nëna me dashurinë e saj që e ka burimin tek amësia, i mëkon fëmijës së vet së bashku me qumështin e gjirit ndjenja të tilla, si: butësia, dashuria, mëshira, zemërgjerësia, dhembshuria etj. Ajo i drejton fëmijët në rrugën e vështirë, por të sigurt, drejt xhenetit.

Po kështu ngjet në zhvillimin fillestar intelektual dhe të a folur. Cila shkollë mund ta zëvendësojë familjen në përpjekjet e para për belbëzim që zhvillohen tek fëmija? Fëmija futet në klasën e parë me një sistem të plotë zhvillimi të aftësive shprehëse gjuhësore. E natyrisht shkolla këto i mbreh dhe i përpunon në të gjitha strukturat e veta. Më shumë se në familje nuk mund të luftohen disa vese të këqija, si: parazitizmi, përtacia, kryeneçësia, etj. Një fëmijë që nuk merr në familje shprehitë e para për kulturën dhe disiplinën e punës, do të vuaj tërë jetën, sepse edhe disa veprime krejt të thjeshta, që dikush i kryen me një frymë, atij do t'i duken tepër të rënda e të mërzitshme. E mendoni se ka plot fëmijë deri në një moshë relativisht të lartë shkollorë që nuk dinë të ushqehen, të vishen e të mbathen vetë, e jo më të kryejnë punë për veten e të tjerët.

**Së treti**, puna edukative në familje ka vazhdimësi më të madhe në krahasim me çdo mjet tjetër edukimi. Ndikimi i saj fillon që në moshë të njomë, kur hidhen themelet e edukatës, vazhdon gjatë të gjithë periudhës që fëmijët ndjekin shkollën, madje edhe më vonë. Në kushte të tilla puna e prindit ka vazhdimësi më të madhe se sa puna

e mësuesve dhe e edukatorëve të çdo kategorie shkolle.

Fëmijët janë dhunti nga All-llahu xh. sh. Pra këtë dhunti prindërit duhet ta kenë amanet i cili duhet kultivuar, duhet edukuar, duhet përgatitur për jetën që ata i pret. Për këtë All-llahu xh. sh. prindërit i urdhëron: "O ju që besoni! Ruani veten dhe familje tuaja nga zjarri." (Kur'ani: Tahrim, 6)

*"Është dëshirë e përjetshme e baballarëve të shohin të realizuar tek bijtë e vet dy jetë, atë që u takon vetë bijve dhe atë që kanë lënë pa realizuar në jetë vetë baballarët",* -thotë shkrimtari dhe filozofi i shquar gjerman **Gëte**. Pikërisht këtu qëndron edhe thelbi i edukatës familjare, parimet themelore të saj. Detyra kryesore e kësaj edukate është rritja dhe edukimi i mirë i fëmijëve. Të rinjë u takon e ardhmja. Ata do të jetojnë në periudha më të përparura, prandaj edhe duhen përgatitur më mirë, duhen aftësuar për të përballuar detyrat dhe punët e së ardhmes që do të jenë gjithnjë e më të vështira, sepse zhvillimi e përparimi kërkon njerëz më të aftë.

Fëmijët do të jenë qytetarët e ardhshëm të vendit, ata do të jenë nënat e baballarët e rinj. Fëmijët tanë janë edhe shkopi i pleqërisë. Edukimi i mirë i tyre është edhe pleqëria jonë e lumtur. A ka kënaqësi më të madhe sesa të kesh fëmijë të denjë, trashëgimtarë të devotshëm të traditave më të mira të besimit islam, të familjes dhe të prindërve? Nga tradita Pejgamberike e **Hazreti Muhammedit** a.s. mësojmë: "Fëmijët e edukuar mirë janë një kapital i madh dhe pasuria më e mirë. E kush ka fëmijë të miredukuar nuk duhet t'i frikësohet varfërisë në pleqërinë e vet. Fëmijët e rritur të edukuar janë pensioni më i mirë". Përndryshe rezultatet do të jenë të dyshimta, sepse fëmijët e edukuar keq janë hidhërimi ynë. A ka fatkeqësi më të madhe se sa të kesh fëmijë të edukuar keq? Mendoni sa lot derdhin ato nëna, kur shohin tek bijtë e vet sjellje të padenja. Çdo njeri mund të gabojë, madje edhe mund të bëjë një punë keq, por e kupton gabimin dhe e ndreq atë. Po mendoni të edukosh keq një njeri, sesa e vështirë është, në mos e pamundur të ndreqet. Disa vese të këqija, një karakter i keq duan përpjekje të mëdha për t'u riedukuar. Edukimi i keq nuk është vetëm hidhërimi i pleqërisë, por edhe përgjegjësi para Allahut xh.sh.,

*"Është dëshirë e përjetshme e baballarëve të shohin të realizuar tek bijtë e vet dy jetë, atë që u takon vetë bijve dhe atë që kanë lënë pa realizuar në jetë vetë baballarët"*

para njerëzve të tjerë, para shoqërisë, para atdheut, prandaj edhe ka norma morale e detyrime ligjore para prindit. Ata janë përgjegjës për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve të vet.

Baballarët, prindërit kanë përvojë të gjatë jete, kanë kaluar shumë prova, kanë pasur suksese në jetë, por edhe dështime, prej të cilave kanë nxjerrë shumë mësim, prandaj edhe, kur shohin një veprim të gabuar në jetën e fëmijëve të vet, ata mundohen e përpiqen t'i mbrojnë nga e keqja, nga dështimet, përpiqen t'i këshillojnë, t'i urdhërojnë e t'i ndalojnë për të mos rënë në vorbullën e jetës, grushti goditës i së cilës shpesh është i rëndë dhe ka peshë të dyfishtë për këtë jetë dhe për në amshim. Prindërit jo rrallë janë të pakënaqur nga qëndrimet dhe veprimet e bijve, prandaj edhe ka mospërputhje e kundërshti mes brezit të vjetër dhe brezit të ri, mes etërve dhe bijve. Nuk duhet harruar se bijtë kanë jetën e vet, ata kërkojnë ta jetojnë dhe të formojnë përvojën e vet në rrymat e jetës. Nuk duhet harruar se ndonjëherë kujdesi i tepruar i prindërve kthehet në një tutelë që shpesh herë paraqet rreziqe. Prindi në emër të edukimit i fut fëmijët, si të themi nën sqetull, i mëkon, ua shtron rrugën e ata rriten si në serat e ngrohta. E, sa fillojnë të dalin në ajër të pastër thyhen nga vështirësitë më të vogla. Një gjë ka rëndësi, fëmija që në moshën më të njomë duhet të stërvitet të masë forcat e veta, duhet të dijë sesa është i zoti të bëjë, sa i vlen lëkura.

# Edukimi i brezave

Edukimi është arti i pashoq që formon njeriun, e përgatit atë për të ardhmen duke e zhveshur nga të këqijat dhe gabimet për të arritur shkallët më të larta të aftësisë njerëzore

**E**dukimi është arti i pashoq që formon njeriun, e përgatit atë për të ardhmen duke e zhveshur nga të këqijat dhe gabimet për të arritur shkallët më të larta të aftësisë njerëzore.

Islami gjithnjë ka paraqitur principet dhe parimet që kanë lidhje me çdo veprim tonin. Pikërisht në mesin e këtyre parimeve, principeve me një rëndësi të veçantë shpaloset edukimi njerëzor.

Njeriu meqë është krijuar në mënyrën më perfekte, është i denjë për t'u quajtur krijesa më e nderuar. Në Kur'an tregohet hapur se bimët, gjallesat, kafshët, materialet nëntokësore janë krijuar në shërbim të njeriut. Përsëri që njeriu të arrijë të gjejë rrugën e drejtë, i janë paraqitur mrekullitë e pejgamberëve, ngjarje dhe histori nga të cilat mund të marrë mësim. Të gjithë këto, jo më kot por me një qëllim të caktuar për të kuptuar thesarin e të fshehtës: "Më i larti nga ju është ai më i devotshmi..."

Kjo e fshehtë nuk arrihet vetëm me adhurim, padyshim që myslimani bashkë me adhurimin duhet të jetë zot i fjalës në çdo fushë të jetës, në çdo profesion që është në shërbim të njerëzimit. Ky individ në çfarë do fushë të jetës, le të jetë gjeni, ...asnjëherë nuk duhet të harrojë faktin që...të Allahut jemi dhe tek Ai do kthehemi. Këtu qëndron edhe dallimi mes një myslimani dhe një jomyslimani. Më i miri nga ne është ai i cili pasurinë, diturinë, zgjuarsinë, aftësitë i përdor si mjet për edukimin njerëzor e jo për

mburrje tek të tjerët.

Qëllimi i edukimit në Islam është largimi i njeriut nga hilet e shejtanit, egos, duke e udhëzuar drejt rrugës së të shpëtuarve.

Në rruzullin tokësor në këtë detyrë të rëndësishme si shembulli më i suksesshëm është vula e edukuesve, Muhamedi (a.s.), megjithëse nuk dinte shkrim dhe këndim, ai ishte edukuar nga ana e Allahut. Ai i gjendur në një popull, në një shoqëri primitive si arabët të cilët ishin të dhënë pas grave, pasurisë, pijeve alkoolike, bixhozit...me forcën edukuese i nxori nga kjo errësi duke i drejtuar kah drita, rruga e drejtë. Në mes të kësaj shoqërie primitive kishte persona që para islamit nuk zotëronin asnjë aftësi... por pasi u bënë pjesë e edukimit të Profetit (a.s.), arritën nivele të larta profesionale si nga ana fetare, shkencore ashtu edhe në drejtimin e organizmave të larta shtetërore.

Çdo qytetërim, çdo sukses marrramendës është vepër e njerëzve të edukuar dhe të ditur. Ky parim ishte i skalitur si në mendjen ashtu edhe në zemrën e Profetit (a.s.) dhe shokëve të tij. Ata ishin të vetëdijshëm dhe e vlerësonin çdo individ i cili kishte fituar përvojë dhe ishte specializuar në një fushë çfarëdo të jetës.

Për ta kuptuar më mirë rëndësinë e edukimit të brezave po u përcjellim edhe dy shembuj nga jeta e shokëve të Profetit (a.s.).

Në kohën kur Umeri (r.a.) ishte kalif, në një mbledhje të zhvilluar me të parët e vendit, iu drejton këtë pyetje pjesëmarrësve: - "Nëse

dëshirën tuaj do ta pranonte me njëherë Allahu, çfarë do i kishit kërkuar?"

Njëri nga të pranishmit: - "Do dëshiroja një fushë të tërë të mbushur me ar që ta harxhoja në shërbim të Islamit."

Një tjetër: - "Do dëshiroja kullota të mëdha, që kur të vij vendi dhe koha t'i harxhoja në shërbim të islamit."

Të gjithë të pranishmit shprehën dëshira dhe kërkesa të ngjashme me to, por Hz. Umerit nuk i pëlqeu asnjëra. Të habitur nga kjo të pranishmit i drejtohen kalifes: - "Po ti, o Umer çfarë do dëshiroje?"

Përgjigjia e Hz. Umerit (r.a.) është një shembull i pashoq për rëndësinë që i kushtohet njeriut të edukuar.

- "Unë do dëshiroja edukimin e njerëzve si Salim, Ebu Ubejde dhe Muadhi nëpërmjet të cilëve t'i shërbeja islamit."

Në kohën e kalifatit të Hz. Aliut (r.a.) përçarjet mes njerëzve nuk kishin të mbaruar. I shqetësuar nga ngjarjet e dhimbshme që po ndodhnin si lufta mes myslimanëve, një kalimtar e pyeti Hz. Aliun: - "O Ali! Pse kaq shumë përçarje të cilat nuk ekzistonin në kohën e Hz. Ebu Bekrit (r.a.) dhe Hz. Umerit (r.a.), po ndodhin në kohën kur ti je kalif?!"

Ja përgjigjia shumë e goditur e Hz. Aliut (r.a.):

- "Në kohën e kalifatit të Hz. Ebu Bekrit dhe Hz. Umerit (r.a.) këto ngjarje nuk ndodhnin, sepse në atë kohë ishim ne...por në kohën tonë nuk janë ata!"



**N**jë e vërtetë historike  
Poligamia në histori

Në historinë e njerëzimit poligamia ka një të kaluar të gjerë. Ajo është e lidhur ngushtë me faktorët e jashtëm, si: mënyra e të jetuarit e popujve, traditat dhe kulturat e tyre, proporcioni i popullsisë burrë-grua, mundësitë dhe nevojat ekonomike, statusi shoqëror dhe kushtet gjeografike. Dihet se ajo ishte e praktikuar në shumë popuj që nga Babilonia dhe Egjipti i Lashtë deri tek athinasit, indianët, persët, turqit, sllavët, germenët dhe anglosaksonët. Në ligjet e Hamurabit martesë e dytë u pranonte me kushte të caktuara. Poligamia është e lejuar edhe në fetë e Lindjes si në Brahmanizëm dhe në Zoroastrianizëm.

Në Hebraizëm dhe në Krishterizëm nuk ka ndonjë ligj që e ndalon poligaminë. Në Dhiatën e Vjetër tregohet se Hz. Ibrahim<sup>1</sup>, Hz. Jakubi<sup>2</sup>, Hz. Davudi<sup>3</sup>, Hz. Sulejmani<sup>4</sup> dhe disa profetë

të tjerë të Beni Israilëve<sup>5</sup> ishin me shumë gra, këtë e vërteton edhe Kur'ani Famëllartë<sup>6</sup>. Në Hebraizëm, praktikimi i poligamisë ka vazhduar deri në Mesjetë. Martesa me shumë gra u ndalua në shekullin XI nga Rabbi Gershom edhe pse nuk kishte ndonjë gjykim ndalues as në Dhiatën e Vjetër dhe as në Talmud. As në Ungjill nuk gjendet ndonjë shprehje e qartë që e bën të ndaluar poligaminë. Martin Lutheri e ka thënë hapazi se poligamia lejohet.

Poligamia edhe tek arabët në periudhën para Profetit Muhammed a.s. kishte një praktikë të gjerë dhe nuk kishte ndonjë kufizim në numrin e grave për t'u martuar. Ngaqë fuqia e fiseve dhe e familjeve, në plan të parë, mbështetej në popullsi, poligamia ishte një rrugë që shtonte forcën dhe që zëvendësonte popullsinë e humbur në shkaqe luftërash. Përveç kësaj, tek arabët vendas dhe tek ata nomadë (beduinë) të atëhershëm, martesë me shumë gra ishte një rezultat i mënyrës së jetesës së tyre, i proporcioneve të popullsisë burrë-grua, i traditës dhe

kulturës së tyre. Madje, martesë me shumë gra pranohej si simbol i forcës dhe i pasurisë. Kurse martesë me një grua simbolizonte dobësinë dhe varfërinë. Për këtë arsye, poligamia në popull konsiderohej si mjet nderi dhe krenarie.

Poligamia në kohën e Profetit Muhammed s.a.s.

Në kohën e Profetit s.a.s. vërejmë se kishte plot tradita çrregulluese që me ardhjen e Islamit këto u ndaluan kategorikisht ose gradualisht, si; varrosja për së gjalli e vajzave foshnjë, prostitucioni, dhihar, alkooli, etj..

Një nga traditat e arabëve ishte edhe poligamia. Siç e cekëm dhe më lart ky fenomen nuk ishte vetëm në gadishullin arabik por edhe gjetkë, sepse femra trajtohej përherë si një objekt i krijuar për mashkullin. Atyre nuk u jepej vlerë dhe të drejtat i kishin shumë të kufizuara në popull. Ja se si e shpjegon Omeri r.a. i cili qante sa herë që i kujtohej se si kishte varrosur vajzën e tij për së gjalli:

*"Para Islamit, ne burrat nuk u jepnim vlerë fare grave. Kur erdhi Islami; Kur'ani foli në lidhje me*

1. Bibla, Zanafilla, 16/1-4

2. Bibla, Zanafilla, 29/20-30; 30/3-6

3. Bibla, Samuel II, 5/13-16

4. Bibla, Mbretërit I, 11/3

5. Bibla, Eksodi, 18/2-4

6. Kur'ani, Rad, 38

*'to. Vërejtëm se edhe ato paskan të drejta.'*<sup>1</sup>

## Poligamia në Kur'an

Që të gjykohet drejt mbi faktet historike duhet të përdoret një hermeneutikë e kujdesshme. Pra, që të nxirret një konkluzion i drejtë nga Kur'ani duhet "të shkohet" në kohën e zbritjes së tij, të vërehen mirë kushtet sociale dhe politike, traditat dhe botëkuptimi i arabëve të shekujve VI, VII. Martesa me 10-15 gra quhej krejtësisht normale. Me zbritjen e versetit 3. të sures Nisa, Kur'ani ua kufizoi mundësinë e martesës deri me katër gra dhe ua lidhi këtë "liri" me kushtin e drejtësisë ("*nëse frikësoheni padrejtësisë...*"<sup>2</sup>). Dhe ky pra, po të shikojmë mirë, është një rast që tregon se tek ai popull ishte rrënjësor kjo traditë dhe që të mos shkonte pa sukses mesazhi hyjnor apo me një shprehje tjetër, që të mos kishte reaksion nga populli, këtë ua la të lirë, por me kusht.

Le t'i hedhim një sy më konkretisht pjesës kuranore që bën fjalë për poligaminë:

*"Nëse frikësoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj bonjakëve, atëherë martohuni me ato gra që ju pëlqejnë; me dy, tri e me katra. E nëse i frikësoheni padrejtësisë ndaj tyre merreni vetëm një ose t'ju mjaftojnë ato që keni nën pushtetin tuaj. Kjo është më e përshtatshme për ju që të mos i ndaheni drejtësisë"*<sup>3</sup>

Para së gjithash, nga ky verset duhet të kuptojmë se më shumë se nxitje për poligami, është me përmbajtje për të drejtat e jetimëve. Komentatorët e Kur'anit, si: Ibn Kethiri, Zemahsheri, Teberi, Xhelalejnët, S.Kutubi, Mevdudi, Sabuni, etj, nga ky verset nxjerrin një konkluzion të tillë: "*Nëse je i zoti të bëhesh i drejtë, mund të marrësh deri katër gra*". Po mirë, shtrohet pyetja, a mundet një burrë të bëhet i drejtë,

të, të sillet njëlloj me disa gra? Kur'ani tek e njëjta sure e kthen këtë përgjigje "*Sado që të përpiqeni, ju kurrsesi nuk mund ta mbani drejtësinë mes grave...*"<sup>4</sup> Për çfarë drejtësie bëhet fjalë vallë? Komentatorët, fjalën "drejtësi/adale" që kalon në këtë verset, e kanë kuptuar si një drejtësi materiale. Pra, "*nëse je i zoti t'u ndash të njëjtën pasuri*". Kjo gjë

Myslimanët  
e parë ky  
verset i bëri  
të reduktojnë  
numrin e grave  
dhe nuk nxiti  
për të shtuar  
numrin e grave  
nga një në katër

edhe pse mund të jetë e vështirë, nuk është se s'bëhet. Por mesa duket këtu bëhet fjalë për një drejtësi më absolute, më abstrakte dhe shpirtërore që është "dashuria". "*Nëse je i zoti t'u ndash të njëjtën dashuri atyre, atëherë mund të marrësh edhe dy edhe tre edhe katër, por kjo gjë ngaqë nuk është e mundur, martohu vetëm me njërën*". Nëse lexojmë me kujdes edhe versetet e tjerë që bëjnë fjalë për këtë temë dhe për lidhjet burrë-grua si; Nisa:127, Rum:21, Bekare:187, Fatir:11, etj.. ashtu sikurse vihet në dukje tradita e skllavërisë që Zoti nuk e ndaloi direkt por e nxiti përherë që t'u zhdukte kjo gjë, po ashtu del në pah edhe fakti

se vetë Kur'ani "u mundua" të ndalojë traditën e poligamisë të asaj kohe dhe njerëzit t'i drejttojë në një jetë të lumtur. Një gjë tjetër që duhet të bëjmë kujdes kur gjykojmë rreth "versetit të poligamisë" (Nisa, 3) është edhe qëllimi i këtij verseti, të cilin mund ta kuptojmë qartë tek efekti që bëri pasi u shpall; myslimanët e parë ky verset i bëri të reduktojnë numrin e grave dhe nuk nxiti për të shtuar numrin e grave nga një në katër.

Martesa me një grua është traditë e Profetit tonë Muhamedit s.a.s.. Rininë deri në moshën 25 vjeçare ai e kaloi i vetëm. Pastaj duke i pasur të gjitha mundësitë të martohet me një grua tjetër pas martesës me Hz. Hatixhen (e cila ishte 15 vjet më e madhe se ai), deri kur vdiq ajo, Muhamedi a.s. jetoi vetëm me atë. Ja pra, kjo traditë profetike mbi 50 vjeçare është shembull për çdo mysliman.

Madje, i Dërguari i Allahut pas vdekjes së bashkëshortes së tij Hatixhes r.a. për mallin që ndjente ndaj kësaj zonje fisnike dhe të ndershme, afro tre vite i kaloi në vetmi dhe për një periudhë kohore të caktuar nuk u martua. Nuk i la fëmijët e tij në duar të njerks. Më pas, në Medine, kur në shtëpinë e tij nuk kishte ndonjë fëmijë të vogël, Muhamedi s.a.v. u martua me Aishen r.a. Nëntë apo dhjetë vitet e jetës që i ngelën i plotësoi me këtë zonjë, edukata e së cilës ishte shembull për të gjithë. Të gjitha martesat e tjera, jashtë këtyre të dyjave, kanë shkaqe politike dhe sociale të lidhura me realitetin e kohës, vendit dhe rastet e veçanta.<sup>5</sup>

5. Psh. Që t'i mbante gratë sahabe që ishin besimtare të singerta dhe që iu kishin vdekur bashkëshortët (si; *Sevde bint Zem'a, Zejnep bint Huzejme, Hint bint Ebu Umejje*).

Që të ishin nismëtare për t'i ndryshuar botëkuptimet e gabuara të rrënjësura tek arabët (si; *Zejnep binti Xhahsh*).

Të miqësohej me të parët e sahabëve, me fiset e vjetra arabe dhe me popujt fqinj që të mundësohej uniteti islamik (si; *Hafsa bint Omer b. Hattab, Ummu Habibe bint Ebu Sufjan, Safijje bint Hujej*).

1. Buhari, Libas, 31

2. Kur'ani, Nisa, 3

3. Kur'ani, Nisa, 3

4. Kur'ani, Nisa, 129

# Jetimët

Atëherë detyra e çdo myslimani pasi t'i kryej farzet dhe të largohet nga mëkatet, duhet të jetë i dobishëm për bashkësinë njerëzore duke i dal për zot me mënyrat nga më të ndryshmet

**A**llahu i Lartmardhëruar thotë:  
Pra, mos e përul jetimin, as ly-pësin mos e për-zë! (Duha, 9-10)

-A e ke parë ti (a e sheh) atë, që përgënjeshton përgjegjësinë dhe llogarinë në botën tjetër? Po ai është që e përzë në mënyrë të vrazhdë jetimin. Dhe që nuk nxit për ta ush-quer të varfrin. (Maun,1-3)

-Të pyesin ty për jetimët. Thuaj: "Po t'i ndihmoni në punët e tyre është më mirë, e nëse i përzeni (pasurinë e tyre me tuajën), ata janë vëllezërit tuaj. All-llahu di të dallojë qëllimkeqin nga që-llimiri. (Bakara, 220)

-Jetimëve jepuni pasurinë e tyre (kur të rriten), dhe mos e ndërroni të pastërtin (ma-llin tuaj që e keni hallall) me të ndytin (me haramin) edhe mos e hani pasurinë e tyre (të përzier) me pasurinë tuaj, se ky është mëkat i madh. (Nisa, 2)

Transmetohet nga Sehl b. Sad (r.a.) se i Dërguari (a.s.) ka thënë: "Kush sillet mirë me djaln apo vajzën jetime që i ka nën kujdestari, do të jetë bashkë me mua në xhenet." (Buhari)

Gjithashtu transmetohet prej Ebu Hurejres (r.a.) se Pro-feti (a.s.) ka thënë: "Ai i cili e merr përsipër, kujdeset për je-timin e tij ose të dikujt tjetër se

bashku me mua do të jetë në xhenet." (Muslim)

Me ardhjen e Profetit (a.s.) në këtë botë si jetim, bonjakë-ria fitoi nder dhe virtyt edhe në këtë botë, edhe në jetën tjetër. Ja si e përshkruan poeti Mehmet Asllan me këto var-ge:

Allahu i del jetimit për Zot!

Ta ngacmosh jetimin është mëkat,

Jetimin të dobët mos e pa-ndeh,

Lotët e jetimit janë armë e fortë!

Në një hadith tjetër kështu thuhet:



“Shtëpia më e mirë është shtëpia ku jetimi trajtohet mirë; shtëpia më e keqe është shtëpia ku jetimi trajtohet keq!” (Është përsëritë më poshtë. I.D.)

Allahu i Lartmadhëruar në një hadith kudsi kështu thotë:

-O robi im! Nuk do të hyjë në xhenet askush përveç atyre që janë modest karshi xhenetit, madhështisë sime, ata që e kalojnë ditën më adhurime, ata që janë mirënjohës ndaj jetimëve dhe bëjnë detyrën e babait, ata që ua zgjasin dorën vejushave për ndihmë dhe me dhembshuri sikurse burri i vet. Këta persona që i posedojnë këto cilësi kur të më thërrasin Mua, u shkoj në ndihmë. Sa herë që dëshirojnë diçka nga Unë, jua jap atë dhe në zemrat e tyre ua ngulis dashurinë.

-O robi im!, Ata që për hir të rizasë Time i mbrojnë jetimët dhe vejushat, do t'i marrë nën atë hije ku nuk do të ketë tjetër përveç hijes Time.

-O robi im! Ashtu siç je treguar i mëshirshëm ndaj të tjerëve, ashtu do të mëshirohesh. Si ke fytyrë të lypësh mëshirë nga Unë, përderisa nuk je i

mëshirshëm karshi të tjerëve?

I Dërguari i Allahut (a.s.) thotë se tri kategori njerëzish do të prehen nën hijen e arshit në Ditën e Kiametit:

Në grupin e parë hyjnë ato gra vejusha, që ju kanë mbetur fëmijët jetimë dhe, kur lypen nga të tjerët për t'u martuar me ta, u përgjigjen duke u betuar para Zotit duke thë-

Çdo person duhet ta dijë se është i përgjegjshëm për aftësinë dhe të mirat e tjera që ia ka dhuruar Zoti (xh.sh.)

në: “Derisa nuk vdesin fëmijët dhe unë, do të kujdesem për ta deri sa të rriten.”

Në grupin e dytë hyjnë ata njerëz që kanë pasuri por që përgatisin ushqime të mira dhe i ftojnë për t'i ushqyer jetimët dhe të vetmuarit, të mjerrët.

Ndërsa në grupin e tretë

janë ata njerëz që nuk e neglizhojnë vizitën e të afërmeve të tyre.

Po ashtu këtyre njerëzve u shtohen të mirat, u zgjatet jeta dhe në Ditën e Kiametit do të prehen nën Hijen e Arshit.

Kujdestari i jetimit duhet ta edukojë atë, ashtu siç i edukon fëmijët e vet. Për këtë është përgjegjës për të në Ditën e Kiametit.

I Dërguari Allahut Muhamedi (a.s.) thotë:

-O Ali! Xhebraili (a.s.) ka thënë se po të isha njeri, do t'i bëja këto shtatë gjëra:

1. Do të falja namazin me xhemat
2. Do të isha i pranishëm pranë dijetarëve
3. Do t'i pyesja të sëmurët
4. Do të falja namazin e xhenazes
5. Do të shpërndaja ujë për të pirë
6. Do t'i pajtoja dy të hidhëruar më njëri tjetrin
7. Do të kisha treguar dhembshuri ndaj jetimëve.

O Ali, lakmoji këto gjëra që të thashë.



O Ali, kur qanë jetimi dridhet arshi.

Allahu i Lartmadhëruar thotë:

-O Xhebrail bëja vendin në xhehenem atij personi që bëhet shkaktar për qarjen e jetimit! Edhe Unë do ta bëjë atë të qajë. Zgjeroja vendin në xhehenet atij që e gëzon dhe e kënaq jetimin, që unë do ta gëzoj dhe kënaqë atë.

Më pas ai thotë:

-O Ali! Këto gjëra e pastrojnë zemrën:

Leximi i tepërt i sures Ihlas.

Ngrënia e pakët

Prania në mexhlisin e dijes.

Falja e namazit të natës.

Ledhatimi i kokës së jetimit.

Në një hadith kudsi kështu thuhet:

-O Davud! Ji i mëshirshëm ndaj jetimëve, sikurse babai i vet. Ji i dhimbshëm ndaj vejjushave të varfra sikurse një baba i mirë. Dije se atë çka ke mbjellë do të korrësh. Pra, ashtu si i trajton të tjerët, ashtu do të trajtohesh edhe vet, sepse patjetër do të vdesësh. Do të mbesin fëmijët jetimë edhe

gruaja vejushë.

Pejgamberi (a.s.) thotë:

-Në Ditën Kiametit një pjesë e njerëzve do të ngrihen nga varret duke nxjerrë zjarr nga goja e tyre. Shokët pyeten:

-Kush janë ata, o i Dërguari i Allahut?

-A nuk keni dëgjuar se çfarë thotë Allahu i Lartmadhëruar?

Mjekët të cilët

interesohen për shërimin  
e të sëmurëve pa ndonjë  
interes dhe tregohen të  
dhimbshëm karshi tyre,  
numërohen se kanë bërë  
xhihad, sadaka

- Ata që e hanë pa të drejtë pasurinë e jetimëve, në të vërtetë ata hanë atë që mbush barkun e tyre me zjarr dhe do të futen në zjarrin e xhehenemit. (Nisa, 10)

Veçanërisht është detyrë e shtetit dhe të pasurve që të mbrohen jetimët, t'ua mbulojnë nevojat e tyre për studi-

me, mësimin e fesë, edukim, afrimin e zemrave të tyre më pranë Allahut, të Dërguarit (a.s.), dashurinë për atdheun, po që nevoja dhe martesën e tyre dhe gjetjen e një banesë të mirë.

Zemrat e jetimëve janë të thyera. Janë të trishtuar shumë për shkak të mungesës së dashurisë prindërore. Për ta riparuar këtë plagë duhet që njerëzit e mirë të Zotit t'i marrin nën mbrojtjen e vet, shteti dhe të pasurit të ndërtojnë jetimore etj. Me anë të këtyre gjërave ata ushqehen, vishen, mbathen, edukohen, shkollohen etj. Mjafton që nëpunësit e këtyre institucioneve bamirëse të kenë sjellje të mira, moral të lartë, edukatë të mirë. Para së gjithash këta çiliminj kanë nevojë për dashuri, moral, udhëzim për jetën.

I Dërguari i Zotit Muhamedi (a.s.) në një hadith thotë:

-Pas kryerjes së farzeve, ibadeti më i vlefshëm është gëzimi i zemrave të vëllezërve besimtarë. Duke qenë kështu afria të Zoti bëhet duke i gëzuar zemrat e jetimëve, vejjushave e pambrojtura, fëmijëve me sy të përplotur.





Shumë njerëz janë të qetë me mendimin se i kanë plotësuar obligimet, detyrat e fesë, por a është e mjaftueshme kjo? Jo! Atëherë detyra e çdo myslimani pasi t'i kryej farzet dhe të largohet nga mëkatet, duhet të jetë i dobishëm për bashkësinë njerëzore duke i dal për zot me mënyrat nga më të ndryshmet.

Vetëm pse nuk u bëhet shërbim të varfërve, me pasuri apo pse nuk u jepet mend në rast nevojë, nuk mund të quhen njerëz të plot, sepse këto që përmendem janë plotësues të farzit dhe pjesë nga syneti i të Dërguarit (a.s.).

Çdo person duhet ta dijë se është i përgjegjshëm për aftësinë dhe të mirat e tjera që ia ka dhuruar Zoti (xh.sh.).

Si nga të pasurit edhe nga ana e shtetit janë realizuar projekte nga më të ndryshmet për eliminimin e varfërisë duke ndërtuar jetimore, spitale, shkolla, xhami, kurse, vendpërjetje për mysafirët e udhëtarët etj.

Ashabët e nderuar e pyetën Profetin (a.s.):

-O i Dërguar i Allahut cili është adhurimi më i mirë?

-Namazi në kohën e vet, përgjigjet ai.

-Përsëri pyetën dhe Pejgamberi (a.s.) u përgjigjet:

-T'i bësh mirë nënës dhe babait.

-Ata përsëri pyesin, Pejgamberi u përgjigjet:

-Xhihadi.

Ashtu siç luftohet me shpirt në rrugën e Allahut (xh.xh.), po ashtu edhe punët e tjera që bëhen për hatrin e Tij janë xhihade, sadaka.

Të gjitha njohurit e dhëna nga mësuesi për hir të Allahut, janë xhihade, sadaka.

Edhe ushtarët mbrojtës që kryejnë detyrën në kufi, kanë vlerën e xhihadit, bëjnë sadaka.

Edhe mjekët të cilët interesohen për shërimin e të sëmurëve pa ndonjë interes dhe tregohen të dhimbshëm karshi tyre, numërohen se kanë bërë xhihad, sadaka.

Po ashtu edhe artistët, nëpunësit e shtetit, punëtorët që në mënyrë të përsosur i kryejnë detyrat e veta, kanë bërë xhihad, sadaka.

Kur'ani Fisnik na njofton se

Sulejmani a.s. ka folur me kafshët. Një ditë prej ditësh Sulejmani i ftoi të gjithë zogjtë. Mes të tjerash ftoi edhe zogun Hud Hud. Por ai e refuzon ftesën e tij. Për këtë Sulejmani buzëqeshi dhe e ftoi përsëri. Por edhe këtë radhë ia mohoi ftesën e Sulejmanit. Duke këmbëngulur që të jetë i pranishëm në tubimin e kafshëve, atij i rritej mendja edhe më shumë. Të mos vijë më pas meje, sarajin e tij do t'ia bëj çapojë, tha me hidhërim të thellë. Por ai dihej se kishte një trup të vogël sa një trumcak.

Pas këtij refuzimi e pyeten se si mund ta djegësh sarajin:

Ai dha këtë përgjigje:

-Po të marrë pak nga malli i vakëfit dhe t'ia vendos sipër çatisë së sarajit, e din vet ai se çfarë i ndodh.

Qoftë mall jetimi, qoftë mall vakëfi, kujdestari i tij duhet ta përdor në vend të duhur. Ky mall nëse nuk përdoret në vend të duhur, është përgjegjësi e madhe që u bie mbi supë drejtuesve të tij. Të papërgjegjshmit i shpie në humbje.



# Tavafi i një bisede zemrash...

**“Çdo ditë të re, Allahu i Madhëruar kërkon prej nesh të hapim një faqe të re në jetën tonë”!**

Po bisedoja me një njeri shumë të dashur për zemrën time për mirësitë e Zotit, me të cilat Ai shfaqet ditë pas dite para njeriut në hapësirat e jetës së tij. Tavafi i bisedës së këndshme na mori drejt brigjeve të mendimeve që dalin nga zemra e drejtohen drejt zemrës. Ca mendime u mblodhën me shpejtësi, e sikur të ishin hise e bashkëbiseduesit tim të dashur, morën rrugën e tyre drejt zemrës që qëndronte karshi zemrës sime...

Dhe mora të flas para duarve të njeriut të dashur. Unë, tha zemra para zemrës, mesa kam parë e dëgjuar, mesa kam lexuar e hulumtuar, kam përfunduar se, nëse ndonjërit prej nesh i janë mbledhur tri gjërat (për të cilat do të flas më poshtë), duhet të jetë i kënaqur me Zotin e tij, ta falënderojë Atë mesa të ketë mundësi dhe të ndjehet i lumtur: **jeta, shëndeti dhe ndjesia e dashuri-**

**Jeta...**

J e t a ,  
sepse atij  
që All-  
llahu i

ka dhuruar jetën, sado që të jetë, sido që të jetë, e ka ende një mundësi... Jeta është mundësi! Është mundësi për të rregulluar diçka, për të korrigjuar diçka tjetër, për të ndërtuar, për të dhënë, për të marrë njëkohësisht, për shumë sosh është mundësi..!

Jeta është mundësi e të gjallëve për të rregulluar atë që kanë prishur me duart e tyre në ditët e shkuara. Fakti që Krijuesi Mëshirëplotë i ka lënë të hapura dyert e pendimit të sinqertë e të faljes për çdo të gjallë që në një moment fatlum të jetës së tij kthehet nga këto dyer për të trokitur me kokë të ulur në to, nëpërmjet rrugeve të: **“Ai që nuk kërkon prej Allahut, zemërohet prej tij”**<sup>1</sup>, është një mirësi shumë e madhe, të cilën nuk mund ta ketë veçse ai që është i gjallë! Prandaj, sa të jesh gjallë, falënderoje Allahun që të ka dhënë këtë mundësi kaq të madhe, shfrytëzoje para se të merret prej teje, se atëherë do të jetë vonë, tepër vonë..! Siç kanë thënë: **“Prej shenjave të hidhërimit të Allahut me njeriun, është edhe humbja e kohës”**<sup>2</sup>, pra e vetë jetës!

Jeta është mundësi për të korrigjuar në ditët e saj. E kush prej nesh nuk ka se çfarë të korrigjojë? Cili prej nesh nuk do të donte të korrigjonte një gabim me një mik, me një të afërm, me një

të dashur, me një të njohur? Jeta është mundësia e korrigjimeve! Përfitimi prej saj për këtë është në vetvete një qëllimi i lartë prej qëllimeve të bardha të kësaj jete ditëpak!

Jeta është mundësia e ndërtesve, sidomos e atyre që përpigjen të ndërtojnë zemrat me dashuri, mendjet me dije e kulturë, shpirtat me përkushtim e sinqeritet besimi, urat e komunikimit me tjetrin me shpirtmadhësi e urtësi, paqen e harmoninë në mesin e njerëzimit me krejt qenien e tyre... Dhuntia e jetës është kaq e madhe për t'i shërbyer këtij qëllimi, sa vetëm ata që e përjetojnë në liri e me besim atë, dinë ta vlerësojnë si duhet, dinë ta shijojnë si dhunti, e përjetojnë gëzueshëm!

Jeta është mundësi për të dhënë atëherë kur ke, e kur të duket se e gjithë bota është e jotja, njëkohësisht që vetëm e jotja nuk është e nuk mund të ishte, sado të punojë e të mblidhje në rrugëtimin tënd drejt një “përjetësimi” të pamundshëm në të! Është mundësi për të dhënë nga zemra jote, nga shpirti e mendja, nga sinqeriteti e bujaria, nga vetja jote si e si të ndihmosh atë që ka nevojë për ty, që ndjen se ka besim te ti e mund të të besojë nga zemra e qenia e tij, sepse **“Besa është pasuri”**<sup>3</sup>... Është mundësi të japësh që të mos zhgënjesh, sepse nuk ka dhembje më të madhe për atë

1. Transmetuar nga Tirmidhiu nga Ebu Hurejra (r.a.).

2. Abdulfettah Ebu Guddah: “Kimetuz-zemen indel-ulema”, fq. 24.

3. Transmetuar nga El-Kudai nga Enesi (r.a.).

që pret prej teje, e ndërkohë që pret, para tij shfaqet zhgënjimi i papërshtueshëm për fatalitetin e tij..!

Është mundësi të japësh, që të marrësh njëkohësisht, sepse kështu e ka kjo jetë, është rregull i vendosur që në amshim, është natyrë e saj; kush jep, herët a vonë merr, kompensohet, qoftë edhe pas një kohe e një jete...

Jeta është mundësi, që siç thotë një dijetar i urtë: *"Çdo ditë të re, Allahu i Madhëruar kërkon prej nesh të hapim një faqe të re në jetën tonë"*<sup>1</sup>!

### Shëndeti...

Shëndeti është kurora e madhe e mirësive të Allahut mbi kokat e të shëndoshëve, të cilën e shikojnë me shumë nostalgji ata që u është marrë, a e kanë dorëzuar me duart e tyre në përbuzje me rregullat dhe natyrën e marrëdhënieve të njeriut me vetë jetën...

Shëndeti, për të cilin lutemi ditë-natë, pa të cilin nuk do të ishim siç jemi e nuk mund të mendonim siç mendojmë! Shëndeti, për të cilin duhet të jemi mirënjohës para Atij që jep e që merr, që është Posedues i gjithçkaje dhe Mbret i gjithësisë, mirënjohje që në njëfarë mënyre shpreh dëshirën e vazhdimësisë së garantuar: *"Nëse falënderoni, do t'ua shtoj të mirat"*<sup>2</sup>!

Vlerën e vërtetë të jetës e të shëndetit e përcakton fare thjeshtë, por bindshëm e me elokuencën e tij të dhuruar, Zotëria i bijve të Ademit, Resulullahi (a.s) që thoshte: *"Janë dy mirësi në të cilat, shumë prej njerëzve janë të humbur; shëndeti dhe koha"*<sup>3</sup>!

Po dëgjoja intervistën e një të paralizuar, në një kanal televiziv arab, kur gazetari e pyeti:

"Çfarë ju ka mbetur pishman nga koha kur keni qenë shëndosh?" Ai, me plot emocion u përgjigj: "Tri gjëra! I kam pasur këmbët shëndosh, nuk u ula një herë në sexhde me to... Ah, sikur t'i kem tani..! I kam pasur duart shëndosh, nuk e shfletova një herë Librin e Allahut, Kuranin... Ah, sikur t'i kem tani..! Kam qenë shëndosh e mirë, por asnjëherë për bajram, nuk shkova ta përqafoj e ta uroj me zemër nënën time... Ah, sikur të jem, siç isha..!"

Për këtë, i dërguari i Allahut (a.s), porosiste: "Përfito nga pesë gjëra para pesë gjërave: ... *Nga shëndeti para sëmundjes!*"<sup>4</sup>.

### Dashuria...

Dashuria është mirësia më e madhe mbi bazat e së cilës ngrihet besimi i njeriut dhe feja e tij! Në vetvete dashuria është themelet e besimit. Një zemër që nuk do e që nuk ndjen, është zemër e sëmurë që nuk mund ta përjetojë besimin dhe frytet e tij, si zemra fatlume që e ka shijuar atë mbi themelet e një dashurie të sinqertë e të pastër. Për këtë dëshmon Kur'ani, i dërguari i Allahut dhe historia islame. "E nga njerëzit ka asish që në vend të Allahut besojnë idhujt, që i duan dhe i madhërojnë ata, sikur që besimtarët e vërtetë e duan Allahun, po dashuria e atyre që besuan Allahun është shumë më e fortë!"<sup>5</sup>, "O ju që besuat! Kush largohet prej jush nga feja e vet i bën dëm vetes, s'ka dyshim se Allahu do ta sjellë një popull që Ai e do atë popull dhe ata e duan Atë!"<sup>6</sup>, "Thuaj: "Nëse e doni Allahun, atëherë ejani pas meje që Allahu t'ju dojë"<sup>7</sup>, "Nuk beson asnjëri prej jush derisa të jem më i dashur për të se fëmija i tij, se prindërit e tij dhe se mbarë njerëzimi!"<sup>8</sup>, thënia e Saf-



van ibni Kuidames (r.a), ditën që i dha besën e Islamit Resulullahit (a.s): "O i dërguar i Allahut! Unë të dua ty!" dhe përgjigjja e tij (a.s): "Njeriu do të jetë me atë që do!"<sup>9</sup>, "Dua për njerëzit, atë që do për veten tënde"<sup>10</sup> etj., janë tekste dhe ngjarje autentike që janë vendosur në rrënjët e pemës së lulëzuar të fesë tonë!

Të duash, të ndjesh, është një dhunti që nuk i është dhënë kujtdo e që nuk mund ta ketë kushdo, kur e si të dojë.., ajo është dhunti hyjnore, buron nga dashuria e Krijuesit të gjithësisë!

E, siç kanë thënë: *"Një kokërr e vogël meli dashuri është më e dashur për mua sesa shtatëdhjetë vite adhurim pa dashuri"*<sup>11</sup>...

Po bisedoja me një njeri shumë të dashur për zemrën time për mirësitë e Zotit, me të cilat Ai shfaqet para njeriut. Tavafi i bisedës së këndshme na mori drejt brigjeve të mendimeve që dalin nga zemra e drejtohen drejt zemrës...

Shkodër, më 8 mars 2008

1. Osman Nuri Topbash, gjatë komentimit të sures "Esh- Shems", në një takim me të rinj myslimanë shkodranë, më 27 tetor 2007.

2. Kurani: 14: 7.

3. Transmetuar nga Bukhari, Tirmidhiu dhe Ibn Maxheh nga Ibni Abbasi (r.a).

4. Transmetuar nga Hakimi dhe Bejhakui nga Ibni Abbasi (r.a), etj.

5. Kurani: 2:165.

6. Kurani: 5:54.

7. Kurani: 3:31.

8. Transmetohet nga Bukhari dhe Mu -

limi nga Enesi (r.a), sipas Kadi Ijadit në "Esh- Shifa", fq. 492.

9. Transmetuar nga Tabarani, sipas Kadi Ijadit në: "Esh- Shifa", fq. 494.

10. Transmetuar nga Bukhari në: "Et-Tarikh", Ebu Ja'la në: "El-Musned", Tabarani në: "El-Kebir", etj, nga Jezid ibn Usejd (r.a).

11. I atribuohet Jahja ibni Muadhut, sipas Ebul-Kasim el-Kushejriut në: "Er-Risaletul-Kushejrije", fq. 326.



## Çerdhja familjare

Martesa, për femrën,  
do të thotë që ndjenjat  
e feminitetit, talentet  
dhe karakteristikat  
dalluese të saja t'i  
fokusojë mbi gjininë  
tjetër. Ndërsa për  
mashkullin kurorëzimi  
martesor është shtrati  
që e shpëton atë nga  
rënia brenda vorbullës  
fatkeqe të anëve  
negative të epshit dhe  
që i mundëson atij  
një jetë familjare të  
virtutshme.

Allahu i lartësuar si Krijues i gjithësisë nuk ka të dytë, ndërsa për mbarë krijesat e tjera ka caktuar që të krijohen duke qenë çift. Duke vënë mes tyre ligjin e tërheqjes hapi rrugën për perfeksionimin shpirtëror me anë të unifikimit të tyre në një ndjesi të vetme sublime. Nuk ka dyshim se, prirja për të dashuruar dhe për të qenë i dashur nga të tjerët, ndjenjë që ekziston tek krijesa më fisnike, njeriu, përbën shkallën e parë të ngritjes drejt dashurisë hyjnore. Nisur nga kjo themi se Allahu (xh.sh.) e ka caktuar të domosdoshme jetën martesore, në mënyrë që mbrohet kjo gradë fisnike që ia ka dhuruar njeriut dhe për të mundësuar që brezat njerëzore të vazhdojnë të pastër dhe të bekuar, e ka urdhëruar martesën.

Martesa, për femrën, do të thotë që ndjenjat e feminitetit, talentet dhe karakteristikat dalluese të saja t'i fokusojë mbi gjininë tjetër. Ndërsa për mashkullin kurorëzimi martesor është shtrati që e shpëton atë nga rënia brenda vorbullës fatkeqe të anëve negative të epshit

dhe që i mundëson atij një jetë familjare të virtutshme.

Kurorëzimi martesor përkrah prehjes dhe qetësisë që i fal shpirtit është njëkohësisht edhe elementi i vetëm i efektshëm që i fal formë rregullit fiziko-trupor. Hijeshia e moralit ekziston falë saj. Lumturia familjare, prosperiteti dhe zhvillimi i shoqërisë realizohet me anë të kurorës martesore. Femra zbulon ndjesitë e mëshirës dhe dhembshurisë kur merr në prehër dhe shtrëngon në krahët e saj foshnjën, ndërsa nga ana tjetër jeton një sprovë prej edukatoreje të fëmijëve. Mashkulli, përkrahë forcimit dhe zhvillimit të ndjenjës së përgjegjësisë fillon të ngjis shkallët e përkryerjes me cilësinë e tij si prijësi i familjes. Brenda trupit kombëtar familja është njësi më e vogël administrative, por edhe më themeloria. Kjo është arsyeja që të gjithë profetët, me përjashtim të profetit Isa që u ngrit në qiell që në moshë të re, kanë qenë të martuar.

Gjëja më me vlerë e besimtarit në këtë botë, pas shpirtit të tij të devotshëm, është bashkeshortja e tij fetare. Gruaja është stolia më e vyer e kopshteve të



Nuk ka dyshim se, prirja për të dashuruar dhe për të qenë i dashur nga të tjerët, ndjenjë që ekziston tek krijesa më fisnike, njeriu, përbën shkallën e parë të ngritjes drejt dashurisë hyjnore.

lumturisë. Kombet bëjnë përpara në sajë të familjeve të tyre të shëndosha. Urtësitë nën çatinë e familjes së krijuar mbi bazën e të vërtetës së krijimit të njeriut nga një mashkull dhe nga një femër, janë nga shenjat më të madhërishtme të Allahut.

Rreth urtësive dhe mësimëve për ata që llogjikojnë në lidhje me kurorën martesore në ajetin kuranor thuhet:

“Nga faktet e Allahut është se Ai krijoi për të mirën tuaj nga vetë lloji juaj palën tjetër në mënyrë që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Ky është mësim për ata që llogjikojnë. “ (Rum, 21)

Ky ajet fisnik, vë theksin mbi synimin më final të martesës përkrah urtësive të tjera të saj: kultivimi i ndjenjave të dashurisë dhe mëshirës në rrugën e Allahut. Për këtë arsye edhe Muhamedi (a.s.) është shprehur kështu rreth arsyeve që një mashkull dëshiron të martohet me një femër:

**“Me një grua njeriu martohet për një nga këto statuse që ajo i gëzon, pasurinë, bukurinë, prej-**

**ardhjen dhe fetarinë e saj. Martohuni me atë femër që është e devotshme që të shihni ditë të bardha!..”**

Me qenë se kurorëzimi martesor është faktori më efektiv në ruajtjen e moralit publik Muhamedi (a.s.) është shprehur me këto fjalë me të cilat ka dëshiruar që t’ia tërheq vëmendjen ymetit të tij që ai të mos e vështirësojë mundësinë për martesë:

“Kurorëzimi më i pëlqyer për mua është martesa pa shpenzime të mëdha.”

Muhidin Arabiu i këshillonte kështu njerëzit rreth mirësive të nxitjes për martesë dhe ndihmës së dhënë njerëzve që martohen:

“Sadakaja më e mirë sipas meje është të bëhesh shkak që një mashkull mysliman dhe një femër myslimane të lidhen në kurorë. Aq më shumë që çdo vepër e mirë që pasardhësit e tyre do ta bëjnë, do të ketë nga një sevap për ata që u bënë shkaktar të kësaj lidhjeje martesore.”

Domosdoshmëri është që t’i

shmangim edhe shpërdorimet e mëdha në para dhe të sillemi sa më të përkorë gjatë ceremonive që bëhen me rastin e krijimit të një çerdheje familjare. T’i japësh një start të keq kësaj ndërmarrjeje të bekuar me anë të zakoneve dhe veprimeve të mbrapshta që bien në kundërshtim me rregullat e shariatit, do të thotë të çelësh për vetveten portën e pikëllimit. Tubimet e përshtatshme me rastin e martesës në përputhje me rregullat e moralit dhe të varura ndaj vendimeve të mësimëve fetare, janë të bekuara dhe vendet nga ku pranohen lutjet e drejtuara Zotit.

Martesa e vërtetë është institucioni sublim i dyanshëm, financiar dhe shpirtëror, mbi të cilin është ndalur në mënyrë specifike besimi Islam. Prandaj rreth pikës së themelimit të këtij institucioni sublim është domosdoshmëri që të dy palët të jenë seriozë dhe të kujdesshëm sa më s’ka. Në të kundërt çerdhet familjare që formohen të kapur pas pandehmës se martesa nuk është gjë tjetër përveçse një bashkimi të thjeshtë, përfundojnë me shkurorezime të

pavend që shprehen si ngjarje që e dridhin edhe fronin hyjnor. Muhamedi (a.s.) ka thënë:

"Martohuni dhe mos u shkurorëzoni më pas, sepse edhe froni hyjnor dridhet kur ngjan një divorc!"

Lëre pastaj, të shkurorëzosh bashkëshortin ose bashkëshorten për shkak dëshirash kalimtare, sepse kjo është e refuzuar kategorikisht nga mësimet e fesë që e konsiderojnë këtë veprim një padrejtësi dhe mëkat të madh, llogaria për të cilin në botën tjetër do të jetë e madhe, ashtu sikurse do të jetë edhe ndëshkimi për të. Kjo do të thotë të çapitesh me hapat e indiferencës drejt një asgjësimi dhe pikëllimi të madh që të ngarkon barra e të drejtës së tjetrit, shkelja e së cilës nuk të falet as nga Allahu (xh.sh.).

### **Të drejtat burrë-grua**

Lumturia familjare varet nga mirëpërdorimi i të drejtave të ndërsjella midis të dy palëve.

Burri është i pari i shtëpisë. Ecuria e rregullt e familjes është më shumë e varur pas drejtimin të mirë të burrit. Në ajetin fisnik thuhet "Meshkujt janë përgjegjës për gratë e tyre." (Nisa, 34).

Kuptimplotë është që burri të jetë i pari i shtëpisë po qe se do të kemi parasysh temperamentin jashtëzakonisht të ndjeshëm të femrës, e cila edhe kjo është e kuptueshme pasi që mbrojtja e brezit është e mundur vetëm në saj të ndjenjave të dhembshurisë që gruaja ka.

Kjo epërsi e burrit në familje nuk do të thotë se ai ka të drejtë të përdor dhunën apo despotizëm, por që ai të ruaj rregullin në familje dhe të ruajë jetën martesore. Gruaja është mba-

rështuesja për punët që i përka- sin brenda shtëpisë.

Krijimi i Ademit (a.s.) dhe më pas dalja prej tij si të qe një filiz i Havasë (a.s.), është një e vërtetë e qartë që tregon përparësinë e burrit në familje. Rasti i Havasë (a.s.) të krijuar nga eshtra e brinjës së majtë të Ademit (a.s.), e vërteta që ajo është një copë e këputur nga i njëjti lloj, në të njëjtën kohë është shpjegimi më i bukur që mund të jepet për nevojën e afërsisë ndërmjet burrit dhe gruas. Mbi të gjitha një nga faktorët më themelor të arsyes së ekzistencës së të gjithë krijesave është dashuria, ashtu sikurse edhe është shprehur në hadithin kuds. Dhe kjo është një gradë drejt dashurisë hyjnore, pasi që dashuria hyjnore është shkaku i ekzistencës, po aq sa është edhe synimi i tij. Për këtë arsye prija për të dashur, që nuk është gjë tjetër përveçse një shkallë drejt dashurisë hyjnore, u është dhënë të gjithë krijesave në përgjithësi, ndërsa në mënyrën më komplekse i është dhuruar qenies njerëzore. Por kjo prije e natyrshme për njeriun duhet të realizohet brenda një shtrati të saktë të rrjedhës së jetës. Ky shtrat është kurorëzimi martesor. Kjo është edhe arsyeja përse themeli i jetës familjare në Islam është i stolisur me diamantet afektiv-shpirtëror siç janë dashuria, morali, virtyti, jeta fetare, sjellja e mirë, mëshira, besnikëria, durimi, qëndresa dhe prehja.

Jeta familjare që zë fill që nga jeta bashkëshortore në parajsë e atit dhe mëmës së njerëzimit, Ademit (a.s.) dhe Havasë (a.s.) u përcoll me anë të ligjit të martesës tek bijtë dhe bijat e tyre në tokë për t'u përjetësuar me anë të mësimëve të fesë islame. Me të vërtetë feja islame,

u shndërrua në qiellin e mëshirës së pranverës së përhershme dhe prehjes së paqes me anë ligjeve të saj për jetën familjare. Që të mund të kemi pjesë nga kjo lumturi dhe të mund të ekspozojmë një tablo familjare si ajo e Ademit (a.s.) dhe Havasë (a.s.) është e domosdoshme që me anë të ligjeve të kurorës dhe martesës të mund të shndërrohemi në një shpirt dhe një rrahje zemre të pleksur në udhën e dashurisë dhe devotshmërisë ndaj Allahut.

Për të mundur të krijojmë lumturinë familjare është shumë e rëndësishme që të marrim pjesë nga përroi i "devocionit" që në ajetet kuranore shprehet me fjalët "itteku". Profeti Muhamed (a.s.) në ligjëratën e tij të lamtumirës të mbajtur në Meke u shpreh me këto fjalë rreth të drejtave të grave:

**"O njerëz! Kryejini obligimet tuaja ndaj grave! Trajtojini ato me dashuri dhe dhembshuri! U këshilloj që t'i keni frikën Allahut rreth sjelljeve tuaja me gratë. Gratë ua ka lënë Allahu si amanet në këtë botë, nderin dhe dinjitetin e tyre ju e gëzuar duke**

### **Kurorëzimi**

**martesor përkrah  
prehjes dhe qetësisë  
që i fal shpirtit është  
njëkohësisht edhe  
elementi i vetëm  
i efektshëm që i  
fal formë rregullit  
fiziko-trupor**

## **i dhënë fjalën Allahut për sjelljen tuaj!”**

Perfekcionimi i feminitetit realizohet me anë të ruajtjes së aftësive të bukura që i ka dhuruar asaj Allahu (xh.sh.). Poqese gruaja i orienton karakteristikat e saja femërore në një drejtim të kundërt me caktimin hyjnor duke i lënë shëndetin kështu së vërtetës së fshehur në gjirin e saj, atëherë e asgjëson vlerën e saj dhe e pushton mungesa e prehjes dhe fatkeqësia. Vatra familjare shkretohet dhe kështu jeta sociale bëhet e djerrë. Në shekullin tonë flitet për një garë artificiale të iniciuar në emër të barazisë mashkull-femër. Kjo garë që bie në kundërshtim me veçoritë e krijimit, është duke i dobësuar femrës përherë e më shumë karakteristikën e amësisë dhe zonjës së shtëpisë duke i shkaktuar kështu plagë të rënda familjes. Nga ana tjetër rastet e shumta të abortimit të bebeve në bark të nënave, është krimi monstroz i shekullit që na kujton ngjarjet e injorancës arabe paraislamike kur vajzat e vogla varroseshin të gjalla. Dallimi mes gruas së sotme të lodhur dhe të dërrmuar dhe

gruas së periudhës së hershme në fjalë, është vetëm në veshjen e tyre. Ky është krimi social që nxori në shesh edukimi dhe arsimimi i pashpirt materialist. Sa ashpër Allahu (xh.sh.) ua bën të qartë me kërcënimin e tij hyjnor zemrave që ndejnë fundin e dhimbshëm të shëmtisë, neverisë dhe mungesës së mëshirës së atyre që kryejnë këtë krim kur shpall:

**“Kur foshnjat vajza që u groposën për së gjalli të pyesin përse e merituan këtë vrasje makabre”** (et-Tekvir, 8-9)

Të mos duash të kesh fëmijë do të thotë mosmirënjohje ndaj dhuratës hyjnore, të dalësh kundër qëllimit final që ka kurorezimi martesor dhe të pushtohesh nga ndjesitë e të pashpirtit ndaj vlerave dhe shijeve afektive, morale dhe sociale.

E vërteta është se, Allahu (xh.sh.) e ka krijuar çdo krijesë dhe çdo pjesë të kësaj krijese për një qëllim të caktuar dhe i ka dhuruar asaj një strukturë biologjike dhe psikologjike të përshtatshme me synimin e krijimit të tij. Ja për shkak të këtij realiteti Islami duke e marrë për bazë të vërtetën e pleksur brenda krijimit e ka orientuar njeriun sipas kësaj natyre dhe u ka dhënë drejtimin në mënyrën që duhet aftësive të mashkullit dhe femrës.

Prandaj edhe profeti Muhammed (a.s.) e pat urdhëruar bijën e tij, Fatimenë, që gjendet në piedestalin e grave të kësaj bote, të mbarështojë të gjithë punët e shtëpisë, ndërsa bashkëshortit të saj, Aliut (r.a.), të merret dhe rregullojë punët e jashtme të shtëpisë, kështu pat rregulluar edhe kornizën e cilësive natyrore të cilat duhet t'i ndajnë mes tyre anëtarët e një familjeje. Por

vajza e tij e bekuar, Fatimeja, një ditë prej ditësh erdhi dhe iu qa të atit që t'i caktonte një ndihmës për shkak të punëve të shumta që kishte dhe për faktin se ajo nuk qe shumë e fuqishme fizikisht, ndërsa fëmijët i kishte të vegjël, por profeti Muhamed (a.s.), duke mos u pajtuar me këtë dëshirë të së bijës, nuk e pranoi një gjë të tillë.

Kjo sjellje që shfaqti i dërguari i Allahut (a.s.) për bijën e tij që e kishte si dritën e dy syve, është një shembull mësimdhënës për mbarë popullin e tij mysliman. Në drejtim të kësaj të vërtete duhet të dimë që gratë duhen marrë personalisht me punët e shtëpisë dhe edukimin e brezave dhe kjo mbi të gjithë u shton më shumë edhe fisnikërinë.

**Baballarët, nënat dhe vëllezërit në shtëpi**

Babai, është autoriteti rregullues i prehjes dhe lumturisë familjare. Me një shprehje tjetër ai është paraqitja e familjes, pasi që Allahu (xh.sh.) që e ka ngarkuar atë me luftën e jetës dhe sigurimin e mirëqenies së familjes e ka bërë mashkullin më të fuqishëm fizikisht dhe më të qëndrueshëm shpirtërisht në krahasim me femrën.

Nuk ka dyshim se realizimi i lumturisë në familje mbështetet mbi administrimin e pjekur të një ati të mirë, por bashkëshortja dhe fëmijët nuk e kanë të drejtën të presin më shumë nga bashkëshorti apo babai i tyre më shumë se sa ka fuqi ai të punojë për t'u siguruar atyre jetesën. Detyra e mashkullit është të sigurojë ushqimin dhe mirëqenien e familjes me kush-tin që të mos e kalojë kufirin në shpenzime dhe të mos u ofrojë atyre më pak ngase u nevojiten për një jetë të mesme. Qoftë

**Themeli i jetës  
familjare në Islam  
është i stolitur me  
diamantet afektiv  
shpirtëror siç janë  
dashuria, morali,  
virtyti, jeta fetare,  
sjellja e mirë,  
mëshira, besnikëria,  
durimi, qëndresa  
dhe prehja**

edhe i pasur mashkulli është i obliguar që ta ruaj vetveten nga shpenzimet e mëdha. Meqë pasuria i përket Allahut, njeriu nuk duhet ta harrojë se ajo i është dhënë si amanet. Poqe se njeriu nuk sillet brenda kësaj ndërgjegjeje, ai do të ngarkohet me përgjegjësinë e rëndë të shpërdorimit. Nuk duhet të harrojmë se stomaku i njeriut është një kazan rreziqesh dhe se shpërthimi i tij ka pasoja morale dhe materiale.

Ekziston edhe domosdoshmëria e ruajtjes së maturisë në veshmbathje, sepse është e ndaluar që të vishemi apo stolisemi me qëllim që të shesim mend apo të krekosemi.

Allahu (xh.sh.) urdhëron dhe thotë:

**“Mos e shtrembëro fytyrën tënde prej njerëzve dhe mos ec nëpër tokë mendjemadh, sepse Allahu nuk i do mendjemëdhenjtë që krekosen!..”** (Llukman, 18)

Prindërit janë të detyruar që t'i ruajnë pjesëtarët e familjes, madje edhe shërbyesit në shtëpi, prej bisedave që u prishin ndjenjat fetare dhe bukuritë morale, prej shëtitjeve që bien në kundërshtim me mësimet islame dhe prej fatkeqësive të romaneve negative apo programeve televizive. Allahu (xh.sh.)

**Të mos duash të kesh  
fëmijë do të thotë  
mosmirënjohje ndaj  
dhuratës hyjnore, të  
dalësh kundër qëllimit  
final që ka kurorëzimi  
martesor dhe të  
pushtohesh nga ndjesitë e  
të pashpirtit ndaj vlerave  
dhe shijeve afektive,  
morale dhe sociale**

urdhëron dhe thotë:

**“O besimtarë! Mbroni veten tuaj dhe familjet tuaja nga zjarri skëterrës ushqimi i të cilit janë gurët dhe njerëzit!”** (Tahrim, 6)

Bekuar qoftë ai baba sakrifikes që i ka vënë vetes synim ruajtjen e pjesëtarëve të tij të familjes dhe lumturinë e tyre në botën tjetër!

Sa bukur shprehet tabloja e një babai të devotshëm në këtë hadith profetik:

“Kënaqësia e Allahut është e fshehur brenda fitimit të pëlqimit të babait, ashpërsia dhe dënimi i Allahut (xh.sh.) është e fshehur brenda zemërimit dhe mërzitjes së babait.”

Ndërsa e parë nga brenda,

elementi që e sistemon dhe e edukon brezin që rritet brenda saj është nëna. Për këtë arsye nëna është pajisur me cilësitë si thellësia e ndjenjës, brishtësia, dhembshuria, mëshira, sakrifica, kujdesi për foshnjën dhe ruajtjen e brezit.

Nuk është krijuar ndonjë krijesë tjetër që do të barazohej me dashurinë dhe respektin ndaj nënave tona që në fillim na mbajnë në barqet e tyre, më pas në krahët e tyre dhe deri sa të vdesin në zemrat e tyre. Nëna besnike që ia kushton veten familjes së saj meriton një dashuri të zjarrtë, një respekt të thellë dhe një ndjenjë falënderimi të përvetshme. Diamanti i virtyteve që do të shkrijë brenda saj lodhjet e bashkëshortit, çamarokllëqet dhe lojëra mërzitëse të fëmijëve është vetëm zemra e nënës. Për shkak të kësaj vlerë sublime që ajo gëzon, Allahu (xh.sh.) urdhëron dhe thotë:

“Ne e kemi urdhëruar njeriun të sillet mirë ndaj prindërve, sepse nëna e mbajti atë mund pas mudi dhe pas dy vjetësh i ndau gjirin. Ji mirënjohës ndaj Meje dhe ndaj prindërve tuaj, sepse vetëm tek Unë është kthimi juaj.” (Llukman, 14)

Dhembshuria dhe mëshira zë vendin e saj në shpirtat e nënave. Amësia tek qenia nje-

rëzore është një ndjesi e lartë që nuk mund të krahasohet me të njëjtën ndjesi që ekziston tek krijesat e tjera, sepse tek foshnja shpallen në të njëjtën kohë nga nëna e tij, jo vetëm ushqimi i parë për zhvillimin e tij fizik, por edhe atë shpirtëror. Ajo nënë lind njeriun e pajisur me talentet më të afërta me Krijuesin e gjithësisë. Nënata janë krijesat që kanë marrë më shumë hise nga cilësia e mëshirës hyjnore të Krijuesit.

Mbretëria e lumturisë së grave zë fill me të qenit e tyre një nënë e virtytshme, pasi që edhe fjalët "Parajsa është nën këmbët e nënave!..." është dëshmia më e madhe muhamedane rreth nënave të devotshme.

Nëna është një prehër mëshire e zgjeruar me fuqinë hyjnore.

Bijtë janë begatitë e rralla që bëhen shkak të forcohen lidhjet e dashurisë brenda familjeve në të cilat nuk është prishur rregulli moral, harmonia shpirtërore dhe brishtësia e ndërgjegjes. Sikurse thuhet edhe në hadith:

"Fëmijët janë lulet e parajsës, frytet e zemrës dhe begatia e dhurata hyjnore."

Për këtë arsye edhe prindërit duhet të tregohen më të kujdesshëm rreth bijve dhe bijave

Diamanti i virtyteve që

do të shkrijë brenda saj

lodhjet e bashkëshortit,

çamarokllëqet dhe

lojëra mërzitëse të

fëmijëve është vetëm

zemra e nënës

të tyre, në mënyrë të veçantë, e kanë të detyrueshme të tregojnë një kujdes më të madh rreth bijave të tyre, sepse ata janë gurët e themelit të vatrave familjare që do të krijohen të nesërmen. Muhamedi (a.s.) ka thënë:

"Njeriu që ka tri bija, të cilat i rrit dhe i edukon, i marton dhe vazhdon të sillet mirë me ta edhe më pas, meriton vendin në parajsë."

Prindërit që nuk ia vënë veshin këtyre sihariqeve janë individët që nuk heqin dorë nga kënaqësitë e kësaj bote, që nuk shijojnë shijen e hollë të dashurisë së fëmijës, që mbeten larg synimit final të martesës, që nuk e kalojnë limitin e kënaqësive trupore, përtacë dhe indiferentë.

Allahu (xh.sh.) urdhëron dhe thotë:

"Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë të mos adhuronit kënd tjetër përveç Tij, të silleni me mirësi ndaj prindërve tuaj dhe nëse ndodh që të dy i kap pleqëria pran kujdesit tënd mos t'u thoni atyre as uf, as of dhe të mos bëheni të vrazhdë ndaj tyre, por t'u thoni vetëm fjalë të buta. Në shenjë mirënjohje shtrihe pranë tyre krahun e respektit dhe thuaj: "Zoti im! Mëshiroji ata të dy sikurse më edukuan kur isha i vogël" (Isra, 23-24)

Të gjithë këto që thamë na tregojnë se familja është guri bazë i domosdoshëm për prehjen, lumturinë dhe paqen individuale dhe shoqërore. Në këtë kontekst edhe profeti ynë, Muhamedi (a.s.) është shprehur se "Parajsa e njeriut është shtëpia e tij!..."

Zoti ynë! Mundësona ne dhe familjeve tona një jetë të devotshme me të cilën do të fitojmë pëlqimin Tënd dhe na i shndërro banesat dhe shtëpitë tona në parajsat e begatisë dhe lumturisë! Mos i shndërro ato në ferrin e dhimbjeve ku gëlojnë mijëra mosbindje dhe akte të pamenduara!

Amin!..

# Sexhdeja kulmi i lirisë njerëzore

Nëpërmjet sexhdes rrymon e vërteta, me të kalohet pas kohës dhe hapësirës, pas kalueshmërisë dhe shkaktërimit, me të hyhet në ritmin paraqitjeve më të larta të së Vërtetës dhe hyn në rrjedhën e krijesave që i janë drejtuar Krijuesit.

Hyrje

Ibn Xherir Et-Taberiu në vepërën e tij Tarih'ul-umemi ve'l-muluk pohon se krijimi i njeriut dhe rënia në sexhde (përrulje) të krijesave të tjera para njeriut, u prit nga melekët / engjëjt si lajm habitës e befasues. Kjo, si duket ndodhi për dy arsye:

1. Sexhde i bëhet vetëm Zotit krijues dhe;
2. A nuk mjaftonte ibadeti i melekëve ndaj Zotit.

Pa synim që të përgjigjemi në të gjitha kuptimet e mundshme të këtij akti të paparë, megjithatë duhet pranuar se sexhdeja para Ademit bëri lëvizje të mëdha në sferat shpirtërore. Vetë Kur'ani jep të kuptojmë se rënia në sexhde e melekëve para Ademit bëri dallimin fundamental ndërmjet melekëve të cilët amshueshëm bijën në sexhde dhe njeriut, i cili në sexhde bie herë pas here. Me formulimin herë pas here nënkuptojmë dimensionin fizikë të tij, sepse tërësia e njeriut është në sexhde permanente, jashtë dëshirës së tij të përfshirë në sexhden

universale, permanente, kozmike ndaj Zotit.

Sexhdeja e përkohshme dhe e përhershme

Ka mendime se njeriu e mori për obligim sexhden e përkohshme pikërisht sepse ai është kalif në tokë, zëvendës i Zotit, sepse është bartës i amanetit të ofruar nga Zoti, e të cilin e patën refuzuar toka, qiejt dhe mallet. Por, kjo sexhde për Ademin ishte shenja dhe vërejtja se njeriu po hyn në botën e sprovës, vuajtjes, dijes, fuqisë, lirisë, punës, sëmundjes, vdekjes, dëshirave, urisë etj. Kjo është sexhdeja e përhershme e Ademit, sikur edhe i tërë kozmosi. Kemi një numër të madh ajetesh që e përshkruajnë këtë gjendje, të sexhdes së të gjitha krijesave, edhe Dielli, edhe Hëna, edhe yjet, edhe mallet, edhe drunjat, me dëshirë apo detyrimisht, në qiej dhe tokë, në mëngjes apo në mbrëmje, edhe kafshët dhe shumë njerëz. Por, shumë njerëz do të rebelohen dhe për këtë arsye do të ndëshkohen.

Baraspesha e katër elementeve

Imam El-Gazaliu domethënien e ajeteve që flasin për njeriun dhe sexhden që iu bë atij nga krijesat e tjera e formulon duke thënë: Çdo njeri ka katër elemente: 1. Hyjnor (engjëlli - NI), 2. Djallëzor (shejtani), 3. Shtazarak (derri) dhe 4. Animal (qeni). Nëse nuk ka baraspeshë ndërmjet këtyre katër

elementeve, njeriu do të bije në varësi të elementit djallëzor dhe shtazarak dhe gjithnjë në detyrim ta ngopë njerin dhe tjetrin element dhe kështu t'i robërojë gjithnjë edhe elementit të djallëzisë dhe të atij shtazarak mizor. Sikur njeriut në këtë gjendje t'i hiqej perdja e varësisë, ai do ta shihte gjendjen e vërtetë të tij në format më të këqija, të idhujtarit, se si i robërohet elementit të tij të djallëzisë dhe kafshërisë dhe se si pretë urdhra të rinj nga urdhërdhënësi (djalli, derri apo qeni).

Sexhdeja me fytyrë është e kushtëzuar me sexhden e zemrës

"Njeriu me anë të sexhdes i afrohet Allahut", si mësojmë nga fundi i sures Ikre. Sa do të depërtojë në fshehtësi njeriu në namaz dhe në sexhde varet nga pastërtia e tij personale. Ky depërtim në fshehtësi dallon nga njeriu te njeriu si nga fuqia ashtu edhe nga intensiteti. O njeri, kur thua "Kërkoj strehim te Zoti!", dije se shejtani është armiku yt i cili është në pritë të vazhdueshme, me synim që zemrën tënde ta kthejë nga Zoti te smira që do të flasë me Të dhe do t'i biesh në sexhde, sepse, shejtani është i mallkuar, sepse e ka lënë sexhden të cilën është dashur t'ia bëjë Ademit. Te sexhdeja njeriu duhet ta ripërtërijë kujtesën e vet për madhësinë e Allahut ...

"Sexhdeja është shkalla më e lartë e përlësisë dhe nënshtri-

mit. Lëshoje, o njeri, fytyrën tënde, pjesën tënde më madhështore në shkallën më të ultë të gjerave, në pluhur. Nëse gjen që ndërmjet fytyrës tënde dhe tokës nuk ka asgjë, bëje sexhden në tokë sepse kjo është pikëpamja më e mirë e përulësisë dhe dëshmia më e mirë e nënshtrimit. Nëse ke sukses që epshin tënd ta vendos në nënçmimin e tillë, dije se e ke vendosur në vendin e vërtetë dhe se një pjesë ia ke kthyer tërësisë së tij, sepse ti je krijuar nga toka dhe në të do të kthehesh. Atëherë në zemrën tënde rimëkëmbe madhërinë e Zotit me fjalët: "I lavdëruar qofsh, o Krijuesi im i Lartësuar!", dhe këtë konfirmoj me përsëritje sepse një përsëritje është me efekt të dobët. Dhe kur zemra jote të bëhet e fortë dhe kur kjo të manifestohet, bëhu i sigurt në mëshirën e Zotit, sepse mëshira e Tij nxiton drejt dobësisë dhe përmirësimit, e jo mendjemadhësisë dhe zemërimit...".

Fytyra është pjesa më e lartësuar e njeriut. Në të vërtetë në fytyrë (kurse fytyra e njeriut është e lartësuar mbi të gjitha fytyrat e krijesave të tjera) njeriu e njeh dhembjen, gëzimin, dëshpërimin, zemërimin, smirën. Ajo është ai gadishulli për shkak të të cilit fshihen gjendjet e brendshme të zemrës. Për këtë arsye sexhdeja me fytyrë është kush-tëzuar me sexhden e zemrës. Kafshët nuk bijën me fytyrë në tokë, sepse ato nuk kanë xheloz, nuk urrejnë, nuk janë të poshtra etj. (ose, njeriu nuk mund të dijë gjendjet e tyre shtazore).

El-Gazaliu, meqenëse ka depërtuar në fshehtësitë e zemrës, thotë: "Zemra ka ushtrinë e saj të dukshme, të dukshme me sy. Këto janë duart, këmbët, sytë, veshët, gjuha dhe gjymtyrët e tjera të dukshme dhe të padukshme. Të gjitha janë në shërbim të zemrës dhe i binden zemrës. Zemra zotëron me to dhe i urdhëron ato. Organet janë krijuar t'i nën-

shtrohen zemrës, nuk mund t'i kundërvihen as t'i rebelohen asaj. Kur zemra i urdhëron syrit të shikojë - ai shikon, duart të kapin - ato kapin. Bindja e organeve ndaj zemrës është sikurse bindja e melekëve ndaj Zotit - nuk mund t'i kundërvihen as të gabojnë dhe vetëm bëjnë atë që kërkohet prej tyre. Megjithatë dallojnë në diçka. Melekët janë të vetëdijshëm për sexhden dhe nënshtrimin e tyre, për përkoresinë dhe përunjtërinë e tyre, kurse organet janë të pavetëdijshme për bindjen e tyre ndaj zemrës. Zemrës i nevojitet kjo ushtri sepse i nevojitet kafsha transportuese dhe furnizimi për rrugë për të cilën zemra është krijuar, kurse kjo është rruga drejt Zotit dhe kalimi i horizonteve dhe sferave për arritje atje. Kafsha transportuese e zemrës është trupi, kurse furnizimi është dija. Ajo që zemrën e çon deri te furnizimi është puna e mirë. Njeriu nuk mund të vijë te Allahu deri sa nuk është në trup dhe deri sa nuk e lë këtë botë. Shkallën më të ultë duhet ta lësh për të arritur deri te më e larta...".

Hyryja e njeriut në sexhden kozmike

Dijetarët klasikë myslimanë frymën, shpirtin njerëzor, në të vërtetë shpirtin e kanë vendosur në pjesën e sipërme të trupit, zemrës dhe kokës.

Pjesa e poshtme e trupit është epsh dhe hapësirë e epshit, e karakterit.

Në këtë mënyrë sexhden e kupton edhe Ibn Arabiu. Nëse sexhdeja e njeriut shikohet në hapësirë, në pllakën e rrafshët, vërehet se këto dy vende ku gjendet fryma njerëzore, janë të vendosura në rrafshin më të ulët të mundshëm. Ibn Arabiu shkon më tej dhe thotë: "Me sheriat namazliut i është caktuar që në sexhde të thotë: Subhane rabbije'l-a'la, tri herë. Herën e parë për sensibi-



Nëpërmjet  
sexhdes rrymon  
e vërteta, me të  
kalohet pas kohës  
dhe hapësirës

litetin dhe shqisat e tij, herën e dytë për intuitivitetin dhe imagjinatën e tij dhe herën e tretë për mendjen e tij. Kjo punë dhe ky veprim domethënë se E Vërteta (Zoti) e pastron (robin, njeriun e vet) në vendin ku atë e ka më së afërmi, dhe dëshiron që robi / njeriu të bëhet i njohur edhe nëpërmjet ndjenjave edhe nëpërmjet intuitës edhe nëpërmjet mendjes dhe me këtë t'i kundërvihet shejtanit.

Nuk është vështirë të përfundohej se Ibn Arabiu në aktin e sexhdes sheh hyrjen e plotë të njeriut në sexhden kozmike, një transformim, kthesë që ndodh befasisht, që për një çast e sjellë në harmoni kohën dhe amshueshmërinë.

Në bazë të tregimeve kuranore e dimë se qiejt dhe toka janë të ndërtuara në shtatë kate (shtresa), të cilët janë të fortë dhe të qëndrueshëm. Në trupin e njeriut



“Një njeri i tha Pejgamberit a.s.: ‘Lute Zotin që të më bëj nga ata që do ta fitojë ndërmjetësimin tënd’, kurse në këtë Muhamedi a.s. iu përgjigj: “Më ndihmo me shumësinë e sexhdeve tuaja.”!

pjesa më e fortë janë eshtrat. Për këtë Ibn Arebiu thotë: “Juristët islamë pajtohen se sexhdeja duhet bërë me ballë, por janë ndarë rreth asaj se a duhet prekur edhe hunda me tokën, sepse hunda nuk është asht, nuk është ashtu i pastër dhe sipas përbërjes së tij më tepër është muskul se sa asht. Hunda dallohet nga balli. Në hadith është udhëzim madhështor që sexhdeja të bëhet me ballë, domethënë që të bëhet me shtatë eshtra, duke filluar nga balli, “ndaj, mendo mirë për këtë, o njeri.”

Por, fjalët më madhështore për namazin, që Ibn Arebiu i ka thënë, janë: Zoti i ka urdhëruar krijesat të bëjnë sexhde kurse sexhden e ka bërë vendin dhe shkallën më të afërm të krijesave të Zotit me fjalët e veta: “Bën sexhde dhe afroju Krijuesit tënd!” Edhe sipas hadithit njeriu është më i afërm me Zotin kur është në sexhde. Ne e dimë se relacioni hapësinor

“mbi” është i njëjtë sikur edhe relacioni “nën” në raport me Ate, sepse, robi i cili është në sexhde para Allahut e kërkon me fytyrën e tij “poshtë” sikurse që robi me qëndrimin në këmbë kërkon “lartë”. Megjithatë robi në dua ngre fytyrën dhe duart e tij duke e kërkuar Krijuesin, edhe pse Ai ka bërë që sexhdeja të jetë më afër Allahut, atëherë e dimë se kjo ka të bëjë vetëm me njeriun. Zotin e madhërishtëm nuk e ka kufizuar ajo “mbi” nga ajo “nën”, as ajo “nën” nga ajo “mbi”, sepse Zoti është krijues edhe i asaj mbi edhe i asaj nën.

Kthimi në Burim dhe në Fillim

Zoti nuk është i kufizuar as me Arshin (Fronin Hyjnor), as me kozmosin, tokën e qiejt. Ai është më afër se damari i qafës sonë. Ai përshkon çdo gjë: Arshin, kozmosin, të dukshmen e të padukshmen, fillimin dhe fundin, të qartën dhe të fshehtë. Kurse njeriu në tokë është në gjendjen e kthimit në Burim dhe në Fillim. Gjatë qëndrimit në tokë, njeriu, sipas Ibn Arebiut, është në gjendjen e komentimit (te’vil), kurse me sexhde dhe namaz ai e përshpejton atë. Këtë gjendje e ka përshkruar bukur sufiu Abdul Kuddusi nga Gangohu:

“Muhamedi, pejgamberi arab, është ngjitur në Qiellin më të lartë dhe është kthyer në Tokë. Be-tohem në Krijuesin tim se sikur unë të arrija atje, kurrë nuk do të kthehesha.” (M. Ikbali, Ripërtëritja e mendimit fetar në Islam, Shkup, 2006, fq. 163).

Muhamedi a.s. për sexhden ka shprehur shumë hadithe:

“Me asgjë njeriu nuk mund t’i afrohet Zotit më shumë se sa nëpërmjet sexhdes së fshehtë.”

“Asnjë mysliman nuk do t’i bëjë sexhde Zotit, e që Ai mos ta ngrejë atë për një shkallë dhe do ta çlirojë nga mëkatet.”

“Një njeri i tha Pejgamberit a.s.: ‘Lute Zotin që të më bëj nga ata që do ta fitojë ndërmjetësimin / shefaatin tënd’, kurse në këtë Muhamedi a.s. iu përgjigj: “Më ndihmo me shumësinë e sexhdeve tuaja.”!

“Sexhdeja është dritë e përunj-tësisë e cila ndriçon nga brendësia në jashtësi!”

“Kur njeriu ta lexojë sexhden me rastin e leximit të ajetit Kur-anor të caktuar (tilavet) dhe të bëjë sexhde, shejtani vetmohet i përqaftur duke thënë: ‘Vallë për mua, njeriut i është urdhëruar sexhdeja, dhe iu bind dhe do ta fitojë xhenetin, kurse mua më është urdhëruar, e kam refuzuar dhe më përket xhehenemi!’”

Nëpërmjet sexhdes rrymon E Vërteta. Me atë depërtohet pas kohës dhe hapësirës, pas kalueshmërisë dhe shkatërrimit, me të depërtohet në ritmin e paraqitjeve më të larta të së Vërtetës dhe hyn në rrjedhën e krijesave që i janë drejtuar Krijuesit. Njeriu me sexhde kapërcen dimensionin hapësinor dhe pozitën e caktuar gjeografike dhe me tejkalimin e tyre hyn në dashurinë dhe fuqinë që e lëviz diellin dhe yjet. Prekja e ballit me tokën zgjon horizonte të panumërta, e bashkon atë që njeriu mendon se është e ndarë dhe pikërisht në sexhde njeriu, me shpirt dhe trup, e konfirmon atë detyrë madhështore që ia ka dhuruar Zoti.

Sexhdeja është miratim se jash-të asaj që njeriu e ka ndërtuar apo imagjinuar se është madhështore ka diçka edhe më madhështore. Me sexhden për një çast mësojmë se tërë ajo “më madhështorja nga veprat e poezisë, pikturës, muzikës, arkitekturës, nga konstrukcionet më largpamëse të religjioneve dhe të sistemeve filozofike deri te operacionet matematikore, është vetëm një kujtim i zbeh-të për jetën e papërkryer pas së cilës nuk vajtohet. ...

# Mendoni se ka edhe njerëz që me të vërtetë ju duan



**D**jaloshi për të cilin bëj fjalë është një i ri 28 vjeçar me aspirata të larta për jetën, me ideale të shumta, me një fuqi mendore me të vërtetë për t'u pasur zili. Por mbi çdo gjë, ajo që e karakterizon te këtë djalë të ri është një element mjaft i rëndësishëm që për të mund të thuhet se ishte edhe pasuria më e madhe që kishte, kuraja që i jepte vetes për të përballuar vështirësitë që shpalos jeta. Ndoshta jeta me të ishte sjellë disi ashpër, ndoshta edhe mund të kishte gabuar diku pasi nuk ka njeri të pagabueshëm, por ajo që e mbante gjallë atë për të përballuar atë fatkeqësi jetësore ishte pikërisht kuraja, kjo forcë dhe fuqi shpirtërore mjaft delikate dhe tërheqëse që e kishte bërë atë të palëkundur ndaj fatkeqësive me të mëdha që mund të sillte jeta.

Në një moshë të re, një ditë prej ditësh, tek po kërkonte t'i jepte një ndihmë disa të rinjve aty rrotull, djali prek me dorë një dinamit i cili në moment pasi shpërthen në dorën e tij, i shkakton edhe verbërimin për tërë jetën. Që nga ky moment faktikisht fillonte lufta me jetën, ballafaqimi me shumë e shumë vështirësi që për dikë që i mungon kuraja mund të ishin të pareaalizueshme. Vallë ç'duhet të bënte? T'i jepte fund jetës së tij? Mos vallë jeta është kaq e shkurtër sa ç'mund të mendohet për një çast të caktuar?

Së pari, ishte një dhunti e të madhit Krijues të gjithësisë që i dha atij një forcë shpirtërore të pallogaritshme. Më pas, me vullnetin e tij të fortë, përballë edhe familja

e cila nuk mungonte në asnjë çast për ta mbështetur dhe inkurajuar. Ai kërkonte të ecte përpara, kërkonte të çante dallgët e mëdha dhe të pamëshirshme që i kishin ardhur përsipër, kërkonte të kalonte të gjitha pengesat që i kishin dalë përpara, kërkonte që, edhe pse jetonte në botën e errësirës, të jepte shembullin më të mirë pasi ai i besonte në çdo moment një fuqie të madhe nxitëse brenda vetes së tij dhe atyre që e përkrahnin në këtë rrugë kaq të vështirë. Ashtu siç thuhet edhe në një ajet kuranor: **"Pas çdo vështirësie ka një lehtësim"** edhe në jetën e tij, me të vërtetë pas shumë e shumë vështirësish do të kishte patjetër një lehtësim, do të kishte patjetër një udhëkryq dhe pas tij një rrugëdalje mjaft të sigurt.

Allahu i Lartë i kishte dhuruar atij një mjeshtëri dhe një fuqi mendore tepër të fortë. Edhe pse i gjendur para një situatë të tillë, ai kishte kuptuar mjaft mirë se në këtë jetë nuk ishte i vetëm, kishte kuptuar faktin se njeriu ashtu siç jeton në hapat e para të tij, ashtu vazhdon të jetojë dhe si i tillë ashtu edhe vdes. Ai e kishte kuptuar se në vetvete ishte i singhtë dhe kështu që brenda tij nuk kishte ndjenja në mëdyshje, kishte kuptuar që ndjenjat ishin një pasuri e madhe, ato mblidhen dhe grupohen duke u jetuar dhe në këtë mënyrë edhe forcohen, dhe ishin pikërisht këto ndjenja që i kishin dhënë dhe vazhdonin t'i jepnin kurajë që shumë kush nuk e ka.

Verbëria, kjo botë e errësirës, nuk e kishte mposhtur, përkundrazi, e kishte bërë më të fortë se ç'duhet, e kishte bërë të palëkundur, i kishte hapur disa shkëndija drite në

mendjen e tij të cilat do t'i hapnin rrugën për një jetë të admirueshme, një jetë e cila kërkonte shumë përgjegjësi. Ndoshta kishte pasur momente apo çaste ku edhe kishte rënë në pesimizëm, por që më pas, një zë i brendshëm, një jehonë shpirtërore i kishte sjellë mesazhin e jetës: "vazhdo përpara se ka njerëz që të duan". Kjo ishte bërë për të një armë e sigurt që i kishte dhënë edhe kurajën e shumëpritur që do ta bënte atë të arrinte edhe shkallët e sukseseve.

Inteligjenca mendore që kishte vepruar si një ushqim i pashtershëm për shkollimin dhe arsimimin e tij nga njëra anë, teknologjia bashkëkohore e cila në çastet më të vështira nuk i kishte munguar nga ana tjetër, kishin bërë që ai të ishte përkrah të tjerëve. Në çdo vend ku kishte shkelur kishte hasur një famlje të dytë, kishte kontaktuar me njerëz që dëshironin të ishin pjesë e tij, kishte gjetur zemra të mbushura plot me dashuri. Edhe këtë herë ai kishte kuptuar se nuk ishte i vetëm në këtë jetë dhe se njeriu sa më shumë që ta përdorë vullnetin e tij aq më shumë forcohet. Dhe së bashku me këtë forcë madhore ai jepte mesazhin: **"Mendoni se ka edhe njerëz që me të vërtetë ju duan."**

Mendimtari i njohur Jostein Gaarder thoshte:

**"Sikur të mos sëmureshim fare, s'do ta dinim ç' domethënie ka shëndeti. Sikur mos ta shijonim urinë, s'do ta dinim ç' kënaqësi është të jesh i nginjur. Sikur mos të kish luftëra, s'do ta konceptonim vlerën e paqes..."**

# Ajetet Kuranore për familjen dhe fëmijët

**1.** Urdhëro familjen tënde të falë namaz, e edhe ti vetë zbatoje atë, ngase ne nuk kërkojmë prej teje ndonjë furnizim (për ty as për familjen tënde), Ne të furnizojmë ty (dhe ata), ardhmëria e mirë është e atij që ruhet. (Taha, Ajeti 132.)

**2.** Ai urdhëronte familjen e vet me faljen e namazit dhe me zeqatë, dhe ishte shumë i pranishëm te Zoti i tij. (Merjem, Ajeti 55.)

**3.** O ju që besuat, ruani veten dhe familjen tuaj prej zjarrit, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët... (Tahrim, Ajeti 6.)

**4.** Adhuroni Allahun e mos i shoqëroni Atij asnjë send, silluni mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmve, ndaj jetimëve, ndaj të varfërve, ndaj fqinjit të afërt, ndaj fqinjit të largët, ndaj shokut pranë vetes, ndaj udhëtarit të largët dhe ndaj robërve. Allahu nuk e do atë që është kryelartë dhe atë që lavdërohet. (Nisa, Ajeti 36.)

**5.** Thuj: "Ejani t'ju lexojë atë që me të vërtetë ju ndaloj Zoti juaj: të mos i shoqëroni Atij asnjë send, të silleni mirë me prindërit... (En'am, Ajeti 151.)

**6.** Dhe, dine mirë se pasuria e juaj dhe fëmijët tuaj janë vetëm një sprovë, dhe se te Allahu është shpërblimi i madh. (Enfal, Ajeti 28.)

**7.** Ne e kemi obliguar njeriun me punë të mira ndaj prindërve të vet, e nëse ata të dy përpiqen të shpijnë ty që të më përshkruash Mua shok (zot tjetër) për çka ti nuk di asgjë, atëherë ti mos i respekto ata. Kthimi juaj është te Unë, e Unë do t'ju njoftoj për atë që keni vepruar. (Ankebut, (të verifikohet emri i sures. I.D.) Ajeti 8.)

**8.** Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuroni tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as "of - oh", as mos u bën i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaju fjalë të mira (të buta respektuese). (Isra, Ajeti 23.)

**9.** *S'ka dyshim se pasuria juaj dhe fëmijët tuaj janë vetëm sprovë, ndërsa ajo që është tek Allahu, është shpërblim i madh. (Tegabun, Ajeti 15.)*

**10.** *Nuk është pasuria juaj, e as fëmijët tuaj ajo që ju afro pranë Nesh, është vetëm besimi dhe veprat e mira; të tillët shpërblehen shumëfish për atë që vepruan dhe ata janë në dhoma të larta të shpëtuar. (Sebe'e, Ajeti 37.)*

**11.** *O Zoti im, më bën mua nga ata që falin namazin, e edhe prej pasardhësve të mijë dhe pranoje lutjen time, o Zoti ynë! (Ibrahim, Ajeti 40.)*

**12.** *Ne e urdhëruam njeriun t'u bëjë mirë prindërve të vet, ngase nëna e vet me mundim e barti dhe me vështirësi e lindi, e bartja e tij dhe gjdhënia e tij zgjat tridhjetë muaj (e ai vazhdon të jetojë) derisa të arrijë pjekurinë e vet dhe kur t'i mbushë dyzet vjet ai thotë: "Zoti im, më inspiro mua që të falënderoj për të mirën tënde që ma dhurove mua dhe prindërve të mi, që të bëj vepra të mira që i pëlqen Ti dhe m'i bën të mirë pasardhësit e mi, unë pendohem te Ti dhe unë jam me myslimanët. (Ahkaf, Ajeti 15.)*

**13.** *... "Nëse na jep një (fëmijë) të mirë, (pa të meta), ne do të jemi falënderues ndaj Teje". (A'raf, Ajeti 189.)*

**14.** *Zekirjaja (a.s) e lut Zotin e tij e thotë: "Zoti im, falma edhe mua nga ana juaj një pasardhës (fëmijë) të mirë, vërtet, Ti je dëgjues i lutjes"! (Ali Imran, Ajeti 38.)*

**15.** *Zoti ynë, bëna neve të dyve besimtarë të singertë ndaj Teje dhe nga pasardhësit tanë, njerëz të bindur ndaj Teje, na i mëso rregullat e ibadetit (adhurimit) tanë dhe falna neve, vërtetë Ti je që falë shumë, je mëshirues!" (Bekare, Ajeti 128.)*

**16.** *Zoti ynë, dërgo ndër ta, nga gjiri i tyre të dërguar që t'u lexojë atyre ajetet Tua, t'u mësojë atyre librin dhe urtësinë, e t'i pastrojë (prej ndyrësisë së idhujtarisë) ata. S'ka dyshim se Ti je ngadhënjyesi, i dijsmi. (Bekare, Ajeti 129.)*

# Mburrja

## Sëmundja kryesore e zemrës



**A**snjë vepër e keqe, gabim ose djallëzi nuk do të mbetet me ne, Allahu përmes mirësisë të tij do të na pastrojë prej tyre në këtë botë para se të kthehemi tek Ai. Sa më lart të ngrehet njeriu, sa më i sinqertë të jetë ai në marrëdhënie me Allahun aq më transparente do të bëhen gabimet tek Ai. Ngritja për tek Allahu dhe afrimi për tek Ai, forcon dhe zgjeron logjikën e njeriut.

Bazuar në mëshirën dhe mirësinë e Muhamedid a.s, me të cilat Allahu xh.sh na ka nderuar, gjërat janë të thjeshta për ne. Pra ne nuk japin llogari për mendimet tona. Gjithsesi ne japim llogari për veprimet që vijnë si pasojë e këtyre mendimeve. Në fillim, kërkohej që individit të jepte llogari lidhur me mendimin. “Allahu i përket gjithçka që është në qiej dhe gjithçka që gjendet në tokë. Edhe në se e tregoni apo e fshihni çfarë keni në shpirtin tuaj, Allahu do tju kërkoj llogari për këtë. Kështu, Ai do të falë kë të dojë dhe do të dënojë kë të dojë. “Allahu është i fuqishëm për çdo gjë”

Por mëshira e lehtësoi këtë problem dhe Allahu xh.sh uli

ajetin: “Allahu nuk ngarkon askënd përtej fuqisë që ka, kurse në dëm të tij është e keqja që punon” [Kuran 2:286]

Njeriu pra nuk thirret për të dhënë llogari për një mendim që i kalon nëpër mendje, por ai jep llogari për frytet e këtij mendimi, për afirmimin e këtij mendimi i cili është një akumulim veprash. P.sh n.q.s. një mendim djallëzor që kalon në mendjen e myslimanit, në vend që të kërkojë mbrojtje nga Allahu, ai e afirmon këtë mendim. Ky afirmim është gabim (shkelje) për të cilin ai do të japë llogari. Megjithatë udhëtarit për tek Allahu dhe kushdo

Njeriu pra nuk thirret për të dhënë llogari për një mendim që i kalon nëpër mendje, por ai jep llogari për frytet e këtij mendimi, për afirmimin e këtij mendimi i cili është një akumulim veprash

që kërkon afërsi për tek Allahu xh.sh nuk është i kënaqur me problemet që arrijnë këtë fazë. Ata e dinë se megjithëse nuk thirren për të dhënë llogari lidhur me mendimet individuale, është gjithashtu e vërtetë se çdo vepër e mirë fillon me një mendim të mirë dhe çdo vepër djallëzore fillon me një mendim djallëzor. Prandaj ata i thërrasin mendjes para se këto mendime të kalojnë në vepra

Nefsi djallëzor ka fuqinë e shumë gabimeve dhetributeve jo të lavdërueshme. Kur këto gabime dhetribute jo të lavdërueshme e mbërthejnë njeriun, ato e zbehin dhe degradojnë punën e tij. D.m.th ato ulin dhe zvogëlojnë efektin e asaj vepre të veçantë në zemër. Mund të jetë edhe rasti Zoti na ruajtët, që kjo mund ta çojë në zero veprën e adhurimit. Si rezultat nuk ka fryt nga kjo vepër adhurimi, ajo nuk mund të shpëtoj nga vuajtja dhe shqetësimi. Për këtë i Dërguari i Allahut xh.xh ka thënë: “Ka shumë njerëz që agjërojnë dhe prej agjërimit të tij nuk kanë veçse urinë dhe shqetësim”. Në një transmetim tjetër thuhet “vuajtje” dhe në një tjetër “etje” dhe pse?

Kjo sepse të tillë njerëz janë pa cilësi të larta morale dhe sinjeritet të cilat sigurojnë veprën e adhurimit si të bërë për hir të Allahut xh.sh.. Këto janë attribute negative të cilat mund të ndodhin (bien) në vepër dhe n.q.s nefsi nuk pastrohet nga këto attribute, çdo lloj veprë adhurimi që personi ndërmerr, mund të kundërshtohet dhe efekti i saj në zemër dobësohet.

Është punë e adhurimit vetë, përfeksioni i saj, pranimi i veprave të adhurimit dhe pastaj vjen efekti që ndjek nga ky pranim. Për këtë arsye, puna virtuale është fillimi i afrimit për tek Allahu. Njeriut i intereson vetëm që asgjë të mos ndërhyjë në mënyrë që të sillte mospërfeksionimin në adhurime.

Pastaj pas kryerjes së punës së adhurimit dhe përfeksionit të saj, njeriu mbetet në një gjendje frike me pak përsa i përket pranimit, sepse kjo gjë është vetëm në duart e Allahut xh.sh në të kaluarën, sherbyesit virtuoze të Allahut ishin shumë të interesuar me të vërtetë të merakosur, rreth pranimit të veprës së adhurimit më shumë se ç'ishin të interesuar rreth vetë veprës së adhurimit në të vërtetë merakë i tyre rreth vepër së adhurimit dhe përsosmerisë së saj, buronte nga interesimi dhe shqetësimi për pranimin e saj. Pas pranimit vjen fryti i pranimit, dhe fryti i pranimit është drita që injektohet në zemër. Kjo dritë nuk lind nga vepra e adhurimit, por më shumë nga pranimi i veprës së adhurimit. Kur pranimi afrohet nga Allahu

Është punë e  
adhurimit vetë,  
përfeksioni i saj,  
pranimi i veprave  
të adhurimit dhe  
pastaj vjen efekti  
që ndjek nga ky  
pranim

xh.sh, ajo ndriçon zemrën dhe pastrohet nefset. Më të vërtetë është Allahu Ai që të pastrohet "i shpëtuar është ai që pastrohet". [Kuran 87:14]

Ato që janë pastruar janë me të vërtetë të begatë. Fryti i përpjekjeve është pranimi, dhe fryti i pranimit është që Allahu xh.sh pastrohet nefset e njeriut.

Atributet kryesore jo të lavdërueshme

Ka shumë attribute të cilat Allahu nuk do që robërit e Tij t'i marrin lehtë dhe t'i zvogëlojnë. Besimtarët duhet të përpiqen që të çlirojnë veten nga këto attribute. Atributet kryesore jo të lavdërueshme janë katër:

1. Vetëlavdërimi .
2. Mendjemadhësia ose arroganca (kibr.)
3. Hipokrizia (rija)
4. Zilia (hased.)

Këto katër attribute mëmë lindin të tjera

Vetëlavdërimi (mburrja), kjo është shkallë për attribute të

tjera.

Mburrja ndodh kur dikush është i pavëmendshëm, që nuk e kupton fuqinë e Allahut ndaj tij, që Allahu na ka dhënë (hijeshinë), aftësinë për të bërë vepra bindjeje. Allahu na ka urdhëruar që të përpiqemi të përsosim veprat tona të fitrimit.

Allahu na ka urdhëruar që të përpiqemi të bëjmë çfarë ai na urdhëron të bëjmë dhe ai gjithashtu na urdhëron që të përpiqemi për të përsosur veprimet tona të lindjes për më tepër, Allahu na bën të ditur se përpjekja jonë drejt përfeksionit dhe pranimi që vjen më pas, është e gjitha bujari e pastër e Allahut xh.sh. Po të mos ishte mirësia e tij aftësuese asnjë nuk do të ishte në gjendje t'i bindet Atij. Asnjë nuk do të ishte në gjendje t'i kushtojë bindjes dhe asnjë nuk do të ishte i vendosur në bindje.. Kur kjo ide dhe ky perceptim mungon në zemër dhe njeriu pushon së provuari ose së ndjeri atë, atëherë sëmundja e vetëlavdërimit (mburrjes) sigurisht që do ta bëjë të vuajë. Lavdia në nefsi është kuptimi se ato kanë bërë diçka përmes pushtetit, aftësisë, përpjekjes së tyre. Po njeriu është i aftë të jetë i vendosur dhe perfekt. Në të vërtetë është ai që bën përpjekje. Kjo gjë thuhet në ajetin: "Kjo më është dhënë vetëm prej diturisë sime" [Kuran 28:78]. Me fjalë të tjera, duke ngarkuar (caktuar) të gjithë çështjen tek ai njeri (nga njëra anë) por duke dështuar (nga ana tjetër) për t'ia ngarkuar atë mirësisë aftësuese të Allahut.

Kjo është ajo që quhet vetë-

# XHELOZIA NË ISLAM

**F**oja jonë i jep rëndësi të veçantë moralit. Pejgamberi (s.a), ka thënë: “Me të vërtetë jam dërguar që t’i përsos virtytet e mira.” (Ahmedi)

Kur Allahu e zgjodhi Muhamedin (s.a), pejgamber, ky i pranoi sjelljet e mira që i kishin arabët në injorancë, i mënjanoi sjelljet e këqija dhe i përmirësoi ato që duhej.

Xhelozia ndaj nderit të vet ka qenë njëri nga virtytet që kanë pasur arabët në kohën e injorancës. Disa prej tyre kanë qenë aq ekstremistë në këtë çështje, sa që i kanë mbytur vajzat e tyre kur kanë qenë të vogla, nga frika se kur të rriten do të bëjnë imoralitet. Sheriati e ka ndaluar mbytjen e vajzave. Kurse vetinë e xhelozisë e ka përmirësuar dhe e ka bërë një prej degëve të imanit. Pejgamberi (s.a), thotë: “Askush nuk është më xheloz se Allahu”. (Buhari)

Mbjellja e xhelozisë në shpirtat e myslimanëve për të afërmet e tyre, është prej formave të shkëlqyera të nderimit të gruas në Islam. E kjo është një virtut i lartë dhe një cilësi e ndershme që gjendet në zemrën e myslimanit, e cila e shtyn atë të përkujdeset për të afërmet e tij, t’i ruajë ato, ta mbrojë nderin e tyre dhe e bën që t’i ndalojë ato prej zbulurimeve dhe përzjerjes me burra të huaj.

Islami e llogaritë xhihad (luftë e shenjtë në rrugën e Allahut) mbrojtjen e nderit dhe xhelozinë për të afërmet, për të cilën gjë derdhet gjaku dhe flijohet jeta, ndërsa personi i tillë shpërblehet me gradën e shehidit në xhenet. Transmetohet nga Se’id bin Zejd të ketë thënë: “E kam dëgjuar të dërguarin e Allahut të thotë: “Kush

vritet duke e mbrojtur pasurinë e tij është shehid. Kush vritet duke e mbrojtur vetveten e tij është shehid. Kush vritet duke e mbrojtur fenë e tij është shehid, dhe kush vritet duke e mbrojtur familjen e tij është shehid”. Në një transmetim tjetër: “Kush vritet duke e mbrojtur nderin e tij, është shehid”. (Ebu Davudi dhe Tirmidhiu)

Bile, Islami e konsideron xhelozinë prej virtyteve më të larta të imanit (besimit). Transmeton Mugireh bin Shu’beh se Sa’d bin Ubadeh ka thënë: “Nëse e shoh një burrë (të huaj) me gruan time, do ta godas me shpatë të mprehtë”. I arrin të dërguarit të Allahut (s.a), kjo që ka thënë Sa’di dhe Pejgamberi (s.a), thotë: “A po çuditëni prej xhelozisë se Sa’dit?! Unë jam më xheloz se ai, ndërsa Allahu është më xheloz se unë, dhe, për shkak të xhelozisë së Allahut, janë bërë haram të këqijat e dukshme dhe të fshehta” (Transmeton Buhariu dhe Muslimi).

Në lidhje me xhelozinë në Islam ka shumë hadithe, ndër ta mund të përmendim;

“Allahu xhelozon, por edhe besimtari xhelozon. Xhelozia e Allahut vjen në shprehje kur një besimtar i bën ato vepra që ia ka ndaluar Allahu”. (Buhari dhe Muslim)

Pejgamberi (s.a), në hutben që e ka mbajtur gjatë errësimit të diellit, ka thënë: “O umet i Muhamedit! Askush nuk është më xheloz se Allahu.” (Buhari dhe Muslimi)

“Ka xhelozë që e do Allahu...”. (Ahmed, Ebu Davud dhe Nesai)

Sahabët e Pejgamberit (s.a), janë kapur për këtë virtut pejgamberik dhe ia kanë dhënë të njëjtën pozitë që ua kanë dhënë degëve tjera të ima-

nit, andaj nuk është e çuditshme që ndonjëri prej tyre të vrasë ose të vritet nga shkak i xhelozisë.

Tregon Ibën Hishami se një grua arabe solli me vete disa mallra për t’i shitur në tregun e fisit Beni Kajnuka (një prej fiseve çifute) dhe u ul pranë një argjendari. Ata (çifutët) kërkuan që ta zbulonte fytyrën, kurse ajo e refuzoi këtë gjë. Argjendari duke mos e hetuar ajo, i kapi rrobat e saja dhe i lidhi. Kur u ngrit, asaj iu zbulua trupi, me çka ata u qeshën, kurse ajo bërtiti. Atëherë u ngrit një mysliman dhe e mbyti argjendarin, i cili ishte çifut, kurse nga ana tjetër u mblodhën çifutët dhe e vranë këtë mysliman. U nis Pejgamberi (s.a), drejt tyre dhe i rrethoi derisa iu dorëzuan, e atëherë Pejgamberi i dëboi në Sham.

Në këtë gjendje kanë vazhduar të parët e umetit tonë dhe nuk e kanë lënë pas dore këtë sjellje as në momentet e dobësisë, që kanë përjetuar. Kur i kanë okupuar kryqtarët disa vende myslimane, përafërsisht për dy shekuj, disa myslimanë filluan të mendojnë se asnjëherë nuk do të lirohen, derisa të vijë Isai (a.s.). Myslimanët i kanë shikuar të krishterët me nënçmim dhe nënvlerësim, sa që i kanë konsideruar dejutha, njerëz të cilët duke ecur me gratë e tyre, takoheshin me burra të huaj, e burri largoheshin duke i lënë të flasin në vetmi, aq sa donte gruaia.

Historia është plot shembuj, të cilët rrëfejnë për xhelozinë dhe përkujdesjen e madhe që kanë pasur myslimanët për të afërmet e tyre.

Prej këtyre shembujve të çuditshëm është edhe rasti, të cilin e ka cekur Ibnul-Xhevzij, në librin e tij El-Muntedham: “Thotë Muhamed



Kush vritet duke e mbrojtur pasurinë e tij është shehid. Kush vritet duke e mbrojtur vetveten e tij është shehid. Kush vritet duke e mbrojtur fenë e tij është shehid, dhe kush vritet duke e mbrojtur familjen e tij është shehid.

bin Musa el-Kadij: "Kam marrë pjesë në një seancë gjyqësore të gjykatësit Musa bin Is'hak el-Kadij, në qytetin Rejj, në vitin 286 hixhri. Një grua dhe i afërmi i saj kishin ardhur te gjykatësi. I afërmi i gruas pretendonte se burri i kishte premtuar asaj për mehër (dhuratë nusërie) pesëqind dinarë, mirëpo burri refuzonte një gjë të tillë. Atëherë, gjykatësi i drejtohet të afërmit të gruas: "A ke dëshmitarë për një gjë të tillë?" Ai thotë: "Po, ata janë prezentë." Gjykatësi e thërret njërin prej dëshmitarëve që ta shohë gruan për të cilën dëshmon. Ai afrohet dhe kërkon prej gruas që të zbulojë fytyrën, ashtu që të dijë se për kë po dëshmon. Burri thotë: "Çka po veproni?" Gjykatësi i shpjegon atij se gruaja duhet ta zbulojë fytyrën, ashtu që dëshmitari ta dijë se për kë po dëshmon. Kur dëgjon këto fjalë, burri thotë: "Dëshmoj para gjykatësit se unë ia jap asaj atë mehër që kërkon prej meje, por mos ta zbulojë fytyrën". Informohet gruaja për atë që ka thënë burri dhe thotë: "Dëshmoj para gjykatësit se unë ia dhuroj atij këtë mehër dhe ia fali atë në këtë botë dhe në ahiret." Atëherë, gjykatësi tha: "Le të shkruhet kjo prej virtyteve të larta të moralit." (El-Muntedham i Ibën Xhevziut)

Shikoni vëllezër myslimanë se si të parët tanë kanë pasur xhelozë për gratë e tyre që të mos iu shikohet as fytyra jo më diçka tjetër, ndërsa myslimanët e sotëm nuk e kanë problem se iu dalin gratë, motrat, vajzat..., komplet të zbuluara, me të shkurtëra, me të ngushta, me të tejdukshme, ku iu duken pjesët e trupit pothuajse komplet. Ka edhe të tjerë që dalin dhe shëtisin me to në këtë gjendje, duke mos e pasur problem se ia shikojnë të

tjerët, në disa raste edhe duke u krenuar me to.

Prej mungesës së xhelozisë, është edhe lejimi i gruas të udhëtojë pa njeri të afërm, kurse Pejgamberi (s.a.), ka thënë: "Asnjëherë të mos vetmohet një grua me një burrë të huaj pa pasur mahrem (njeri të afërm) dhe asnjëherë mos të udhëtojë ndonjë grua pa mahrem." Ungrit një njeri dhe tha: "O i Dërguari i Allahut, gruaja ime ka udhëtuar për në haxh, kurse unë jam regjistruar të marr pjesë në këtë e këtë betejë." Pejgamberi (s.a.), i tha: "Shko dhe bëje haxhin me gruan tënde." (Buhari dhe Muslim)

Pra, ky njeri, edhe kur do të bënte xhihad në rrugë të Allahut, Pejgamberi (s.a.), e urdhëroi të largohet nga beteja për ta shoqëruar gruan e tij, e cila kishte dalë në një udhëtim të ndershëm, udhëtim të haxhit, me njerëzit më të devotshëm dhe më të ndershëm. Pra, edhe pas gjithë kësaj, Pejgamberi (s.a.), i ka thënë: "Shko dhe bëj haxh me gruan tënde"

E kundërta e xhelozit është dejjuthi. Dejjuthi është ai, që e miraton të keqen në familje të vet dhe nuk ka xhelozë për ata, kurse në Islam ka ardhur një kërcënim i ashpër për këtë lloj të njerëzish. Transmeton Abdullah bin Umeri se i dërguari i Allahut ka thënë: "Tre lloje të njerëzish Allahu az-ze ve xhel nuk do t'i shikojë Ditën e Gjykimit: atë që nuk i respekton princërit, një grua që i përngjanë burrave dhe dejjuthin." (Ahmedi)

Të nderuar besimtarë me aq sa pamë më sipër, kuptohet qartë se myslimani duhet të jetë xheloz dhe të mos pajtohet me të keqen. Por të mundohet me çdo kusht, sipas mundësisë që ka, ta dallojë atë.

Të jetojmë sipas besimit e jo sipas traditave, sepse nëse do të jetojmë sipas traditave e jo sipas besimit do të vijmë në një pikë që zakonet të vlerësohen si besim. Një shprehje e urtë turke thotë: "Nëse nuk jeton sipas besimit, atëherë do të fillosh të besosh sipas mënyrës së jetesës që bën". Këtë e kemi fakt në shoqërinë tonë. Po japim një shembull krejt të thjeshtë. Para komunizmit gratë myslimane në përgjithësi kanë qenë të mbuluar, me ardhjen e komunizmit si shumë gjëra tjera fetare edhe mbulesa u ndalua. Dhe kështu gratë myslimane ishin të mbuluar u mësuan me zbuluesin deri në atë pikë sa që një pjesë e mirë e tyre pasi u rihapë feja, filluan ta shikojnë mbulesën si diçka jo të mirë. Këto gra që dikur jo vetëm që kanë qenë të mbuluar por edhe me byrde (perçe), kur mbulohet ndonjë vajzë e re, ndër të tjera i thonë asaj: Si je mbuluar? Ti je e re. Është gjynah me i mbuluar ata farë flokësh, ato farë këmbësh etj. Këto harrojnë se mbulesa është urdhër Allahut (xh.sh), dhe harrojnë se urdhrat e Allahut nuk ndryshojnë, janë të njëjtë si për myslimanët në kohën e Profetit (a.s) ashtu edhe për myslimanët e tjerë deri në kiamet, pa u ndryshuar. Të jetuarit ndryshe nga ajo që kërkon besimi është fatkeqësi e madhe. Me kalimin e kohës gjërat e këqija fillojnë e konsiderohen të mira, ndërsa ato të mirat të këqija.

E lus Allahun Fuqiplotë që t'ju kthejë myslimanëve këtë cilësi të humbur, për të cilën sot më shumë se asnjëherë kanë nevojë për të. Në këtë kohë kur pjesa dërmuese e myslimaneve kanë marrë modën e huaj, dhe kanë lënë pas dore urdhrat e Krijuesit të tyre.

# FAMILJA DHE RËNDËSIA E SAJ

Kurorëzimi është mjeti dhe hapi i parë për përgatitjen dhe formimin e familjes, përveç se është një marrëveshje normal, ai është edhe një akt i cili mundëson afrimin tek All-llahu.

Familja është bashkësia më e vogël sociale në të cilën lind, rritet, zhvillohet njeriu dhe në të cilën e merr edukatën e parë. Mirëpo edhe pse është bashkësia më e vogël, ajo posedon rolin më të madh në bashkësi. Sepse bashkësia është organizim i cili përbëhet nga familja dhe anëtarët e saj.

Kur'an-i Fisnik na informon se njeriu i parë dhe babai ynë Ademi a. s. posedonte një familje dhe se nga ky çift i parë në sipërfaqen e tokës u krijua familja e parë e tyre bashkë me fëmijët që linden.<sup>1</sup>

Atëherë pra, shihet se familja pikë së pari qenka një çerdhe në të cilën njeriu gjen lumturinë. Por kur të mendojmë edhe lumturinë shpirtërore dhe shëndetin trupor që janë të pashmangshme, kuptojmë se sa rëndësi dhe vlerë të madhe posedon kjo çerdhe. Përkrah kësaj, familja përgatit vendin dhe shtresën se si të jetohet në mënyrë njerëzore. Mos mundësisë së jetesës në vetmi që nga krijimtaria e njeriut, familja i mundësoi atij formimin e një personaliteti dhe ngrohësin, shijen e përbashkët intime në mes dy gjinive.

Familja është bashkësia që ka

për qëllim ndërtimin e pashmangshëm të jetës më kuptimplote për të jetuar në të. Për këtë shkak, së bashku me ndërrimin dhe ndryshimin e përmbajtjes dhe mentaliteteve, të gjitha normat juridike, janë munduar që t'i fusin në harmoni marrëdhëniet e jashtme dhe të brendshme të saj dhe për këtë shkak, është formuar dega *E Drejta Familjare*.

Kurorëzimi është mjeti dhe hapi i parë për përgatitjen dhe formimin e familjes, përveç se është një marrëveshje normal, ai është edhe një akt i cili mundëson afrimin tek All-llahu.

Pejgamberi (a.s.) ka thënë: *"Një besimtar pas frikës së All-llahut dhe veprimit të urdhrave të Tij, nuk ka dobi/begati më shumë përveç se me një grua të ndershme. Sepse kur ai ta urdhëroje gruan e tij për diçka, ajo e dëgjon fjalën e tij, kur ta shikoje fytyrën e saj bëhet i lumtur, nëse betohet mbi të, betimi i tij del i saktë, kur ai (burri) del jashtë ajo e ruan namusin, moralin dhe pasurinë e tij".<sup>2</sup>*

Si specifika themelore të familjes islame mund të numërojmë:

A. Bashkësia e cila formohet nga prindërit dhe fëmijët, është grupi më i vogël familjar që rrjedh nga martesja, fëmijët dhe anëtarët

tjerë të saj. Në këtë mënyrë përkufizohet bashkësia familjare. Në mesin e këtyre përkufizimeve, për të gjetur ngrohtësinë dhe afërsinë që familjen e bën familje, është një punë e madhe. A thua, vërtet familja përbëhet nga një grup i thjeshtë? A thua është e mjaftueshme që atë ta shohim apo cilësojmë familje me bashkimin e disa individëve nga radha njerëzore? Natyrisht se një grup, ngjarje, cilësi që i reflektojnë jashtë virtytet e tyre, duke u bazuar në disa gjëra konkrete, etimologjikisht shpjegohen në një mënyrë. Mirëpo në shumicën e rasteve këto grupe, ngjarje, cilësi pasi që mundë të jenë pak si joreale/zmadhuese, nuk e përkufizojnë apo nuk i japin një shpjegim të vërtet. Kur shikojmë kuptimin fetar Islam të familjes e cila është nga kategoritë e dobëta njerëzore, shohim se si një bashkësi ajo e nxjerrë përpara vetes një shpirt mbi të cilin e ndërton vetveten. Ky shpirt është "qetësi, lumturi, dashuri dhe mëshirë". Allahu i Madhëruar i cili e krijoi njeriun, në Kur'anin Famë lartë thotë: *"Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë"* (Rrûm, 30/21). Atëherë, pra për një familje të shëndoshë

1. El-Bekare, 2/35; Máide, 5/27; A'râf, 7/19; Tâhâ, 20/117-119.

2. Ebû Dâvûd, Zekât, 32; Ibni Mâxhe, N - kâh, 5.

Në familjen Islame,  
fëmijët kanë një vlerë  
të madhe si një amanet  
i Allahut. Fëmijën e  
dhuron vetëm Allahu xh.  
sh. dhe vetëm Ai cakton  
gjininë e tij



islame duhet që të ekzistojë një qetësi, rahat apo një burim dashurie e respekti. Në këtë familje, nëna dhe babai janë ata që përqafohen njëri me tjetrin dhe sjellin lumturi, kurse fëmijët janë ata të cilët nga kjo lumturi e njohin këtë botë dhe në këtë mënyrë të gjithë së bashku me dashuri e mëshirë krijojnë dhe fitojnë personalitete të shëndosha.

**B.** Nëna dhe babai janë faktorët dhe vlera kryesore në familjen Islame. Ata, aspak nuk shqetësohen. Dëshirat dhe kërkesat e tyre menjëherë realizohen – nëse këto janë të lejuara. Tregohet një kujdes i madh që ata të mos dëshpërohen. Kjo është një cilësi dhe vlerë e rëndësishme Islame sa që në Kur'an, menjëherë pas besimit në All-llah është cekur vlera dhe rëndësia e respekti i prindërve. *“Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuroni tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as “of - oh”, as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaju fjalë të mira (të buta respektuese)”* (Isrâ', 17/23). ; *“Thuaj: “Ejani t’ju lexojë atë që me të vërtetë ju ndaloi Zoti juaj: të mos i shoqëroni Atij asnjë send, të silleni mirë me prindërit, të mos i mbytni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, sepse Ne u ushqejmë juve dhe ata”*

(En’âm, 6/151). All-llahu i cili neve na ka obliguar që vetëm Atë ta e falënderojmë, e ka cekur menjëherë pas kësaj edhe respektin, shkallën dhe rëndësinë e prindërve dhe se edhe falënderimin ndaj tyre, duke thënë: *“...Ne (e porositëm njeriun) të jetë mirënjohës ndaj Meje dhe ndaj dy prindërve tu...”*. (Lukmân, 31/14). Kur pak më lartë cekëm se “çdo dëshirë e prindërve realizohet/bëhet” këtë e kufizuar vetëm në “kufi të lejuar”. Ja pra, këto kërkesa të lejuara i ka bërë të ditura dhe i ka cilësuar në mënyrë të përgjithshme si “Vlera dhe Norma Islame”, pastaj ka urdhëruar: “Thuaj (o i dërguar): *“Në qoftë se etërit tuaj, djemtë tuaj, vëllezërit tuaj, bashkëshortet tuaja, fafesi juaj, pasuria që e fituat, tregtia që frikoheni se do të dështojë, vendbanimet me të cilat jeni të kënaqur, (të gjitha këto) janë më të dashura për ju se All-llahu, se i dërguari i Tij dhe se lufta për në rrugën e Tij, atëherë, pritni derisa All-llahu të sjellë vendimin e Tij. All-llahu nuk vë në rrugën e drejtë njerëzit e prishur”*. (Teëbe, 9/24) Atëherë, nëse prindërit kërkojnë diçka jashtë kornizës, ligjeve të All-llahut dhe Pejgamberit të Tij, kjo nuk është obligim për fëmijët e tyre. Pra këto dëshira nuk mund të u plotësohen. Lidhur me këtë çështje në Kur'an cekët edhe një ajet tjetër: *“E nëse ata të dy tentojnë që ti të më përshkruash Mua shok, për çka*

*ti nuk ke kurrfarë fakti, atëherë mos i respekto ata, po në çështjet e jetës së kësaj bote të kesh mirë-kuptim ndaj tyre, e ti ndiqe rrugën e atij që është i kthyer kah Unë, mandej kthimi juaj është tek Unë, e Unë do t’ju njoftoj për atë që keni punuar”*. (Lukmân, 31/15). Në realitet, që të dy ajetet e shohin të arsyeshme dhe kërkojnë që edhe gjendja e tyre e brendshme e edhe marrëdhëniet jashtë saj, të jetë dhe ndërtohet sipas normave dhe vlerave Islame. Kjo donë të thotë që: *Familja Islame është ajo familje që jeton ashtu siç e kërkon Allahu dhe i dërguari i tij.*

**C.** Në familjen Islame, fëmijët kanë një vlerë të madhe si një amanet i Allahut. Fëmijën e dhuron vetëm Allahu xh. sh. dhe vetëm Ai cakton gjininë e tij. Pastaj, Allahu xh. sh. kërkoj nga nëna dhe babai që atë ta edukojnë në mënyrën më të mirë, ku thotë: *“Vetëm i All-llahut është pushteti i qiejve e i tokës; Ai krijon çka të dojë; Ai i falë vetën femra atij që do; e i falë vetëm meshkuj atij që do. Ose u falë çift, meshkuj e femra, por atë që do e lë pa fëmijë (steril); Ai është i dijshëm, i fuqishëm”*. (Shûrâ, 42/49-50).; *“S’ka dyshim se kanë dështuar keq ata që mbytën fëmijët e tyre nga mendjelehtësia e pa kurrfarë dije dhe ata që duke i shpifur Zotit, shpallën të ndaluar atë që Zoti u kishte dhuruar. Ata*

kanë humbur rrugën e drejtë dhe prej fillimit nuk ishin në udhëzim” (En’âm, 6/140). Në realitet, fëmijët të cilët janë fuqia morale, lumturia dhe jeta e familjes, është një nga çështjet dhe sprovat më të mëdha dhe të rëndësishme të botës. Edukata dhe virtyti që u jepet fëmijëve, janë shkaqet që fëmijët më së shumti caktojnë vendin e prindërve dhe ndihmojnë shpëtimin e tyre në ahiret. Tu kthehemi edhe një herë ajeteve: *“Dine se pasuria e juaj dhe fëmijët tuaj janë vetëm një sprovë, dhe se te All-llahu është shpërblimi i madh”* (Enfâl, 8/28). ; *“O ju që besuat, as pasuria juaj e as fëmijët tuaj të mos u shmangin prej adhurimit të All-llahut, e kush bën ashtu të tillët janë mu ata të humburit”* (Munâfikûn, 63/9). ; *“pasuria dhe fëmijët janë stoli e kësaj bote, kurse veprat e mira (fryti i të cilave është i përgjithshëm) janë shpërblimi më i mirë te Zoti yt dhe janë shpresa më e mirë”* (Kehf, 18/46). Ja, mu për këtë shkak, familja muslimane e edukon fëmijën e sajë për këtë shkak dhe mundohet që të formojë një shembull personaliteti të gjallë të Islamit. Këshilla e Llukmanit a. s. që i kishte bërë të birit, është një shembull shumë korrekt për ne. Në Kur’an cekën këshillat e tija: *“O djali im, s’ka dyshim se edhe ajo (vepra) peshon sa kokrra e lirit, e të jetë e fshehur në rrasë guri, ose në qiej apo në tokë, All-llahu do ta sjellë atë, se All-llahu është i butë dhe hollësisht i informuar. O djali im, fale namazin, urdhëro për punë të mira, e ndalo nga të këqijat, përballlo me durim çdo gjë që të godet, vërtet, këto janë nga çështjet më të preferuara. Dhe mos shtrembëro fytyrën tënde prej njerëzve, mos ec nëpër tokë kryelartë, se All-llahu nuk e do asnjë mendjemadh e që shumë lavdërohet. Të jesh i matur në ecjen tënde, ule zërin tënd, se zëri më i egër (shëmtuar) është zëri i gomarit”*. (Lukmân, 31/16-17). Në këtë kontekst edhe Pejgamberi a. s. thotë: *“Pasuria më e mirë që mund të t’i leje një prind fëmijës së tij është*

*emërtimi me një emër të mirë dhe edukata e shkëlqyeshme”*.<sup>1</sup>

D. Një veçori tjetër e familjes islame është që çdokush të kryejë obligimin me plotë përpikëri dhe dëshirë ibadeti të kësaj çerdheje. Themi me dëshirë ibadeti sepse obligimet familjare janë cekur në Kur’an, sunnet dhe në konceptin e përgjithshëm të fesë, dhe është kërkuar nga muslimanët që në këtë çështje të kenë kujdes. Detyrat tona në mënyrën më të përgjithshme në suren Nisa cekën: *“Burrat janë përgjegjës për gratë, ngase All-llahu ka graduar disa mbi disa të tjerët dhe ngase ata kanë shpenzuar nga pasuria e tyre. Prandaj, me atë që All-llahu i bëri të ruajtura, gratë e mira janë res-*

Familja është bashkësia që ka për qëllim ndërtimin e pashmangshëm të jetës më kuptimplote për të jetuar në të

pektuese, janë besnike ndaj të fshehtës” (Nisâ, 4/34). Në një thënie tjetër Pejgamberi a. s. cek edhe sjelljet dhe obligimet morale e juridike, edhe ato intime dhe trupore, e edhe detyrat tjera që çdokush duhet t’i kryejë: *“Më i miri nga ju është ai i cili sillet më së miri me familjen e tij. Edhe unë sillem më mirë me familjen time”*.<sup>2</sup> Kur ndonjëherë në mes bashkëshortëve ndodhin mosmarrëveshje, mund të çojnë në moskujdesin e kësaj detyre por edhe në ndarjen e çerdhes familjare. All-llahu xh. sh. thotë: *“O ju që keni besuar! Çoni jetë të mirë me*

*gratë tuaja. Nëse urreni ato, bëni durim që All-llahu të japë shumë të mira në një send që ju e urreni”* (Nisa, 4/19) dhe *“Nëse ndonjë grua i frikësohet largimit ose ftohjes së burrit të vet ndaj asaj, atëherë nuk gabojnë po qe se bëjnë mes vete mbarim (pajtim). Pajtimi është më i dobishmi.”* (Nisa, 4/128).

E. Kujdesi i familjes ndaj individëve që janë jashtë kësaj çerdhe, e formon edhe një themel tjetër të familjes islame. Në atë mënyrë sikurse një musliman nuk është egoistë që kujdeset vetëm për vetveten, po ashtu edhe familja islame e dinë se ka përgjegjësi morale – juridike, dhe kujdeset edhe për krijesat tjera që janë jashtë sajë. Farefisnia është grupi i parë ku një familje muslimane ka përgjegjësi jashtë obligimeve të veta. Njerëzit që janë përgjegjës për të njëjtën gjë, qoftë nëna apo babai, duhet që të ndajnë të njëjtat gëzime dhe hidhërime me ta. Ruajtja e farefisnisë, nga ana Kur’anore vlerësohet si një cilësi e pashmangshme. Në të kundërtën, ata që si venë rëndësi kësaj, cilësohen si “humbës”, “shkaktarë të problemeve”, “të mallkuar dhe dënuar me xhehennem”. Nëse një musliman e lexon këtë ajet dhe mendon pak mbi të, sigurisht se do të bëhet nga grupi i parë: *“Ata që e mbajnë lidhjen (familjare) për të cilën All-llahu ka urdhëruar të mbahet, që frikësohen nga Zoti i tyre dhe nga llogaria e rëndë e përgjegjësisë”* (Rad, 13/21).

F. Një nga çështjet më themelore që familja islame aspak nuk duhet ta anashkalojë, padyshim se është edhe dituria, shkenca, kultura, zanati. Në një anë kjo e bën ndërtimin dhe përparimin e kësaj bote, në anën tjetër, kjo muslimanët i shpëton nga prapambeturia e shteteve që nuk kanë përparuar fare. Se edhe Pejgamberi a. s. ka urdhëruar që dituria, shkenca të kërkohet që nga djepi gjerë në varr. Familja muslimane duhet të i përmbahet këshillës së Aliut r. a. që fëmijët e tyre të jenë të pasur me shkencën dhe teknologjinë e së nesërme. Kur kjo të realizohet, atëherë muslimanët do të jenë të parë.

1. Ibnu’l Ethîr, Xhâmiu’l Usûl, I, 416; Shih, Tirmîdhî, “Birr” 33.

2. Tirmîdhî, Menâkib, 63; Ibnî Mâxhe, Nikâh, 50.

# *Vjen tek unë papritur...*

*Dikush vjen tek unë e më trondit, si furtunë më tund, më shkund*

*Më thërret prej ëndrrës së fjetur, që thellë tërheq ndër iluzione.*

*Ma kthjellon imazhin, më zgjon.*

*Je ti profet i njerëzve që më thërret në dritë*

*Më ngarko me fjalë, me qetëson, më ngushëllon.*

*Më fut në turmën e njerëzve besnik me hapa drejt teje.*

*Të thanë poet, por poet nuk je,*

*Je dorë e ngrohtë mbi kokën e bonjakut,*

*shërim i ëmbël i zemrave të sëmura.*

*Drejtësi, fisnikëri prej dijes së pashkollë buruar nga i vetmi Zot.*

*Prej shpellës Hira filloi misioni i rëndë, e bartet ndër shekuj.*

*Ngjizet magjishëm në mendjet njerëzore,*

*Mrekulli hyjnore përherë e re përmes njeriut profet në zemra fisnike.*

*Dhe vjen tek unë.*

*Më tund, me shkund.*

*Samir Hoxhiq  
Viti-III  
Medreseja Haxhi Sheh Shamia  
Shkoder*

# Muhammed

*Në kupën e arshit emri i tij me nur i shkruar  
Në qiej Ahmed kurse në tokë Muhamed  
Ai që bukurinë e Zotit shikoi i mrekulluar  
Udhëtari i parë dhe i fundit Muhamed*

*Tek zbriste shiu i nurit nga shtat katet e qiellit  
N'at natë që zbritte ti nga pafundësia e diellit  
Melekët tek i dhanë çdo grimceje lajmin e Nebiut  
Atë natë ishte ti që erdhe o Muhamed*

*Diejt tek i linin në sexhde nurit të asaj nate  
Ujet tek përkuleshin, gjithësia në ekstazë  
Për Zotin të gjitha falenderimet e pamasë  
Atë natë ishte ti që erdhe o hazreti Muhamed*

*Tek ranë përtokë gurët e shirkut  
Tek u ulën të gjithë flamurët e injorancës  
Tek u fik flaka e zjarrit të pabesimit  
Atë natë ishte ti që erdhe o hazreti Muhamed*

*Tek thahej mrekullisht ligeni save  
Tek shtyllat e sarajit kisra u vrëzuan  
Tek mëshira mbush vakumet e botës  
Atë natë ishte ti që erdhe o hazreti Muhamed*

*Ti që i mbështjellur në lindje me të bardhat re  
Qysh se lindi urdhëri t'u dha për sexhde  
Në kokë kurora e mëshirës të duket  
O zotëria i botërave Muhamed*

*Ti që pishtari i cilësive të nalta morale je  
Ti që në majën e durimit ma i madhi je  
Ti që në xhennet shtëpia e të varfërve je  
O thesari i shpirtërave tanë Muhammed*

*Për ty dëshmojnë pafundësitë qësh në ezel  
Për ty dëshmon çdo shenjë ajet dhe vend  
Si mundet zemra larg teje me ndejt  
O dashuria e çdo shpirti Muhamed*

*Në natën e miraxhit hapen qiejt me rradhë  
Të përshendesin të gjithë pejgamberët me rradhë  
Të gjithë engjujt atëherë u ndalen me rradhë  
Shkove drejt Zotit krejt i vetëm, si një njeri i rallë*

*Çka i duhet syri atij që i zemrës mbyllur është  
Çka mundet gjuha me thanë kur në dynja vetëm ka hesht  
Të gjithë njerëzimin Zoti e shpëtoftë  
Nën flamurin tand o Muhamed, Ai e shëroftë*

*Në atë dasëm hyjnore robi me Zotin takohet  
Kur askush kërkend smundet me ndihmue  
Para peshores që matë të korrat  
M'i fal të metat o Muhammed*

*E dimë që randsi nuk ka pasuria e kësaj bote  
Në ahiret asht shpirti e vetmja pasuri  
Vazhdimisht përkujtues i jati me selam  
Dëshmitar i xhennetit këtij ummeti banu Ti*

## XHAMIA EMEVITE NË DAMASK

Arti emevite hodhi gurrthemet e para në arkitekturën islame që në fillimet e dinastisë së saj. Ky art i përket periudhës kur përhapja e fesë islame ishte në proces e sipër. Veçoritë e tij kanë aftësi seleksionuese më shumë se sa krijuese. Xhamia emevite është simboli i Damaskut dhe vendi që vizitohet më së shumti. Historiani Stragon pohon se qyteti i Damaskut është më i njohuri në Azinë perëndimore. Nga cila do anë që të hyni brenda qytetit e takoni atë, sepse xhamia identifikohen së bashku me qytetin.

Veçoritë e artit emevian mund t'i përmbledhim në këto pika të shkurtëra:

Objektet e trashëguara nga arkitektura e para islamit janë bërë burim inspirimi edhe për artin islam emevit.

Arkitektura e kësaj kohe mbart një rol të veçantë për arsye se janë krijuar objekte arkitekurore të reja me anë të një botkuptimi dhe shpirti frymëzues.

Emevitët kanë arritur ta sintetizojnë në mënyrë

të mirë jetën tradicionale arabe me qytetërimet e më parshme. Arkitektura emevite është skematizuesja e planit të hershëm të arkitekturës islame, ku në vitet pasuese do të bëhet shembull frymëzues edhe për popujt e tjerë myslimanë.

Elementet si mihrobi dhe minberi janë ndërtuar brenda mureve të faltores, rrethimi me kolona dhe portiku janë përdorur për të parën herë në planimetritë e xhamive të mëdha të po kësaj periudhe.

Arkitektura edhe pse është ndikuar nga kultura para islame, përsëri ka ruajtur formën në përputhje me frymën krijuese islame.

Materiali kryesor në këtë arkitekturë është guri dhe tulla, ndërsa në ornamente vërehet ndikimi i artit bizantin.

Xhamia është ndër më të mirat dhe të zgjedhurat në botë, për sa i përket veçorive të artit emevit për nga dekorimet dhe vlerat shpirtërore që mbart ajo.

Xhamia emevite është ndërtuar sipër kishës



së Jahjasë (Gjon Pagëzorit) e cila më parë kishte qenë një faltore romake e shkretuar që i përkiste shek. I p.e.s. Pas pushtimit të Damaskut, faltorja u transformua në xhami në vitin 635 h. nën kujdestarinë e Ebu Ubejde bin Xherrahit. Më vonë, si shkak i mosplotësimit të nevojave të besimtarëve, halifi emevit Velid b. Abdulmelik (705-715) e pa të arsyeshme blerjen e kishës së krishterë me qëllim zgjerimin e xhamisë. Me kërkesë të halifes, në ndërtimin e saj morën pjesë arkitektë bizantinë të dërguar nga Kostandinopoja. Xhamia emevite ka pësuar shumë herë dëme dhe për këtë arsye edhe është restauruar disa herë. Megjithatë ajo ka ruajtur cilësitë e veçanërisht madhështinë e mozaikëve. Si shkak i rënies së zjarrit kësaj xhamie, në vitet (1082-1083) është riparuar nga sultani selçuk Melik Shah. Kurse riparimi i dytë dhe më i rëndësishmi është realizuar në vitin 1894 nga ana e Sultan Abdylhamidit II.

Veçoria më tërheqëse e kësaj xhamie është ndërtim i saj në formë katrore. Faltorja me portikun janë të ndara nga njëra-tjetra. Sipërfaqja e faltores është 137 X 37 m, ndërsa ajo e portikut është 122.5 X 50 m. Pjesa e jashtme dhe qemerët janë të stolisur me mozaikë në ngjyrë të blertë si dhe mbartin motive floreale dhe gjeometrike. Veçoritë më krye-

sore të artit emevit vërehen tek figurat e ndodhura në sarajet dhe pallatet e emevive. Thesari i xhamisë u ndërtua në periudhën abbasite, sipër tetë kolonave në portik, me qëllim ruajtjen e tij. Xhamia numëron tri minare dhe katër porta kryesore. Hishia e minares së ndodhur në anën premdimore bie në sy më shumë nga të tjerat. Minarja e krahut lindor emërtohet si "Minarja e Isait", ndërsa ajo e anës veriore emërtohet "Minarja e nuses". Arsyja e emërimit në këtë mënyrë është simbolike dhe i ngjan asaj nuses që në dasëm ndodhet në mes të banketit. Ashtu siç ndodhet në mest të qytetit Xhamia emevite, po ashtu dhe kjo minare ndodhet në pozicionin në mes dy minareve të skajit. Mesi i xhamisë është i mbulura me një kube të madhe, kurse pjesët e tjera të saj janë të mbuluara me çati prej druri. Për të parën herë, në këtë xhami është ndërtuar një mihrab në formën e gjysëmharkut.

Në drejtim të mihrabit të madh, sipër varrit të Jahjasë është ndërtuar një tyrbe në periudhën e sundimit të halifit Velid. Portiku në mesin ku ndodhet shatërvani është e rrethuar me kolona.

Gjë tjetër interesante në këtë xhami është edhe ekzistenca e katër mihrabeve të secilit medhebb.



# Biblioteka e myftinisë së Shkodrës



**“Kush bisedon me botën flet me njerëz të zakonshëm, kush lexon libra flet me filozofë e njerëz të mëdhenj” – Sami Frashëri.**

Fondi i librave të sotëm të bibliotekës së Myftinisë përbëhet nga një pjesë e librave që iu kthyen nga biblioteka e qytetit dhe institucione të tjera, dikur në pronësi të institucioneve fetare islame, të gjithë në gjuhët orientale, si edhe nga libra të dhuruar nga persona privatë.

Janë të njohura raportet e librit me bibliotekën. Të grumbullosh libra nuk është shumë e vështirë, mjafton të kesh mjete financiare, kurse ta shndërrosh grumbullin e librave në bibliotekë, ta bësh këtë si një organizëm të gjallë që rritet paprerë, kjo gjë kërkon shumë punë e dije. Grumbulli i librave shndërrohet në bibliotekë të mirëfilltë atëherë kur punonjësi i shërbimit, bile deri edhe lexuesi, e gjen me lehtësi librin a çfarëdo materiali tjetër studimor që ndodhet aty.

Puna për krijimin e kësaj biblioteke nisi rreth katër vjet më parë, me identifikimin e tyre në ambiente të shpërndara pranë dy medreseve të qytetit duke i seleksionuar sipas gjuhëve, duke i veçuar sipas shkallës së dëmtimit e mundësisë për t’i kthyer në gjendje sa më normale pas një trajtimi të kujdesshëm një nga një, duke i pastruar nga pluhuri e myku e duke i mbledhur pjesët e shpëputura për t’i kthyer në gjendje fillestare. Kujdesi kryesor në këtë fazë ka qenë siguria fizike e librave, inventarizimi numerik i tyre, kushtet më të domosdoshme higjienike dhe sistemimi i tyre në ndërtesën e ish-medresesë, në lagjen Dudas, aty ku gjinden sot.

Për shkak të vendit të kufizuar jo shumë të përshtatshëm dhe të pamundësisë së sistemimit në rafte, meqë këto të fundit do të jenë në përshtatje me ambientet e reja që nuk janë ndërtuar ende, librat janë vendosur në kuti kartoni, sipas ndarjes në gjuhët përkatëse ku çdo kuti është e pajisur me shifrën e vet të klasifikimit shkencor bibliotekar dhe ka të regjistruar numrin e librave që përmban secila, një element i domosdoshëm për kontrollin fizik të tyre në çdo kohë. Duke marrë parasysh se vendi ku ndodhen aktualisht nuk mund të quhet përfundimtar, qoftë për arsyen e nevojës që kjo ndërtesë ka për rikonstruktime e adaptime, ose për arsye të zhvendosjes në një ndërtesë tjetër, sistemimi i tyre në kuti kartoni është zgjidhja më e përshtatshme tani për tani edhe për faktin se ndodhen në kushte higjienike të kënaqshme dhe se është e mundur të verifikohet me lehtësi inventari i tyre në çdo kohë gjatë lëvizjeve e zhvendosjeve të tyre në të ardhmen.

Nga ana tjetër, me këtë vendosje, kur dihet numri i saktë për çdo kuti, janë krijuar kushtet që, edhe pa pritur sistemimin e tyre në stacionin përfundimtar, qysh tani, duke siguruar një mbështetje financiare modeste, si pjesë e një projekti, të kalohet në fazën e përpunimit shkencor të të dhënave të vjela nga çdo libër për krijimin e skedës përkatëse për secilin e të skedarit në tërësi, si bazë për futjen në sistemin kompjuterik e plotësimin me të dhëna të tjera, duke krijuar kështu një sistem informacioni shkencor të kënaqshëm për lëndën që pasqyrojnë.

Deri tani, është arritur që identifikimi i tyre të bëhet sipas ndarjes së përgjithshme në bazë të gjuhës, përkatësisht në këto grupe:

1. Libra në gjuhë arabe, me kodin përkatës të gjuhës =927, rreth 5000 copë.
2. Libra në gjuhë osmane, me kodin përkatës të gjuhës =943.5, rreth 2300 copë.
3. Libra në gjuhë perse, me kodin gjuhësor =915, rreth 70 copë.
4. Dorëshkime, me kodin gjuhësor 09, rreth 1110 copë.
5. Libra të ndryshëm jo-orientalë, me ko-

din gjuhësor 091/094, rreth 80 copë.

Pra, si shumë e përgjithshme numerike na del rreth 8550 libra.. Këtu duhet të vëmë në dukje se, sadoqë numri i tyre për çdo kuti është strikt e nuk ndryshon, prurjet e reja në të ardhmen do të bëjnë që numri i përgjithshëm të vijë gjithnjë në rritje.

Përveç këtij kontigjenti në njësi libri, në këtë fond ka edhe një sasi periodikësh, edhe këto në gjuhët arabe e osmane, si Nur al Islam e tjerë. Për vetë veçoritë që kanë revistat, të marra veç e veç, ato nuk përbëjnë njësi bibliotekare, por vetëm kur lidhen bashkë në koleksion, duke përfshirë periudha kohore 3-mujore, 6-mujore ose vjetore si edhe duke llogaritur trashësinë që ato formojnë, punë që duhet të bëhet në të ardhmen. Sot për sot, ato janë të grupuara në kuti, njësoj si librat dhe numri i këtyre kutive arrin në 16 copë.

Deri tani ka përfunduar ajo pjesë e punës që ka të bëjë me identifikimin e sasinë numerike të tyre, të ndarë në bazë të gjuhës. Në këtë fazë ku ndodhemi, ata janë të manovrueshëm shumë lehtë për çdo ndërhyrje të nevojshme, si për kontrollin e verifikimin e tyre, ashtu edhe për vazhdimësinë e punës shkencore të mëtejshme me ta. Sikurse u theksua në pjesën e parë të këtij materiali, ngritja e një biblioteke nënkupton krijimin e një institucioni me rëndësi e kjo kërkon një kohë të gjatë, punë komplekse ku të bashkëveprojnë shumë pjesëmarrës. Puna e deritani-shme mund të shërbejë si shembull se edhe me një forcë të vetme, me një punonjës me normë jo të plotë e mbi baza gjysmë-vullnetare, mund të arrihet jo pak; mbi të gjitha, mund të shënohen piketat dhe drejtimi i duhur. Në këtë vështrim, në perspektivën e një biblioteke që ta meritojë emrin si të tillë, ne ndodhemi ende në fazë fillestare. Për ecurinë e mëtejshme, së pari, nevojiten takime e konsulta të veçanta, të përgatitura mirë e jo sa për të kaluar radhën në mënyrë që gjithçka të pasohet me masa e hapa konkretë e punët të përparojnë më tej. Kësaj duhet t'i kushtohet kujdes për shkak të veçorisë që do të ketë faza në vazhdim, sepse në qoftë se deri tani ka qenë e mundur deri diku të vazhdohet puna edhe me një forcë të vetme, me një person përgjegjës, tani duhet të futen në veprim edhe faktorë të tjerë.

Që libri të bëhet pjesë e bibliotekës, ai duhet t'i nënshtrohet procesit të përpunimit të tij sipas kritereve shkencore të njohura e për këtë, përveç specialistit të fushës nevojitet infrastruktura e nevojshme, me shumë elemente që përbën një rrjet të tërë, duke filluar nga vulat e posaçme me emërtesë përkatëse të Myftinisë, me etiketat që duhet t'i bashkëngjiten çdo libri, pajisja e çdo libri me shifrat përkatëse që kanë të

bëjnë me lëndën që përfaqëson, me të dhënat e tjera fizike të nevojshme, me libra inventari, me skedat që i shoqërojnë. Të gjitha këto nënkuptojnë trajtimin e çdo libri në veçanti, si pjesë e punës për evidentimin e tij e që pasohet me klasifikimin shkencor, krijimin e skedarit, katalogizimin e tjerë. Asnjë libër, si i tillë nuk mund të lihet jashtë klasifikimit të përgjithshëm i cili përmban në vetvete qindra e mijëra degëzime të veçanta e që i përkasin dijeve të panumërta; ky është një klasifikim shkencor ndërkombëtar dhe pa këtë nuk mund të vazhdoen proceset e mëtejshme me librin, për skedimin e integrimin në llojet e ndryshme të skedarëve, futjen në sistemin kompjuterik dhe hartimin e katalogëve e të bibliografive tematike ose përgjithësuese.

Nuk mund të lihet jashtë interesit gjithashtu edhe sigurimi i shërbimit të libërlihdhjes, sidomos në këtë fazë për rehabilitimin, për lidhje të pjesshme e të plotë të librave të dëmtuar në vite, për veshjen me kopertina e tjerë, gjë që e kanë të domosdoshme një pjesë e madhe e tyre.

Në këtë kuadër, në tërë këtë gamë të gjerë veprimtarie, puna e një njeriu të vetëm rezulton mikroskopi, ndërsa hartimi i një projekti të plotë për këtë bibliotekë tonën që po përpiqemi të krijojmë, do të ishte produkt i shumë forcave nga shumë sektorë, si nga fusha e inxhinierisë, ekonomisë e tjerë e, në këtë numër, edhe nga fusha e librit. Sa për këtë të fundit, si një veçori mund të shtojmë se edhe pa pritur hartimin e këtij projekti të madh, ky aspekt i punës me librin, puna studimore shkencore si edhe ajo që ka të bëjë me teknikën bibliotekare mund të vazhdohet, si deri tani; librat aty janë, të sigurt, në pritje të studiuesit që t'i shfletojë. Jemi me fat se kemi mjaft forca të kualifikuara për t'u marrë me këtë punë, duke llogaritur vetëm numrin jo të vogël të teologëve të rinj si edhe personelin mësues e nxënës pranë dy medreseve të qytetit tonë.

Është e vërtetë se në dinamikën e jetës së sotme, përballë dukurive të tilla, si kompjuteri, interneti e tjerë, libri po zhvendoset gjithnjë e më thellë në qoshen e harresës, por kjo ngjan si me atë që me zënie e një miku të ri i kthen krahët mikut të vjetër, ndërsa fjala e urtë na kujton se "një libër i mirë është miku më i mirë; njësoj, sot e përgjithmonë".

Megjithatë, dëshira për të ngritur një bibliotekë të tillë, mbi të gjitha, një bibliotekë të mirëfilltë si edhe fryma e mirëkuptimit që nuk ka munguar asnjëherë, na bën të shpresojmë se puna e nisur për krijimin e saj do të vazhdojë me ritme më të shpejta dhe ndihma e Allahut do të sjellë suksesin.

## SHPËRTHIMI QË TRONDITI JETËN DHE POLITIKËN SHQIPTARE

Me datë 15 mars 2008 Shqipëria dhe opinionioni publik u trondit nga shpërthimet që ndodhën në një bazë demontimi private. Armatimi që u çmontua në këtë minipunishte private është dërguar nga 22 depo me armatime që gjenden në Shqipëri, depo ushtarake të ngritura gjatë sistemit komunist në këtë vend.

Një muaj pas tragjedisë bilanci i tij numëronte 26 viktima të moshave të ndryshme, punëtorë të çmontimit të predhave dhe banorë të zonës, 19 nga të cilët janë gjetur të vdekur në terren dhe 7 të tjerë që kanë humbur jetën nga plagët e rënda në spitalet e vendeve fqinje. Përveç këtyre qindra të tjerë kanë marrë plagë nga ky shpërthim dhe janë kurrë në spitalet e vendit.

Kryeministri i vendit Sali Berisha ka bërë të ditur bilancin e tragjedisë së Gërdecit. Ai ka pohuar para anëtarëve të kabinetit qeveritar se janë

**EXCLUSIVE**



gjithsej 2615 objekte që kanë pësuar dëmtime të ndryshme dhe dëmi llogaritet 1 miliard e gjysmë lekë. Nga këto : 1112 objekte të dëmtuar janë në Vorë, 365 në Marqinet, 233 në Gjakaj, 109 në Gërdec. Në listën e përmendur janë vetëm objektet private të zonës dhe jo ato publike.

Ngjarja e Gërdecit është bërë shkak për largimin e Fatmir Mediu nga posti i Ministrit të Mbrojtjes.

## SHQIPËRIA MERR FTESËN PËR NË NATO



Data 03-04-2008 përbënte ditën e dytë të agjendës së samitit të Bukureshtit, por njëkohësisht edhe ditën kur Shqipëria mori ftesën zyrtare për anëtarësimin e saj në NATO. Se çfarë do të thotë kjo për fatet e ardhme të Shqipërisë pak nga shqiptarët e dinë, por ftesa për pjesëmarrje e një shteti të vogël, ku strukturat shtetërore dhe qeveria luajnë pak rol mbi fatin e vërtetë të kombit, në një bllok kaq të madh ushtarak siç është NATO-ja, u shëmbëllen aty si një ogur i mbarë.

Sipas analistëve ftesa e Shqipërisë për në NATO, mund të quhet garanci e lirisë dhe mund të nën-

kuptojë po ashtu garanci kundër ndonjë sulmi të ardhshëm të Serbisë. Përvoja e disa ish-vendeve komuniste tregon se anëtarësimi në NATO është hap drejt integritetit në Bashkimin Evropian.

Pritej që edhe Maqedonia ta merrte ftesën, por Greqia përdori veton për ta bllokuar këtë lëvizje. Ajo që pamë këtë javë, ishte se Greqia vazhdon në mënyrë konsekuente dhe pa kompromis nacionalizmin helen të shekullit të 19-të, e cila para së gjithash i kushtoi tokave të pastra etnike shqiptare dëshminë e masakrave makabre ndaj çamëve.

Çështja e emrit, që është shumë e rëndësishme për Qeverinë në Athinë, nuk do t'i ndalë investimet dhe aktivitetet bankare greke në Maqedoni pasi kjo do të thoshte humbje e madhe për ekonominë greke e cila një pjesë të mirë të fitimit të saj e realizon më saj të monopolit ekonomik që ka krijuar në këto shtete të vogla të ballkanit, siç edhe rasti i Shqipërisë. Befasues që fakti se si Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk u shprehën aspak në mënyrë që Greqia të zbusë pretendimet e saja, kur dihet shumë mirë ndikimi amerikan në krijimin e shtetit Maqedon.

# VIZITA E KRYETARIT TË KOMUNITETIT MUSLIMAN TË TURQISË



Me datat 11-12 mars 2008 bëri një vizitë të shkurtër në Shkodër kryetari i Komunitetit Musliman të Turqisë, prof. dr. Ali Bardakoglu, në krye të një delegacioni të këtij insitucioni prestigjioz. Mëngjesin e datës 12 mars kryetari i komunitetit musliman të Turqisë, Ali Bardakoglu, bëri një vi-

zitë në ambientet e medresesë "Ha xhi Sheh Shamia" dhe në zyrën e shoqatës Istanbul.

Në fjalën e tij Ali Bardakoglu mes të tjerash tha: "E rëndësishme është që të mund të ringjallet jeta jonë fetare me anë të rikthimit të vlerave vakufore që ka trashëguar ky vend dhe me një punë të madhe brezat e rinj të mund të valëvisin flamurin e besimit dhe mirëkuptimit, për të cilat ka aq shumë nevojë shoqëria e sotme shqiptare dhe ajo mbarëbotërore. Mes teologëve të rinj nuk duhet të ketë asnjë lloj të vogël keqkuptimi dhe mosmarrveshje dhe përpjekjet tuaja më të mëdha duhet të jenë se si ti shërbejini sa më mirë dhe me plane më afatgjate popullit dhe besimit musliman, në të cilin aderon pjesa më e madhe e kombit shqiptar."

## ERDOGAN VIZITË NË SHQIPËRI

Me datë 26 dhe 27 mars 2008 kryeministri i Turqisë, Erdogan është rikthyer pas tre vjetësh në vendin tonë për të konfirmuar ndër të tjera se, vështrimet e Turqisë dhe Shqipërisë në politikë përputhen me njëri-tjetrin dhe mes dy vendeve nuk ka asnjë problem për këtë çështje.

Dy kryeministrat kanë pohuar se, investimet turke ndër vite janë rritur dhe kanë shkuar në shifrën e 620 milion dollarëve sot nga 38 që kanë qenë në vitin 2002.

Si rrallë herë, gjatë konferencës për shtyp të Kryeministri Berisha dhe kryeministrit turk Erdogan dje nuk janë lejuar pyetjet nga përfaqësuesit e medias. Ndonëse një vizitë e rëndësishme, Berisha dhe Erdogan nuk janë pyetur dje nga gazetarët lidhur me atë çfarë ata kanë diskutuar gjatë takimit kokë më kokë apo atij mes dy delegacioneve. Shkak për këtë publikisht u njoftua se është bërë axhenda e ngjeshur e takimeve të kryeministrit turk Rexhep Tajip Erdogan dhe pamjaftueshmëria e kohës.

**Në fjalën e tij para shtypit kryeministri Sali Berisha mes të tjerash tha:**

"Dy vendet tona janë të lidhura me mijëra fije historike në të shkuarën e tyre. Lidhje tradicionale miqësore, por mendoj se gjatë qeverisjes së krye-



ministrit Erdogan, marrdhëniet midis dy vendeve mike, Shqipërisë dhe Turqisë kanë njohur zhvillimet më të mëdha. Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e cila hyn në fuqi në muajin Maj do të fuqizojë më tej këto shkëmbime. Shqipëria mbështet kandidaturën e Turqisë në sigurim. Është bindja ime se Europa nuk mund të plotësohet pa futjen e Turqisë në BE", ndërsa kryeministri turk Rexhep tajip Erdogan tha se: "Vështrimet tona në fushën politike përputhen shumë me njëri tjetrin. Midis Shqipërisë dhe Turqisë në këtë çështje nuk ka asnjë problem. Ashtu siç ka ndodhur deri tani edhe në të ardhmen do të vazhdojmë të mbështesim arsimimin e ushtarëve shqiptarë. Ne po hedhim hapa gjithmonë e më të mëdha në fushën e shkëmbimeve tregtare dhe ekonomike."

## KY ILAÇ DO T'I JAPË FUND GËRHIMAVE!

Më në fund shkenctarët kanë arritur me sukses të gjejnë këtë ilaç kundër gërhitjeve. Formula që do të hedh në histori shqetësimin shëndetsor që njihet si sindromi i gjumit të thellë dhe që shfaqet në një ndër 20 meshkujt e moshës së ndërmjetme, do të përkatitet nëpërmjet miksimit të dy ilaçeve të tjera.

Sipas informacionit të gazetës Angleze The Times ilaçi kundër gërhimave me kod BGC20-0166 ndikon direkt në tru dhe parandalon gërhatjen. Kjo gjë është provuar mbi 39 të sëmurë dhe janë marrë rezultate pozitive.



## GRIPI TË SHËNDOSHË!



Sipas studimit që është bërë në Suedi, pranë institutit Karolinsk, virusi i gripit hap rrugë që të shtohet pesha trupore e njeriut. Në seminarin e mbajtur në Malmoe me temë " Mbipesha tek fëmijët" Richard L. Atkinson, i cili kryeson këtë studim, u shpreh se ata shpresojnë se brenda këtij viti apo pas një viti do të kenë në dorë vaksinën që parandalon rritjen e peshës gjatë periudhës gripale".

Atkinson pohoi gjithashtu se të gjithë kilet e tepërta gjatë periudhave gripale nuk rrjedhin nga kjo situatë, por vetëm 1/10 e ndikimit të shëndoshjes së pacientit buron nga viruset gripale. Sipas studimit që është bërë mbi 500 pacient virusi Ad 36 është kontantuar tek 30% e atyre, ndërsa tek të dobëtit kjo masë shënonte vetëm 11%.

Sipas studiusit Atkinson virusi Ad 36 hyn në qelizat bërthamë të ADN-së dhe me anë të disa enzimave ai shkakton rritjen e qelizave dhjamore.

## **TANI MË LEHTË TË PARANDALOJMË INFARKTIN**

Një ndër problemet më të mëdha që njerëzit përballen është edhe infarkti. Ndër shkaqet e infarktut deri më tani numërohen: kolesterol i tepërt, tensioni, konsumimi i duhanit dhe lidhjet gjenetike, të cilëve u shtohet edhe një jetë monotone e stresueshme. Për një zemër të shëndoshë ekspertët këshillojnë që të rrimë sa më larg stresit.

Mund të thuhet se këto metoda ndihmojnë në parandalimin e infarktut:

1. Një martesë e lumtur dhe
2. Qëndrimi larg stresit

Ngjarjet stresuese dhe pikëlluese që ndodhin në ambientet ku jetojnë njerëzit dhe ndikimi që ato shkaktojnë janë të dëmshme për zemrën e njeriut.

Gjithashtu edhe njerëzit që punojnë me orë të gjata pa lëvizur nga tavolinat e tyre të punës janë më shumë të ekspozuar ndaj krizave të zemrës. Sipas studiuesve “qëndrimi për dy orë pa ndërprerje mbi tavolinat e punës përbën një rrezikshmëri të lartë për infarkt. Rëndësia të madhe ka edhe të ecësh në këmbë çdo mëngjes për 45 minuta. Gjithashtu rekomandohen edhe lëvizjet ndërsa jeni të ulur, fjala vjen lëvizja e qafës, hapja e krahëve, lëvizja e këmbëve.”

Gjithashtu studiuesit theksojnë edhe faktin se një zemër e qetë do të thotë edhe një zemër e shëndetshme, prandaj ata kujtojnë se të qeshurit e çiltër ndihmon në shtypjen e hormoneve stresantë të dëmshëm për zemrën e njeriut.



## ROBOTËT NË VEND TË FUQISË PUNTORE

Në të ardhmen e afërt në Japoni do të ketë rënie të fuqisë puntore, dhe si shkak i kësaj vendin e ka kapluar frika.

Popullsia japoneze ditat-ditës vjen e plaket dhe në vitin 2025 mendohet që 3.5 milionë puntorë të zëvendësohen me robotë. Sipas të dhënave zyrtare nga viti 2030 krahu i punës do të bie me 16 % dhe mbulimi i këtyre vendeve po krijon frikë. Fondacioni Memorial i industrisë mekanike në raportin e krijimit të mendimeve pohon se ky boshllëk do të mund të mbushet me anë të robotëve. Por kjo nuk do të thotë se çdo robot do të zë vendin e një puntori. Si shkak i zëvendësimit të tyre me robotë, ata do të kenë më shumë mundësi të hulumtojnë rreth gjërave të tjera të rëndësishme.

Në raport thuhet se në vitin 2025 edhe të moshuarit do të kenë mundësi t'u bëhet shërbim me anë të tyre, dhe nga sigurimet shoqërore të tyre shteti do të kursej 21 miliardë dollarë.

Në kumtesë, gjithashtu thuhet se kryerja e punëve si përkujdesja për fëmijët, të moshuarit dhe mirëmbajtja e shtëpisë nga ana e robotëve do të bëj që nëpunësit të punojnë vetëm një orë në ditë.



## SYZET QË GJEJNË GJITHÇKA



Shkenctarët japonezë kanë prodhuar një palë syze, që drejtohen dhe vihen në punë me komandë nga larg, dhe kështu bëjnë të mundur gjetjen e çdo gjëje të vogël brenda shtëpisë.

Me anë të kamerave të vendosura në syzat

“Smart Goggle” bëhet i mundur gjetja e çdo sendi të vogël si çelësat, celularët etj. Personi që i vendos syzet i mundësohet që me anë të kamerës së vendosur, të shohë, memorizojë dhe së fundi të gjejë çdo mjet, vetëm pasi të bëj thirrje. Sendet e memorizuara, në rast humbjeje të ndonjë sendi mjafton t'i pëshpërisim në mikrofonin e vendosur sipër kamerës së tyre.

Mendohet se me shpikjen nga shkenctarët japonez të këtyre syzeve që bëjnë të lehtë identifikimin dhe vrojtimin e sendeve të humbura, është arritur shumë. Ky produkt është hedhur në treg, por mbete kurioze mënyra e përdorimit të tyre meqenëse ato janë të mëdha dhe të rënda.

## LAVATRIÇET NË KOSH TË PLEHRAVE!

### Sepse ky stof nuk ndotet...

Një grup shkencëtarësh nga Astralia dhe Hong Kongu kanë zhvilluar një stof që pastrohet vetvetiu.

Për këtë arsye, rrobat mjafton t'i nxjerrim pak në diell. Në revistën Shkenca dhe Teknika të muajit Prill i është dhënë një vend i veçantë edhe stofit që pastrohet vetvetiu duke e lënë nën rrezatimin diellor. Sipas studimit të bërë aftësia pastruese që realizohet vetvetiu, bëhet me anë të mbështjelljes së perit me titanium dioksidi, kristalet-nano. Kjo molekulë mbart fotokaliste që duke u lënë në dritë bëhet e mundur zhdukja e papastërtive dhe njollave. Kimisti australian Walid Daoud pranë Universitetit Monash dhe kolegët e tij të Universitetit Politeknik të Hong Kongut, kanë zhvilluar këtë metodë me anë të së cilës pastrimi realizohet duke i ngjitur perit të stofit, titanium dioksidin dhe kristalët-nano. Rezultati më i mirë arrihet atëher kur stofi lihet para energjisë diellore, por efekt ka edhe nga rrezatimi i dritës si dhe në momentin kur e kemi të veshur atë.

Shkencëtari Doud mendon që ky lloj kumashi për të parën herë do të eksperimentohet tek ushtarët, por qëllimi kryesor i tij është zvogëlimi i konsumimit të ujit, energjisë, detergjentit. Sipas tij ky proces do të bëjë të mundur që konsumimi të jetë më i vogël.

